



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 MARS 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. MARTA 2018. GODINE**

**MARS - MART
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar lidhur me vendimin e Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava u vezi odluke Evropskog registra za obezbeđivanje kvaliteta u viskom obrazovanju (EQAR) o isključivanje Kosovske agencije za akreditaciju

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Në sallë aktualisht janë 65 deputetë.

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesë të deputetëve të Kuvendit, Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë të tjerë nënshkrues.

Para se të fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës, më lejoni t'i uroj të gjithë mësimdhënësit në Republikën e Kosovës për 7 Marsin - Ditën e Mësuesit. Faleminderit!

1. Debat parlamentar lidhur me vendimin e Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit

Të nderuar deputetë,

Deputetët e Kuvendit, Avdullah Hoti dhe Arbërie Nagavci, të mbështetur edhe nga 38 deputetë të tjerë nënshkrues, kanë kërkuar debat parlamentar lidhur me vendimin e Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga ky organizëm të datën 27 shkurt 2018.

Ftoj zotin Avdullah Hotin që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Menjëherë pas festimit të 10-vjetorit të pavarësisë, në vend që të kishim njohje dhe anëtarësime të reja në mekanizma ndërkombëtarë, më datë 27 shkurt 2018 Agjencia Kosovare e Akreditimit përjashtohet nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

Për njoftim të opinionit, ky Regjistër është entiteti i parë ligjor në kuadër të Procesit të Bolonjës, i përbërë nga shtetet anëtare të Procesit të Bolonjës. Ky institucion evropian siguron që agjencitë e akreditimit përmbushin standardet ndërkombëtare të cilësisë në arsimin e lartë.

Kosova ka qenë shteti i parë nga rajoni që është bërë pjesë e këtij institucioni dhe ka qenë përfituesja më e madhe e donacioneve për arsim të lartë, duke sjellë ekspertizën ndërkombëtare në Kosovë dhe mobilitet të studentëve dhe stafit akademik.

Por, kjo tani është histori. Shkarkimi i papritur i Bordit në shtator 2017 çoi në përjashtimin e kësaj agjencie nga ky institucion evropian.

Vendimi i Regjistrisë Evropiane të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë merr për bazë shkeljet në procesin e shkarkimit të Bordit dhe propozimin e bordit të ri.

E para, sipas nenit 7, pika 1, të Ligjit për Arsimin e Lartë, Agjencia e Akreditimit është e pavarur në hartimin e standardeve të cilësisë. Vendimet e saj nuk duhet të vihen në pikëpyetje nga palët e treta, sepse kjo konsiderohet ndërhyrje në pavarësinë e saj.

Kështu që sipas vendimit të Regjistrisë Evropiane të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, me shkarkimin e Bordit, kjo Agjenci e ka humbur aftësinë e saj për të vepruar në mënyrë autonome. E dyta, ligji për Arsimin e Lartë, Neni 7, pika 5, thotë: “Nëse më shumë se një e treta e anëtarëve të Bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye brenda një viti, Ministria duhet t’i raportojë Kuvendit”, e cila gjë nuk përmbushur.

Të nderuar deputetë,

Në letrën e ministrit drejtuar Regjistrisë Evropiane të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë theksohet se shkarkimi i Bordit është bërë me kërkesë të Kryeministrit, bazuar në informata konfidenciale për veprime joligjore të anëtarëve të Bordit.

Do të ishte mirë që Kryeministri dhe ministri të përgjigjen në pyetjet në vijim për të ndihmuar vendimmarrjen e këtij Kuvendi:

1. Cilat janë këto informatat konfidenciale?
2. A ka pasur ministri qasje në këto informata?
3. A janë vënë në dijeni anëtarët e Bordit për arsyet e shkarkimit?
4. Në letrën e ministrit drejtuar presidentit të Regjistrisë Evropiane të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë thuhet se “informatat konfidenciale” nuk vlejnjë për të gjithë anëtarët e Bordit.

Atëherë duhet dhënë përgjigje:

- Përse është shkarkuar i tërë Bordi?
 - A janë ndërmarrë veprime ligjore ndaj atyre anëtarëve të Bordit që kanë bërë shkelje?
5. Cilat janë arsyet për shkarkimin e anëtarit austriak të Bordit, z.Chritian Tauch, i emëruar në Bord vetëm dy muaj më herët?
 6. Si ka kuptim të shkarkohet anëtari amerikan i Bordit, z.Herb Amato, i cili pastaj është propozuar përsëri në Bordin e ri?

Të nderuar deputetë,

Vendimi i Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë ka rezultuar edhe për shkak të komunikimit joadekuat të tyre me autoritetet kosovare.

Sipas statutit të Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, agjencitë anëtare obligohen të raportojnë për ndryshimet që bëjnë nëse ato ndryshime do të kenë ndikim në anëtarësimin e tyre në këtë institucion.

- Ministria e Arsimit e ka pranuar një kërkesë nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në tetor 2017 për ofrimin e informatave lidhur me shkarkimin e Bordit.
- Pastaj edhe një shkresë tjetër në dhjetor 2017, ku ministria është informuar se Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë është duke bërë një vlerësim të jashtëzakonshëm të Agjencisë.
- Në vendimin për përjashtim është theksuar se emërimi i anëtarëve të rinj të Bordit nuk është transparent.

Është e papranueshme që për pesë muaj (nga tetori 2017 deri në shkurt 2018) nuk është ndërmarrë asgjë për të shmangur përjashtimin.

Sot nuk do ta kishim këtë situatë sikur të ndërmerreshin këto veprime:

1. Ministri të raportonte në Kuvend për shkarkimin e Bordit,
2. Kryeministri dhe ministri të ndërmerren veprime për shkeljet e pretenduara të ish-anëtarëve të Bordit,
3. Pas këtyre veprimeve, të sigurohej një proces transparent në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Bordit.

Duke qenë se këto veprime nuk janë ndërmarrë, natyrshëm dalin dyshime për motivet e këtij shkarkimi, këtu në Kuvendin e Kosovës, e lëre më nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

Tani jemi në fazën e ankimit të vendimit.

Në pikën 12.1 të Rregullores për aplikim të Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë theksohet se “arsyet e mundshme për ankesa kufizohen vetëm në gabimet procedurale që mund të kenë ndikuar në dëmtimin e gjykimit të Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë. Mospajtimet e thjeshta me vendimin e Komitetit të Regjistrit nuk përbëjnë arsye të vlefshme për ankesë”.

Pra, ankesa mund të bëhet vetëm nëse dëshmitë e ofruara nga Agjencia dhe ministria nuk janë marrë parasysh nga Komiteti i Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

Dëshmi të reja nuk do të pranohen. Rrjedhimisht, Agjencia dhe ministria nuk janë në pozitë të apelojnë vendimin për përjashtim.

Kështu që, është e pamundur që ky vendim të shfuqizohet shpejt dhe të kthehet situata e para 27 shkurtit 2018.

Cilat janë pasojat e këtij vendimi?

E para, ky përjashtim mund të ndikojnë në punësimin sezonal në Evropë të të diplomuarve dhe të atyre që vijojnë arsimin e lartë.

E dyta, rrezikohet referencimi i Kosovës në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, që ka qenë ndër arritjet e mëdha të sistemit të arsimit dhe aftësimin të Kosovës gjatë vitit 2016-2017 të Qeverisë Mustafa.

Në faqen 19 të raportit vjetor të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për vitin 2016 thuhet: “Kosova duhet pas një viti të raportoje për progresin në implementim të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve para grupit këshillëdhënës të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, në të kundërtën, tërhiqet referencimi”.

Tashmë dihet se ky raportim është shtyrë për mbledhjen e 48-të të Këshillit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve që pritet të ndodhë këtë pranverë.

Tanimë, Agjencia Kosovare e Akreditimit rrezikon që seriozisht të përjashtohet edhe nga ENQA, e cila e ka vënë Kosovën në një lloj suspendimi, që pasohet nga një vlerësim i jashtëzakonshëm i situatës.

E treta, janë bërë dëme serioze në arsimin e lartë në Kosovë.

- Në institucionet e arsimit të lartë, sidomos në ato private, ka humbur kontrolli lidhur me numrin e studentëve të pranuar brenda afateve të parapara me rregullore të Agjencisë.
- Është devaluuar procesi i akreditimit.
- Nëse në muajt në vijim nuk kryhet procesi i akreditimit/riakreditimit, plot institucione të arsimit të lartë nuk mund të shpallin konkurs për studentë të rinj në vitin akademik 2018-19.

E katërta, me këtë përjashtim dëmtohet:

- Njohja e diplomave në shtetet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë.
- Mobiliteti i studentëve dhe mësimdhënësve të Kosovës në universitete evropiane.
- Njohja e kredencialeve akademike të stafit akademik.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar i institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës.
- Mobiliteti i studentëve të huaj në Kosovë dhe njohja e studimit në Kosovë nga ana e tyre.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Sot është koha ta vëmë interesin e fëmijëve tonë para interesave partiake. Sot këtu është vendi të dëshmojmë këtë, duke lëvizur nga frazat politike, drejt vendimeve që hapin perspektivë për arsim cilësor.

Ju falënderoj për vëmendje dhe kërkoj që pas debatit që mund të kemi këtu në Kuvend, të mblidhemi grupet parlamentare për të dakorduar rekomandimet që duhet të votohen në fund të këtij debati. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është për dy grupet, dikush nga grupi, zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë,

Meqenëse sot jemi në Ditën e Mësuesit, personalisht dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” urojmë mesimdhënësit e ndërgjegjshëm që me përkushtim e kryejnë punën e tyre, duke u dëshiruar shumë sukses në misionin e tyre.

Kjo seancë e jashtëzakonshme e thirrur sot po vjen si reagim pas një situatë të krijuar, e cila është rezultat i ndikimit të drejtpërdrejtë të politikës, gjegjësisht grupeve partiake dhe biznesore në sistemin e arsimit të lartë.

Vetë situata e krijuar në arsimin e lartë së fundmi, por edhe në sistemin e arsimit në përgjegjësi në vendin tonë, nuk paraqet asgjë të reja e të papritura. Ndaj dhe nuk duhet të na befasojë vendimi i Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Ka kohë që politizimi i skajshëm i arsimit dhe ndikimi i tij qoftë nga grupet e ngushta të interesit, qoftë nga vendimet e marra në mënyrë të ngutshme, arbitrare, pa hulumtime dhe analizë të mirëfilltë, ka bërë që cilësia në arsim të bie dukshëm.

Se rezultatet e synuara në dokumentet strategjike të mos arrihen as për së afërmi dhe që e ardhmja e fëmijëve tanë dhe vendit tonë në përgjithësi, pikërisht për shkak të arsimit jociilësor të mos jetë ajo që ne e dëshirojmë.

Nuk është e re as praktika e ndikimit politik në shkarkime dhe emërimet në pozitat kyçe, qoftë në borde, ashtu edhe në të gjitha institucionet e tjera.

Andaj, edhe vendimi i arbitrari i kryeministrit Haradinaj, të cilin e mori vetëm dy javë pas ardhjes së tij në pushtet për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, i cili u zbatua nga ministri Bytyqi, e fatkeqësisht nuk është e re edhe mungesa e plotë e llogaridhënies dhe mosmarrjes së përgjegjësive nga askush.

Ajo që është e re nuk është se e kuptuam tani që Agjencia Kosovare e Akreditimit është e ndikuar politikisht, se nuk është e aftë të veprojë në mënyrë të pavarur dhe nuk është në pozitë që të marrë përgjegjësi të plota për veprimet e veta. I ri është vetëm fakti se këtë tani na e dëshmoi një vendim i marrë nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

Vendimi për të përjashtuar Agjencinë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë do të ketë pasoja të mëdha dhe të rënda për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Ky vendim i marrë më 27 shkurt të këtij viti, ashtu sikurse tashmë është e ditur, vjen pas vendimit të ministrit të Arsimit, zotit Bytyqi, për shkarkimin e Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim të marrë më 25 shtator 2017, sipas kërkesës së kryeministrit Haradinaj.

Është tërësisht e papranueshme që arsimi i lartë në vend të dëmtohet deri në këtë masë për shkak të betejave krejtësisht partiake e biznese ndërmjet grupeve të caktuara të interesit.

Përkundër deklaratave zyrtare nga MASHT-i, të cilët nuk di se nga e marrin guximin të deklarojnë se asnjë student nuk do të ketë problem me njohjen e diplomave ndërkombëtarisht apo pranim për regjistrim në universitetet evropiane dhe se ato do të trajtohen ashtu siç janë trajtuar deri më tani dhe se tendenca për të thënë se diplomat e studentëve tanë nuk do të njihen në Evropë janë manipulime të ulëte dashakeq dhe dëmtojnë imazhin e universiteteve tona dhe diplomave tona, citim ky i marrë nga faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit.

E vërteta është se pas përjashtimit të Kosovës nga Rrjeti evropian për sigurimin e cilësisë në arsimin, do të komplikohen jashtëzakonisht shumë procedurat e aplikimit në universitete ndërkombëtare për studentët e Kosovës, e po ashtu do të ketë mungesë besueshmërie për punësimin eventual në vendet e ndryshme të Evropës të studentëve që marrin diploma, që do të lëshohen nga universitetet, të cilat do të akreditohen pas përjashtimit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga EQAR-i.

Këtë e pohon edhe vetë drejtori i EQAR-it, i cili ka deklaruar: “Është e sigurt që procesi i aplikimit të studentëve kosovarë në universitetet ndërkombëtare tashmë do të jetë më i gjatë dhe më i vështirë për shkak të procedurave shtesë, që do të bëjnë universitetet evropiane”. Por, duhet të mos harrohet fakti se shkarkimi i Këshillit është bërë për arsye, e përsëris, krejtësisht partiake, dhe kjo tashmë është një praktikë e zakonshme në qeveritë e vendit. Si Këshilli që u shkarkua,

ashtu edhe Këshilli i ri i propozuar, ishin të përbërë nga persona partiakë, të emëruar për interesa të grupeve të ngushta. Beteja për pushtet dhe kontroll të arsimit të lartë publik e privat ndërmjet këtyre grupeve në fakt na ka sjellë në këtë situatë. Agjencia e Akreditimit tashmë ka mbetur pa organet drejtuese për gati gjashtë muaj dhe si rrjedhojë edhe me institucionet e arsimit të lartë të paakredituara, pra praktikisht të pakontrolluara sa i përket cilësisë.

Një element i rëndësishëm në marrjen e vendimit për përjashtimin e agjencisë sonë ka edhe ndikimi i letrës së kryetarit të Këshillit të kaluar, tashmë i shkarkuar nga qeveria aktuale, zoti Blerim Rexha, i cili nuk duhet harruar se po ashtu ishte një person me ngjyrimë partiake nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Edhe ankuesi apo i shkarkuari vjen nga një eksperiencë e keqpërdorimit të Këshillit të Cilësisë. Njihen tashmë jo pak raste kur ishin pezulluar akreditimet e programeve për t'i rikthyer të njëjtat brenda ditësh dhe javësh dhe po ashtu regjistrimet e studentëve përtej kuotave të caktuara.

Këshilli i kaluar Shtetëror i Cilësisë po ashtu asnjëherë nuk ishte ratifikuar në Kuvend sipas obligimit ligjor, pra faktikisht edhe ai nuk ka qenë valid. Por, përgjigjja që erdhi nga Qeveria aktuale ndaj shkeljeve të Këshillit të kaluar nuk ishte hetimi, shqyrtimi, vendosja para përgjegjësisë për këto shkelje, por shkarkimi i plotë i të gjithë anëtarëve të Këshillit të kaluar, mungesa e plotë e transparencës në këtë proces dhe mosraportimi në Kuvend sipas përgjegjësisë ligjore dhe propozimi i një grupi tjetër që duket se ka ndikime po aq partiake sa ai i kaluari. Kujdesi dhe masat ndaj veprimeve të Këshillit të Cilësisë do të duhej të vinin shumë kohë më parë dhe atë për akreditimet të kundërligjshme dhe krim të organizuar në arsimin e lartë, por situata erdhi ashtu që për inate personale dhe grupore, për direktiva partiake, të vendosen studentët tanë në rrezik të ballafaqimit me sfida të shumta rreth njohjes së diplomave të tyre.

Kjo që po ndodh është, në fakt, e përsëris, një betejë ndërmjet partive në pushtet për t'i favorizuar dhe kontrolluar bartësit e arsimit të lartë në vend. Me një qeveri të tillë të papërgjegjshme, jo vetëm se nuk mund të pritët liberalizim i vizave, por edhe ato studente apo ata studentë që do të mund ta gjejnë vetë mënyrën e financimit dhe të sigurojnë bursa për studime apo çfarë zhvillimi profesional jashtë vendit do të ballafaqohen me vështirësi të mëdha. Përgjegjësia pra është krejtësisht e institucioneve të vendit, në radhë të parë e Qeverisë së Kosovës dhe e zotit Haradinaj, e sigurisht edhe e ministrit të Arsimit. Lëvizja “Vetëvendosje” e konsideron shumë shqetësuese përjashtimin e Agjencisë së Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, dhe kërkon urgjentisht nga Qeveria dhe Ministria e Arsimit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për ta përmirësuar këtë dëm të madh që po i bëhet arsimit të lartë nga ndikimet politike e partiake.

Ndër masat emergjente për ta tejkaluar këtë gjendje ne propozojmë që brenda afatit të ankimit prej 90 ditëve të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura për ta kthyer Agjencinë në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë. Duhet të kryhen të gjitha obligimet ligjore

të Ministrisë, në radhë të parë raportimi në Kuvend për shkarkimin e ish-Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë, sipas nenit 7, pika 5 të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, ku parashihet se nëse më shumë se 1/3 e anëtarëve të Bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye brenda një viti, Ministria duhet t'i raportojë këtij Kuvendi, raportim që deri më sot nuk është bërë asnjëherë, me gjithë kërkesën tonë të vazhdueshme.

Kuvendi dhe të gjitha palët e interesuara duhet të njoftohen se pse janë shkarkuar menjëherë të nëntë anëtarët e Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, në mesin e të cilëve kishte edhe anëtarë ndërkombëtarë, ekspertë të arsimit të lartë, që vlerësohen nga komuniteti akademik ndërkombëtar. Duhet të na tregoni se a ka pasur një hulumtim dhe analizë të punës dhe performansës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Nëse po, kush e ka bërë këtë vlerësim të performansës? Cilat janë gjetjet, përkatësisht shkeljet e supozuara, apo parregullsitë? Çfarë është ndërmarrë në raport me ato veprime dhe çfarë do të ndërmerret për t'i përmirësuar këto parregullsi dhe pse këto nuk janë bërë publike asnjëherë?

Duhet të tërhiqet pika e planifikuar për seancën e kaluar për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe e njëjta të silllet në rend të ditës pas marrjes së të gjitha masave që e garantojnë një proces krejtësisht të besueshëm profesional, konstruktiv e me transparencë të plotë, që reflekton me propozimin e anëtarëve të ri të Këshillit Shtetëror të Cilësisë që kanë kredibilitet profesional e moral, të paanshëm politik, të liruar nga konflikti i interesit dhe me integritet personal. Kjo duhet të bëhet sa më parë, në mënyrë që të funksionalizohet puna e Agjencisë, e pastaj duhet të iniciohen ndryshimet ligjore që do të mundësonin mekanizmat dhe instrumente për ta rregulluar këtë çështjen në të ardhmen.

Përndryshe, bazuar në papërgjegjësinë e plotë është shumë e mundur që Agjencia Kosovare e Akreditimit të përjashtohet edhe nga rrjeti i Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë, që është edhe themeluesi kryesor i regjistrit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e ministrit, zotit Shyqiri Bytyqi, që para deputetëve ta sqarojë dhe ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e ngrehur nga dy grupet parlamentare. Zoti ministër, fjala është për ju!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Arsimi sot e ka ditën më të shënuar të tij, Ditën e Mësuesit. Mësues të vendit tonë, kudo që jeni në viset e ndryshme, në Diasporë - urime 7 Marsi, dita e më e rëndësishme për mësimdhënësit. Dhe, të mos harrojmë se sa herë ta kujtojmë Pandeli Sotirin, le ta rimarrim forcën nga

përkushtimi i tij për t'iu shtruar detyrave. Le të ju shërbejë edhe kjo sot kështu që ne për jetë të jetës t'i vazhdojmë për detyrat për arsimin.

Sot po diskutojmë për çështjen e sistemit arsimor, i cili është sektori më i rëndësishëm i vendit, i cili do të duhej të garantonte aftësimin e njerëzve për të marrë mbi vete barrën e zhvillimit ekonomik të vendit, zhvillimit shoqëror dhe zhvillimin individual. E vërteta është që sot kemi për diskutim vetëm një segment të sistemit arsimor, siç është Agjencia Kosovare për Akreditim. Si pasojë e largimit të Agjencisë Kosovare për Akreditim nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, EQAR. EQAR kërkon standarde, rregulla dhe cilësi të lartë në arsimin e lartë.

Të nderuar deputetë,

Shpresojmë se para se të kalojmë për arsyet e kësaj, ne duhet t'i japim disa informacione që janë të nevojshme për qytetarët e Kosovës dhe për ju deputetët.

Shpresoj që në të ardhmen Parlamenti i Kosovës do të ketë seanca shumë të shpeshta për arsimin dhe do të këmbëngulë që arsimit të bëhet prioriteti kryesor i Kosovës, sa s'është bërë shumë vonë. Por, cila ishte gjendja e sistemit arsimor në kohën kur Qeveria aktuale e mori detyrën, përkatësisht unë si ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e mora përsipër menaxhimin e këtij dikasteri. Vërtet pas marrjes së detyrës në mesin e shtatorit të vitit 2017, neve na është dashur një periudhë disamujore për ta skanuar gjendjen si brenda përbrenda vetë dikasterit, po ashtu edhe në sektorët vartës të kësaj ministrie, në mënyrë që ta kemi një qasje sa më të drejtë të implementimit të programit tonë qeverisës tashmë të aprovuar nga Qeveria Haradinaj. Ne e gjetëm një ministri me shumë probleme funksionale, të grumbulluara për vite të tëra. E sapo e konstatuam këtë gjendje edhe nga Zyra e Unionit Evropian në Kosovë nëpërmjet raportit të vlerësimit të dorëzuar në fund të muajit të kaluar, për të cilin vlerësim ne ishim dakorduar së bashku me Zyrën e Unionit Evropian në Kosovë me qëllim që në fillimin e marrjes së detyrës sonë që vërtet t'i dimë ku janë mangësitë e kësaj ministrie, në mënyrë që hapat tanë të jenë të sigurt drejt përmirësimit të kësaj gjendjeje.

Një sistem i arsimit para universitar që lë shumë për të dëshiruar, këtë e ka vërtetuar edhe vetë testi PISA 2015. Një sistem i arsimit të lartë që vështirë të nxirret një përfundim se si funksionon. Me numër të madh të universiteteve publike, me politizim të skajshëm. Me një numër enorm të kolegjeve private, me numër të studentëve për kokë banori të renditur diku në pjesën e parë të renditjes botërore. Pa asnjë orientim dhe vlerësim të raportit programor akademik dhe tregut të punës, një barasvlerë ndërmjet diplomave dhe dijës së dyshuar. Ne gjetëm agjenci të pavarura, shumica prej tyre me ushtrues të detyrave për vite të tëra, pra veprime jashtëligjore dhe si të tilla ishin kthyer tani jo në agjenci të pavarura, por në agjenci të varura.

Me këtë gjendje të përshkruar më lart, me të cilën është i njohur tashmë edhe publiku, ne erdhëm me një mision, për ta filluar një rrugëtim të vështirë dhe të gjatë për një arsim më të mirë në Kosovë, mision që ishim të vetëdijshëm se do të ketë sfida të mëdha, do të ketë reagime të mëdha, do të ketë mospajtime të mëdha, do të ketë rezistencë të lartë. Por, ne erdhëm vetëm me një ide - ky mision që po duket i pamundur nuk do të ndalet dhe për këtë ne i bëjmë thirrje gjithë opinionit, të gjithë personave përkatës dhe e monitorojnë arsimin, të gjithë profesionistëve që të na bashkohen në këtë rrugëtim. Pra, kjo thirrje ishte që në ditën e parë të marrjes së detyrës sonë. Tashmë ky mision ka filluar si rrugëtim, do të jetë një rrugëtim i gjatë me ne, por edhe pas nesh. Prandaj u bëjmë thirrje të gjithëve dhe çfarëdo arsyeje personale apo grupeve të interesit që të mos bëhen pengesë e këtij rrugëtimi.

Ne jemi të vendosur po ashtu që këtë rrugë ta bëjmë bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët pa rezervë po na mbështetin.

Të nderuar deputetë,

Nevojat për të vepruar në drejtim të përmirësimit të gjendjes në sistemin arsimor kërkojnë vendime të guximshme dhe në kohë, dhe gjatë këtyre vendimeve mund të ketë edhe vendime edhe të nxituara, por në asnjë moment keqbërëse, ose qëllimkëqija. Vendimi për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë me kërkesën e kryeministrit, i cili erdhi në fillim të mandatit tonë, jo më shumë se në dhjetëditëshin e parë të detyrës mbase tani nga kjo perspektivë e ngjarjeve mund të quhet veprim i ngutshëm, por besoj se gjatë këtij debati do të kemi mundësi t'i shpalosim parregullsitë e mëdha që e kanë karakterizuar këtë agjenci, e që në një të ardhme jo të largët do të kishte përfunduar po kështu siç përfundoi sot, me përjashtim nga EQAR.

Shqetësimi më i madh do të ishte sikur ne ta kishim gjetur një gjendje të arsimit të lartë ashtu siç do të duhej, do të ishte veprim ynë i bërë për çrregullim, por jo - çrregullimin e gjetëm aty. Tashmë sistemi i arsimit të lartë është bërë një arenë e luftës së parregullsisë dhe padive e ankesave nëpër gjykata. Ajo që dua të theksoj që ne pas vendimit të shkarkimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, i kishim bërë të gjitha veprimet ligjore. Ishte emëruar një bord i ri sipas Ligjit të arsimit të lartë, neni 7 pika 4, më pas iu dërgua Qeverisë më 6. 12. 2017, dhe u miratua më 15. 12. 2017.

Fatkeqësisht, për një kohë të gjatë, pra për muaj të tërë, nuk u arrit të bëhej funksional, edhe pse ne vazhdimisht kishim insistuar për rëndësinë e funksionalizimit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit nëpërmjet Këshillit Shtetëror të Cilësisë, për ç'gjë kishim bërë edhe presion në kuptimin pozitiv të Komisioni Parlamentar për Arsim për përjashtimin e mundësive dhe procedurave të rregullta, që kjo procedurë të shpejtohet dhe të miratohet. Në këtë rast, dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për Arsim, që gjetën mirëkuptim për përshpejtimin e procedurave.

Kjo vonesë, ndër të tjera, është pjesë e vendimit EQAR, sepse Këshilli Shtetëror i Cilësisë nuk arriti të funksionalizohet në kohë për ta dëshmuar pavarësinë e vet, profesionalizmin e vet dhe që nuk ka implikime politike. Është e rëndësishme të ceket që kjo rrugë e ratifikimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Parlament po ndodh një praktikë për herë të parë me iniciativën tonë, sepse ne e kishim vetëm një qëllim - që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të jetë sa më funksional, sa më i pavarur, që do të merrte miratim edhe nga Parlamenti i Kosovës.

Pas ngjarjeve që ndodhën, me shumë vonesë filluan zërat edhe për dyshimin e përbërjes së listës. Nuk është për ne aspak brenga për listën, edhe pse kjo listë nuk përbën persona politikë, siç ishin listat e këshillave shtetërore të cilësisë në të kaluarën, të cilat lista ishin të emëruara direkt nga vetë ministrat, pra paraprakisht me ndikim direkt politik.

Për ne ishte brengë kryesore funksionalizimi i Agjencisë së Akreditimit, që konsiderojmë se pa nevojë ishte lënë për një kohë të gjatë i pafunksionalizuar. Për ta treguar vendosmërinë tonë se Agjencia Kosovare e Akreditimit nëpërmjet Këshillit Shtetëror të Cilësisë duhet të funksionojë i pavarur dhe pa rezervat që u ngrehën, edhe pse me vonesë për mospajtim me këtë listë, ne dje i kemi drejtuar një kërkesë kryeministrit për ta pezulluar këtë listë dhe për të hapur mundësi të verifikimit të kësaj liste, e për një verifikim të tillë kemi kërkuar mbështetjen edhe të Unionit Evropian në Kosovë dhe çdo pale të interesuar, përfshirë edhe Parlamentin. Pra, jemi të hapur për këtë çështje. Duhet që të gjithë së bashku të angazhohemi për përshejtimin e të gjitha procedurave për ta funksionalizuar sa më parë Agjencinë Kosovare të Akreditimit, sepse çdo vonesë do të jetë problematike. Agjencia e Akreditimit në Kosovë ka nevojë që sa më shpejt të bëhet funksionale.

Ju lutem, deputetë, që ta keni parasysh, sepse ne e kemi në dispozicion 90-ditëshin për të parashtruar në EQAR dhe kjo na duhet që vërtet të kemi listë kredibile, për të cilën ne kemi qenë të bindur se kjo është listë kredibile, por ju mund t'i jepni mendimet, mund t'i jepni vërejtjet tuaja. Për ne është me rëndësi që Agjencia e Akreditimit dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë të jetë i pavarur dhe të funksionojë i pavarur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tani është radha e kryetarëve, respektivisht e përfaqësuesve të partive politike. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Së pari, edhe unë e shfrytëzoj rastin që të gjithë mësuesve aktivë dhe veteranëve të arsimit t'ua uroj këtë ditë të shenjtë për arsimin shqip, pra 7 Marsin, Ditën e Mësuesit. Fatkeqësisht, konstatoj që edhe pas 131 vjetësh të hapjes së mësonjëtores së parë shqipe arsimin e kemi në një gjendje, e cila lë shumë për të dëshiruar dhe shpresoj që këtë e kuptojmë të gjithë dhe të gjithë do të angazhohemi që kjo gjendje të ndryshojë sa më parë.

Para se të filloj të flas për çështjen, për të cilën jemi tubuar sot këtu, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Arsimit kam vërejtje për ministrin e Arsimit, i cili është ftuar dy herë në mbledhje të komisionit, e ka konfirmuar ardhjen dhe pastaj nuk ka ardhur në mbledhje. Kjo është një neglizhencë së pari ndaj detyrave e obligimeve që i ka para deputetëve, para komisionit, dhe detyrave për të cilat sigurisht se është njoftuar në momentin kur është bërë ministër.

Tash po vazhdoj me problemin, që konsideroj se është jashtëzakonisht serioz për arsimin në vendin tonë - përjashtimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë nuk mund të injorohet dhe nuk mund të thuhet se nuk ka ndonjë pasojë, sepse po të ishte pa ndikim, atëherë cili është kuptimi që ne jemi bërë anëtar i kësaj agjencie shumë të rëndësishme evropiane.

Bazuar në informatën që ministri i Arsimit ia ka dërguar kësaj agjencie në lidhje me arsyetimin për shkarkimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, të cilin arsyetim ne si komision dhe as si Kuvend asnjëherë nuk e kemi marrë, edhe pse kemi kërkuar, përveç tjerash thuhet se Këshilli Shtetëror i Cilësisë është suspenduar me kërkesën e kryeministrit, i cili ka pasur disa informata të veçanta për punën e Bordit. Ministri ka deklaruar se informatat nuk kanë të bëjnë me të gjithë anëtarët e Bordit, por të gjithë janë shkarkuar, që do të thotë se këtu është bërë vërtet një gabim, ose do të duhej të shpjegohet se si dikush që nuk ka faj duhet të shkarkohet për shkak se dikush tjetër është fajtor.

Ministri po ashtu ka deklaruar se puna e Bordit nuk i ka plotësuar standardet dhe procedurat ligjore, kurse ministri nuk e ka dhënë asnjë detaj se cilat standarde dhe çka konkretisht nuk ka plotësuar ky bord. Anëtarët e Bordit janë shkarkuar nga detyra pa u kontaktuar dhe pa u intervistuar asnjëherë dhe kjo është, po ashtu, një shkelje e rëndë procedurale që ka ndodhur nga ministria. Ministri nuk e ka shpjeguar se si janë përzgjedhur anëtarët e rinj të Bordit, cilat janë kriteret e kështu me radhë, e kjo flet për mungesë transparence. Këto çështje nuk po bëhen vetëm sa për ta kritikuar ministrin, por mendoj se nga këto gabime ministri dhe të gjithë ata që janë involvuar në këtë proces duhet të nxjerrin mësim për të mos i përsëritur, sepse ndonjëherë pasojat janë më të mëdha se sa ne mund t'i marrim me mend.

Pas përjashtimit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, ministri ka deklaruar, “asnjë student nuk do të ketë probleme me njohjen e diplomave ndërkombëtarisht, ose me regjistrimin në universitetet jashtë vendit”. Kurse, drejtori i EQAR-it, zoti Kolintu, ka deklaruar në lidhje me këtë çështje: “Përjashtimi i Kosovës nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë do t'i izolojë studentët e Kosovës. Prandaj, është e sigurt se procesi i aplikimit të studentëve kosovarë në universitetet ndërkombëtare do të jetë i gjatë dhe i vështirë për shkak të procedurave shtesë që do t'i kërkojnë universitetet evropiane”.

Sido që të jetë, nga kjo situatë ku jemi ne patjetër që duhet ta gjejmë rrugën për të dalë. Për të dalë nga kjo situatë, ministri duhet pa humbur kohë ta tërheqë propozimin e Bordit, i cili është në radhë që të votohet këtu. Paraprakisht, duhet t'i hartojë kriteret, jo vetëm MASHT-i, por bashkë me Ministrinë e Arsimit, duhet të marrin pjesë edhe institucionet tjera të arsimit, ekspertë të arsimit, organizata joqeveritare dhe, po ashtu, edhe vëzhgues nga Kuvendi, të sjellin propozime të reja dhe pas aprovimit në Kuvend të Bordit të ri të aplikojmë në këtë agjenci shumë të rëndësishme.

Sot ministri është i obliguar që të përgjigjet para deputetëve dhe nëpërmjet pyetjeve të deputetëve para opinionit edhe një herë në detaje pse është shkarkuar ky bord, cilat kanë qenë kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të ri dhe ajo që është më e rëndësishmja, duhet konkretisht të dalë, nëse s'e ka sot atë plan, me një plan nëpërmjet të cilit duhet të dalim nga kjo situatë dhe që Kosova të kthehet prapë në këtë institucion shumë të rëndësishëm evropian.

Ju kisha lutur edhe për një çështje, ministri tha se është hera e parë që ministria e sjell akreditimin në Kuvend. Është obligim ligjor për ta sjellë, kështu që Kuvendit nuk i keni bërë nder. Nëse bordet tjera janë zgjedhur pa Kuvend kanë bërë shkelje të rëndë, kështu që këto gjëra më nuk mund të lejohen. Nëse ka ndodhur një herë, tash vetëm jeni duke e kryer detyrën ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kush e ka fjalën? Zonja Bunjaku, urdhëro!

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë dhe ju deputete,
I nderuar ministër,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Meqë sot është 7 Marsi, po e shfrytëzoj rastin t'ua uroj të gjithë mësimdhënësve Ditën e Mësuesit dhe sot po diskutohet pikërisht për arsimin e lartë, për degradimin e arsimit në Kosovë tani e shumë vite me radhë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ne do ta arsyetojmë këtë seancë të jashtëzakonshme për përjashtimin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, duke i numëruar dëmet që i shkaktuan Kosovës dhe arsimit të lartë në arenën ndërkombëtare. Do t'i numërojmë vetëm disa nga dëmet e përjashtimit, përgjegjësia e së cilës i takon direkt kryeministrit të Kosovës, i cili nuk ishte i bindur mirë në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë pse e kishte shkarkuar krejt Bordin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, duke ia bërë njësoj sikur që edhe ministri nuk ka raportuar për shkarkimin e Bordit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e si rezultat i mosbindjes para

Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë është vlerësuar si ndërhyrje politike në pavarësinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Do t'i zbërthejmë krejt përgjegjësitë e këtij vendimi të kundërligjshëm dhe në fund do t'i tregojmë hapat që duhet t'i ndjekim tash e tutje, pasi përjashtimi veç ka ndodhur:

- humbja e besueshmërisë së autoritetit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, jo vetëm brenda Kosovës, para institucioneve arsimore publike dhe private, por sidomos në hapësirën evropiane e më gjerë, zhvlerësimi i mëtejme i rëndësisë së diplomave që fitohen në universitetet publike, kolegje private brenda dhe jashtë vendit.

- rangimi i universiteteve tona si universitete pa cilësi i dëmton studentët e Kosovës, të cilët i vazhdojnë studimet në nivele të ndryshme akademike duke rritur edhe më shumë zhvlerësimin e diplomave parauniversitare ndërkombëtare.

- rënia e besimit ndërkombëtar të Kosovës i redukton gjasat për përfitime në projekte të ndryshme evropiane në fushat e arsimit, duke themeluar mosbesimin dhe rënien e përfitimeve të Kosovës në programe e projekte të nevojshme ndërkombëtare për arsimin e lartë.

- humbja e përvojave, komunikimeve, lidhjeve dhe përfitimeve Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, duke i zvogëluar mundësitë e shumta të kësaj agjencie nga Regjistrit Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

- rritja e vështirësive për studentë kosovarë në universitete ndërkombëtare, sikur e kanë transmetuar mediet kosovare edhe deklaratën e drejtorit të Regjistrit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, duke i komplikuar edhe më shumë procedurat e mëtejme, pas rezultatit katastrofal të PISA-s në arsimin parauniversitar, tash edhe përjashtimi katastrofal i AAK-së nga Regjistrit Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, si ngjarja e dytë e dëmshme për arsimin e lartë.

E kujt është përgjegjësia e përjashtimit nga Regjistrit Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë? Përgjegjësia kryesore dhe e vetme duhet t'i takojë kryeministrin të Kosovës. Është publikuar edhe vendimi në mediet kosovare se vendimi për shkarkimin e Bordit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë është bërë me urdhër të kryeministrin Haradinaj dhe gabimi i vetëm i ministrit të Kulturës, Shkencës dhe Teknologjisë është mosrefuzimi i këtij urdhri, apo i këtij vendimi të paligjshëm.

Pra, në anën tjetër, duke e portretizuar kryeministrin Haradinaj si njeri me muskuj, si shumë të guximshëm, si njeri të cilit i frikësohen krejt ministrat për takime, orare apo edhe gjëra tjera,

edhe ministrin e Arsimit mund ta kuptojmë, pasi të gjithë ministrat i frikësohen stilit qeverisës Haradinaj. Dhe, kështu edhe ministri i Arsimit, megjithëse e ka vërejtur se ka shkelje dhe parregullsi dhe është vendim i pabazuar dhe antiligjor, nuk ka guxuar ta kthejë mbrapsht këtë vendim.

Në aspektin ligjor, ne e kemi stërthënë ngado që kemi pasur paraqitje, “nëse shkarkohet krejt Bordi, apo numri i përcaktuar me ligj, ministri i MASHT-it duhet t’i raportojë Kuvendit sipas Ligjit për arsimin e lartë”. Ne këtë e thamë edhe në Kuvend në deklaratimet tona jashtë rendit të ditës, por njëri nga kolegët deputetë është tallur dhe ka bërë gabim të rëndë, duke e vlerësuar reagimin tonë si hajgare, ndërsa sot jemi dëshmitarë se sa kemi pasur të drejtë në këtë reagim, qoftë si deputetë, qoftë si grup parlamentar, qoftë si LDK.

Pra, përgjegjësia për këtë gabim i takon direkt kryeministrit të Kosovës dhe ai duhet të japë përgjegjësi. Kjo përgjegjësi për dëme të tilla nuk duhet të jetë vetëm me një kërkim-falje, nuk mjafton, por për dëmin e madh që i ka shkaktuar shtyllës kryesore të arsimit në vend, ai duhet moralisht të japë vetë dorëheqje.

Çfarë duhet të bëjmë tani? Ne i kemi 90 ditë për Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë dhe po japim aq pak ditë për ndryshime të mëdha në qasjen ndaj Këshillit Shtetëror të Cilësisë, tani duhet t’i bëjmë këta hapa:

Duhet ta arsyetoni shkarkimin e Bordit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë me fakte, argumente, e jo me retorikë.

Më pas, nëse keni fakte e dokumente po ashtu për shkelje ligjore ose ndryshime për keqpërdorime, duhet t’i adresoni ato edhe në Prokurori, sepse nëse ka pasur shkelje ligjore, atëherë as Bord i kaluar, as ky Bord që do të zgjidhet tani nuk duhet të shpëtojë pa marrë përgjegjësi në raport me shkallën e dëmit.

Do të ishte mesazh shumë i keq për Bordin e ri që Bordi i vjetër ka bërë vendime të kundërligjshme, sipas kryeministrit dhe është amnistuar pa dhënë llogari para ligjit dhe drejtësisë. Shkelje pa llogaridhënie kanë shumë gjasa të përsëriten edhe nga Bordi i ri.

Sipas Ligjit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet t’i raportojë Kuvendit për shkarkimin e këtij Bordi.

Arsyetimi me fakte e argumente, e jo me fjalë, t’i dorëzohet si pako Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë.

Të ndryshojmë rrënjësisht emrat e propozuar të Bordit të ri të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe të propozohen emrat e rinj jopartiakë, profesionalë, njohës të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, e të mos zvarriten për kohë të gjatë.

Ata emra është dashur të sillen në Kuvend me kohë dhe t'i adresohen këtij Kuvendi me një CV të përshtatshme dhe njerëz jopartiakë, po profesional.

Ne si grup parlamentar propozojmë një grup punues, ku të bëjnë pjesë të gjitha partitë politike dhe të merren konkretisht me propozimet dhe me aplikimin e Këshillit në Komisionin Evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nezir Çoçaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk dua t'i përsëris kolegët e mi paraprakë, po fillimisht më duhet t'i përsëris me atë që thanë për urimin më të mirë që mund t'u bëjmë mësuesve, atyre që kanë dhënë shumë për gjenerata, për breza dhe për shtet shumë. Urime 7 Marsi- Dita e shenjtë e Mësuesit!

Sa i përket gjendjes që është në arsimin e lartë, ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se ku është arsimi i lartë sot, por një fakt duhet ta kemi parasysh çdo herë, të mos harrojmë para 10 vjetëve, para 20 vjetëve, apo edhe para luftës ku ka qenë arsimi i lartë.

Ne jemi pjesë e kësaj shoqërie, jemi pjesë e këtyre institucioneve në njëfarë mënyre apo tjetër dhe duhet t'i bindemi faktit sepse kemi dalë nga një situatë shumë e vështirë, arsimi i lartë ka qenë në një situatë shumë të pavolitshme, po nuk them që është mirë sot.

Të gjithë ata që kanë kontribuar në arsimin e lartë, të gjithë ata kanë vërejtje në punën e vet, të gjithë ata synojnë që sa më shumë dhe sa më mirë arsimi i lartë të arrijë majat e cilësisë dhe standardeve që kërkohet edhe në BE, po edhe më gjerë.

Unë ndoshta pak duhet të merrem edhe me disa fjalë, po shikoni, unë synoj që edhe ministri, po edhe të gjithë aktorët e tjerë që merren me arsimin e lartë duhet të kenë qenë të vetëdijshëm se ku ka qenë arsimi i lartë dhe çka kanë pritur ata që të jetë apo si duhet të jetë gjendja në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Unë e di mirë që kohët e fundit, edhe sipas vlerësimeve ndërkombëtare, arsimi i lartë në vazhdimësi ka pasur ngritje, e përsëris, ka pasur ngritje, për arsye se vetëm në vlerësimin e fundit

në janar 2018 për 470 vende Universiteti i Prishtinës ka pasur një ngritje dhe të gjitha universitetet e tjera, edhe publike, edhe ato institucione të arsimit të lartë privatë. Pra, kjo duhet të merret në konsideratë.

Nuk dua të flas për historikun si ka qenë gjendja dhe si është situata sot. Ne kemi akoma për të bërë dhe duhet të bëjmë edhe në universitetin publik që e kemi pasur si bërthamë, si ombrellë të të gjitha universiteteve të tjera, e lëre më në universitetet e tjera publike në Kosovë. Po ashtu, unë jam i mendimit edhe mendoj që edhe ministria e të gjithë të tjerët duhet të merren me përkrahjen dhe mbështetjen e arsimit të lartë privat.

Jemi në temën konkrete dhe po mendoj që sinqerisht situata ka qenë e pavolitshme, ndoshta jemi në një farë situatë jo të mirë, të favorshme, por ministri e tha dhe unë dua ta mbështes që do të ketë pezullim të kësaj liste, e unë shpresoj shumë që edhe ministri, po edhe të gjithë aktorët e tjerë që merren me arsimin e lartë duhet të diskutojnë rreth kësaj liste që të jetë sa më e favorshme, sa më e mirë, sa më cilësore, sepse punët dhe detyrat punuese të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe vetë Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe, kur e dimë faktin se pikërisht me këtë punë që është bërë në arsimin e lartë kemi qenë të pranuar në mekanizma që janë jashtëzakonisht kredibile dhe jashtëzakonisht kanë kritere dhe standarde të larta për ngritjen e cilësisë në tërë sistemin universitar të Evropës, po edhe më gjerë.

Unë mendoj mirë që ministri dhe të gjithë të tjerët duhet të ecin dhe të hapërojmë drejt sukseseve të tjera, gjeneratat e reja, studentët dhe të gjithë të tjerët presin nga ne që të kemi një gjeneratë të studentëve dhe studime që janë në koherencë me krahasimet që bëhen dhe me punën që bëhet në universitetet evropiane dhe po shpresoj shumë që kjo do t'i ndihmojë edhe tregut të punës në Kosovë, që është shumë i vogël dhe shumë i mangët, e sidomos me përgatitjen e tyre profesionale dhe të mirë shkencore, do t'ia dalim edhe në vendet ku do të mund të punojnë.

Ne po besoj që asnjëherë duhet të mos ndalemi dhe të punojmë sa më shumë në arsimin e lartë, sepse situata në këtë mënyrë nuk ka qenë e volitshme, sidomos veprimet dhe letrat që kanë ardhur nga EQAR-i nuk kanë qenë një përgjigje adekuate, po mendoj as e ministrit të Arsimit dhe as e Qeverisë krahas atyre që është dashur të thuhet.

Nuk mendoj se ka qenë veprim i mirë ndoshta edhe shkarkimi i të gjithë anëtarëve të Këshillit Shkencor të Cilësisë, por besoj se shumë shpejt do të dalim nga kjo situatë edhe për hir të studentëve, për hir të asaj që kemi qenë duke vepruar mirë në këtë proces, ne duhet në vazhdimësi të synojmë që të jemi sa më lart.

Po ashtu kërkojmë edhe mbështetje sa më të madhe për gjithë bartësit e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!, Zonja Teuta Haxhiu, në emër të AAK-së e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Është një ditë e veçantë për të gjithë mësimdhënësit. Prandaj, urime nga zemra të gjithë mësuesve për ditën e tyre.

Sot, po në këtë ditë të shënuar po diskutojmë për një çështje shumë me rëndësi, një lajm jo të mirë që nuk na bënë nder asnjërit nga ne si deputetë, por edhe qytetarëve të Kosovës.

Por, për mua personalisht është shqetësim edhe dalja në foltore dhe paralajmërimi për përjashtim edhe nga organizatat e tjera. A thua, a po i kontribuojmë vetë përjashtimit nga organizatat, a po i ndihmojmë dhe a i ndihmuan njerëz të caktuar përjashtimit të Agjencisë nga organizatat EQAR. Unë mendoj që ka shumë fakte në këtë drejtim dhe aq më tepër për mua dhe për ne është shqetësim paralajmërimi nga largimi edhe nga organizata të tjera, siç ishte edhe ENK-a.

Pra, i kisha lutur të gjithë ata që po kontribuojnë në këtë drejtim të ndalen dhe t'u thonë stop të këqijave që po tentojnë t'ia bëjnë Kosovës, në këtë rast, arsimit të lartë në Kosovë.

Ishin paralajmërimet, janë edhe fakte, por këto janë shqetësime që duhet të na shqetësojnë të gjithë neve.

Po flasim për një Këshill, kemi ardhur në një situatë që vërtet Kuvendi do të duhej të japë maksimumin për të zgjidhur një problem, pa dashur të ndalemi se si ka ardhur, deri ku ka ardhur.

Tani për mua shqetësim edhe më i madh është fakti që kjo Agjenci, me shumë materiale të shkruara që i kam qysh nga mandati i parë si anëtare e këtij Komisioni për Arsim që shkeljet e vazhdueshme në Agjencinë për Akreditim kanë qenë qysh në kohën kur udhëheqja e këtij institucioni është në një proces gjyqësor, pra drejtoresha Zhushi.

Pastaj, shkeljet e mëhershme të kësaj Agjencie shumë kohë më parë, për disa vjet, institucionet e arsimit të lartë janë përballur me padrejtësi të shumta, ndërkaq së fundit standarde të dyfishta kanë qenë dukshëm edhe më të shpeshta.

Janë marrë vendime të kundërta me rekomandimet e ekspertëve, kjo ka dëmtuar paanshmërinë e punës së institucionit, pra të Agjencisë për Akreditim, duke bërë padrejtësisht Këshillin Shtetëror të Cilësisë instrument të favorizime të disa institucioneve në dëm të institucioneve të tjera.

Kanë bërë lejin e lëvizjes së stafit akademik në kundërshtim me procedurat, duke favorizuar akreditimet e disa institucioneve në dëm të institucioneve të tjera.

Kanë përdorur standarde të dyfishta në pranimin e stafit akademik, varësisht nga institucionet, i njëjti profesor, me dokumentacion të njëjtë, nuk është pranua për akreditim për njërin institucion, por është pranuar për një institucion tjetër.

Është bërë kufizimi apo lejimi i regjistrimit të numrit të studentëve pa aplikuar kriteret e njëjta për të gjithë. Kështu Agjencia mori padrejtësisht rolin e rregullatorit se kush mundet dhe sa studentë duhet të regjistrojë, pa i monitoruar asnjëherë se sa institucionet i respektuan ato kritere.

Pra, jemi dëshmitarë që shumë prej institucioneve të arsimit të lartë, si kolegje private, të favorizuara, kanë pasur numër enorm të studentëve dhe me regjistrime edhe jashtë afateve.

Të gjitha këto dhe shumë të tjera janë shqetësim në vazhdimësi për vite të tëra që i kontribuan ditës ku jemi sot.

Duke i vonuar në proces të akreditimit, ky institucion, Agjencia i ka vendosur në pozitë të pafavorshme në treg shumë prej institucioneve të arsimit të lartë.

Instrumentet kanë marrë akreditim dhe riakreditim vetëm pak javë apo pak ditë para se të fillojë viti akademik, duke mos e lejuar hapësirën për regjistrim të studentëve të tjerë dhe këto kanë qenë të dyfishta.

Për të përkrahur institucione të caktuara Agjencia ka aplikuar edhe rregulla favorizuese të reja që kanë lejuar vetëm për një institucion, për shembull, një mësimdhënës që është në marrëdhënie të rregullt të punës në një institucion në Kosovë njëkohësisht është konsideruar i rregullt për qëllime të akreditimit edhe në një institucion të arsimit të lartë, një standard i tillë nuk është lejuar edhe për institucionet e tjera.

Ka edhe shumë e shumë të tjera shkelje që ky institucion ndërkombëtar, EQAR, nuk i lejon të ndodhin brenda organizatës së vet. Andaj, kontributi ka qenë shumëvjeçar për t'u larguar.

Por, edhe një herë po e theksoj, nëse vërtet kemi probleme, të mos them partiake apo personale, nuk duhet të punojmë në dëm të arsimit në Kosovë, por do të duhej që problemet të zgjidhen brenda institucioneve, në radhë të parë, brenda Republikës së Kosovës dhe t'i largojmë interesat personale për ta dëmtuar procesin arsimor në përgjithësi.

Në fund të fundit, ne jemi këtu për t'i kontribuar zgjedhjes së këtij problemi, pa e larguar edhe vetë Kuvendin që për muaj të tërë nuk bëri ratifikimin e një liste, pa dashur të ndalem në emrat që kanë qenë në atë listë. Megjithatë, Komisioni e përcjelli për Kuvend, por Kuvendi nuk u mblodh dhe këtu fajet i kanë edhe grupet politike, të cilat ndikuan për muaj të tërë që kjo të mos vijë në rend të ditës, në këtë rast, edhe nënkryetari i Kuvendit, i cili nuk e shqyrtoi, edhe pse

ministri priti për dy ditë resht në seanca, ishte këtu, pra, për ta diskutuar ndoshta më herë këtë problem para se të vijë.

Në fund të fundit, besueshmëria e një institucioni, siç u tha më herët, unë them nuk humbet për një kohë shumë të shkurtër, por humbja e besueshmërisë është përderisa punojmë në atë drejtim për vite të tëra dhe fatkeqësisht ky institucion, pra, Agjencia ka bërë shumë e shumë shkelje më herët, por nuk do të thotë që ne të mos diskutojmë, vërtet është me interes debati i sotshëm dhe unë pres që vërtet të kemi rekomandime, të cilat na qojnë përpara dhe të cilat ndikojnë që, në fund të fundit, shqetësimet më të mëdha janë për akreditimet dhe zënia e afateve për riakreditim dhe akreditim të institucioneve, presin 18 për riakreditim, pastaj janë mbi 200 programe për riakreditim, janë 40 deri 50 programe të reja, mbi 130 programe janë në masën e suspendimit dhe të gjitha këto, në fund të fundit, pasojat e tyre i vuajnë studentët tanë.

Dhe, problemet e tjera që janë akumuluar për vite të tëra, kam shumë materiale këtu, që studentët tanë asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje, ka pasur institucione që janë mbyllur nga Agjencia, thashë në mandatin e parë si deputete në këtë Kuvend dhe asnjëherë përgjigje nuk kanë marrë. Ato diploma në Evropë asnjëherë nuk njihen dhe asnjëherë nuk kemi qenë të sinqertë, askush nga ministrat për t'u treguar studentëve se do të ballafaqohen me këto probleme, sado që i kemi diskutuar në kuadër të komisionit. Por, më mirë është transparenca, më mirë është të jemi të hapura për problemet që mund t'i kenë studentët tanë jashtë, se sa t'i rrisim problemet dhe aq më shumë t'i fryjmë, pra t'i qesim benzinë zjarrit në këtë rast për të ndikuar që ne si organizata të largohemi vetëm për shkak të interesave të individëve të caktuar. Dikush mund të pësojë personalisht, por të mos shkojmë sipas thënies: "Për inati të resë, vdektë im bir". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për ta njoftuar opinionin, ne kemi pasur një mocion të LDK-së dhe unë nuk mund ta kaloj mocionin, meqenëse ju s'e keni votuar. Tani ai mocion ka ardhur si kërkesë për debat dhe po zhvillojmë debatin, nuk është as pronë, as çështje kush qysh mendon dhe qysh propozon, e aq më pak i atij që udhëheq seancën.

Nëse ka mocion, askush nuk mund ta çojë përpara çështjen pa u votuar mocioni ose pa u vendosur ndryshe, këto janë rregulla për të gjithë.

Në emër të "Nismës", fjalën e ka zonja Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Të dashur mësues, urime 7 Marsin, do t'ju jemi mirënjohës gjatë gjithë jetës për kontributin tuaj ndër vite.

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, zoti Limaj,
I nderuar nënkryetar,
Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Nëse do të duhej që ministri të raportonte për shkarkimin e Bordit të Akreditimit në Kuvend, atëherë jam e bindur se ai do ta bënte këtë, por meqë me dispozita ligjore nuk parashihet një gjë e tillë, atëherë mendoj se është e tepërt nëse i kërkoni këtë ministrit të Arsimit. Jo se ministri nuk do ta kishte këtë vullnet, por që nuk e ka pasur hapësirën dhe mundësinë për këtë. Madje, në njërën prej seancave, kur insistonte ta merrte fjalën e të jepte detaje për këtë çështje, nuk iu dha as fjala. As ne si pozitë nuk do ta mbështesnim atë nëse ai nuk do ta respektonte Kuvendin, por përkundrazi, ministri respektoi Kuvendin, respektoi edhe Komisionin për Arsim, në të cilin ne vetëm sa nuk e bëmë edhe atë anëtar të komisionit duke diskutuar aq shpesh e aq shumë tema me të.

Përveç kësaj, jemi dëshmitarë si anëtar të Komisionit për Arsim, kur ministri na kërkonte që ta shpejtojmë këtë procedurë për shkak të rëndësisë që ka dhe për shkak se shumë punë e prisnin përpara këtë Agjenci. Komisioni edhe pse pak e vonoi, megjithatë vendosi që këtë çështje ta shtyjë përpara. Ka kohë që pikën e rendit të ditës në Kuvend që e kishim mbi emërimin e bordit të ri e shtyn sa herë, pa asnjë arsye. Çdo vonesë që bëhej, kushtonte, dhe këtu fare nuk varej tashmë asgjë nga ministri dhe s'kishte asnjë faj ministri pse dikujt në Kuvend i pengonte dhe kjo temë as nuk vihej në diskutim, e lere më të votohej. Pra, vonesat ishin të Kuvendit dhe jo të ministrit. Të gjithë e dimë se si erdhi situata për shkarkimin e këtij bordi dhe të gjithë e dinë pse u shkarkua ai bord.

Prandaj, sot nuk do të flas më për këtë. Kam bindjen se duhet ta mbështesim këtë vendimmarrje dhe të kërkojmë nga ministri që të thellojë reformat në sistemin e arsimit, por ja që po ndodh e kundërta, ministri po atakohet dhe linçohet. Shtrohet pyetja, nga kush, pikërisht nga ata që e kanë dëmtuar dhe sjellë arsimin në këtë gjendje. Përveç kësaj, ne e dimë se vlerësimi i parë i AKA-së është bërë në vitin 2015. Vlerësimi i radhës do të ishte bërë në vitin 2019, nga parregullsitë gjatë kësaj periudhe që janë bërë nga KSHC (nga ky vlerësim AKA rrezikonte që të përjashtohet në vitin 2019 nga EQAR, gjëra për të cilat fare nuk do të duhej t'i faturoheshin ministrit Bytyqi).

Ankesat e shumta të drejtuara nga institucionet private të arsimit të lartë në AKA për vendime me standarde të dyfishta, proceset gjyqësore të aktorëve kryesorë nëpër këto institucione, politizim i skajshëm i AKA-së dhe të tjera si këto do të mjaftonin që ky përjashtim të ndodhte në vitin 2019. E tash, kur po mendoj se ministri me kohë i ka proceduar në Qeveri dhe Kuvend emrat e bordit të rinj, por Kuvendi nuk e ka proceduar, përkatësisht miratuar, ngase ka pasur vështirësi të ndryshme kinse në funksionimin e Kuvendit, më bën të mendoj se ka edhe politizim të çështjes, duke dashur që ky proces të vonohej. Çdo vonesë për kalimin e kësaj pike tregonte politizim. Gjithçka ishte e qartë, nuk ishin të gatshëm ta 'çkapnin' arsimin nga grupe të ngushta të interesit.

Unë personalisht kam pasur edhe kërkesa nga deputet të opozitës për ta kaluar këtë bord, por kur vinte puna te debati dhe miratimi i tij, ata dilnin jashtë, pra shihej se mbi interesin e arsimit, ata vendosnin qëndrimet e tyre politike, mbi interesin e vendit, ata i nënshtroheshin presionit politik. Arsimi është interes i vendit tonë, duhet ta mbështesim, pavarësisht politikave jo të drejta që i janë bërë, ne duhet të punojmë pavarësisht dashakeqësve.

Ministrin Bytyqi duhet ta mbështetim si Kuvend, ngase arsimi është kategori e rëndësishë se veçantë shoqërore, duhet të jetë mbi politikën ditore. Ju lutem, nëse kaq shumë ju duhet ta politizoni arsimin, atëherë fëmijët tuaj i mbani dhe i shkolloni këtu, në këtë politikëbërje, e jo në vende të tjera. Mos rrënoni një mundësi të mirë për të ardhmen. Ministrin duhet t'i kërkojmë me shumë reforma, me shumë aktivitete konkrete në terren, me shumë dinamizëm, në asnjë rast ta godasim politikisht. Qysh me marrjen e detyrës si ministër, z. Bytyqi tregoi seriozitet dhe përkushtim, andaj nëse mendoni se njerëzit e tillë duhet t'i largojmë edhe atëherë kur kemi rezultate, jeni gabim, sepse interesat individuale ose grupe të ne nuk do të merren parasysh, sepse nuk jemi të gatshëm të japim asgjë për një arsim cilësor, sepse ne nuk duam që idetë dhe kontributi ynë të manipulohet nga grupe të tilla.

Me asnjë çmim nuk do ta ndalim luftën kundër dukurive negative në arsim, me asnjë çmim nuk do të heqim dorë në ndërtimin e drejtë e produktiv të sistemit arsimor, andaj "Nisma" me politikën e saj në bashkëpunim me ministrin Bytyqi do të punojnë pandalshëm në arritjen qëllim mirë për arsimin në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar "6+".

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe ne si Grup Parlamentar "6+" vendimin e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, EQAR, për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit e kemi pranuar me shqetësim.

Sigurisht që nuk përbën lajm të mirë për të gjithë ne, për institucionet e vendit, për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e veçanërisht për reputacionin e shtetit të Kosovës. Por është një thirrje për të gjithë neve, pozitë e opozitë, atyre që ua dëshirojnë të mirën fëmijëve tanë dhe shtetit të Kosovës që të punojnë maksimalisht për t'ia kthyer dinjitetin arsimin tonë.

Si deputet, por edhe si qytetar i Kosovës, ky vendim për përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit duhet ta marr si shqetësim dhe si një çështje me të cilën duhet të ndërmarrim sa më

parë hapat e duhur që ta kthejmë cilësinë e arsimit të lartë aty ku e ka vendin dhe në binarët e nevojshëm.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë besoj që sa më shpejt që të jetë e mundur duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë për të kapërcyer këtë situatë, në të cilën gjendemi aktualisht, duke filluar nga parashtrimi i ankesës lidhur me vendimin për përjashtim.

Besoj dhe jam i mendimit që Agjencia Kosovare e Akreditimit duhet të jetë plotësisht e pavarur për ta kryer funksionin e saj, por gjithashtu është edhe më se e domosdoshme të jetë edhe transparente, duke treguar profesionalizëm dhe efikasitet. Prandaj, edhe një herë i lus palët e përfshira në këtë proces që në këtë situatë, me përkushtimin më të madh të tyre e me profesionalizëm e me dije të gjejnë zgjidhjen e duhur për të kthyer arsimin e lartë të Kosovës në këtë institucion, si dhe t'ua kthejmë shpresën e besimin studentëve tanë që me plot sfida e probleme ballafaqohen gjatë studimeve të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e diskutuesve, zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Meqenëse është Dita e Mësuesve, urime 7 Marsin të gjithë mësuesve në krejt Republikën e Kosovës, shpresoj që t'u kthehet dinjiteti një herë e përgjithmonë.

Përjashtimi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë rrënjët i ka thellë në partizim të institucioneve dhe bordeve tona. Kjo praktikë ka kohë që ka filluar, po jua ilustruj me një sekuençë bisede nga afera "Pronto", aty ku Grabovci i thotë Bujës: "A e ke qu ndokënd në Agjenci të Akreditimit?" E ky i dyti i përgjigjet se "që dy herë është shtyrë dhe rishtyrë", mandej ish-ministri i Arsimit, Ramë Buja, thotë: "E kam qu Fatmirin", ndërsa Grabovci insistonte në Ramadanin. Në bisedën e radhës të këtyre dy personave, ministri duket i nervozuar për shkak të presionit që kishte në ndikime në emërimet, madje ai edhe kërcënon me dorëheqje.

Të nderuar qytetarë,

Ndikimet partiake kanë filluar edhe shumë kohë para kësaj që kemi dëgjuar nga afera "Pronto". Madje, ka pasur një garë të ashpër mes të ashtuquajturve "kuadro të LDK-së" dhe atyre që kaluan në PDK se kush më shumë e më dendur shtrinte ndikimin në universitetet publike e kolegje private, e në institucionet përgjegjëse për monitorimin e tyre. Duhet ta themi hapur se arsimit në Kosovë jo vetëm në arsimin e lartë dhe në Agjencinë Kosovare të Akreditimit, por në të gjitha nivelet, në të gjitha komunat e Kosovës, me disa përjashtime të vogla, është i partizuar skajshëm. Prandaj, kemi udhëheqje të dobëta të shkollave, mësimeve, të cilët kanë mesatare të ulët, ndërsa ata të cilët kanë mesatare të lartë, një pjesë e tyre nuk punojnë në vendet adekuate, sepse partitë politike, të cilat kanë udhëhequr me Kosovën, nuk e kanë parë arsimin si prioritet,

por si mekanizëm për të bërë fushatë elektorale të pandershme që si përfundim kanë sjellë këtë degradim, i cili ka mbërritur kulmin në përjashtimin e Agjencisë.

Në të njëjtën mënyrë bëri edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj. Ai këtë kërkesë e ka bërë duke arsyetuar se procesi i akreditimit në arsimin e lartë është përcjellë me parregullsi serioze. Kryeministri ka deklaruar se ka kërkuar nga ministri që procesi i ri të rezultojë me përzgjedhjen e njerëzve me ekspertizë të duhur në sektorin e arsimit, etike e profesionale. Në fakt, kërkesa e tij, mosraportimi dhe sjellja me papërgjegjësi të plotë rezultoi me përjashtim të Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë. Ajo që shihet nga vendimi për shkarkimin e AKA-së nga EQAR është se theksohet se përjashtimi ka ndodhur për të mbrojtur vlerat ose parimet e tjera kryesore të cilësisë. Në dokumentin e EQAR theksohet se ministri nuk ka mundur të arsyetojë shkarkimin e Bordit, ndërsa nuk ka mundur të arsyetojë as parregullsitë, të cilat i ka përmendur gjatë procesit të shkarkimit.

Por, është me rëndësi të përmendet fakti se vetë kryetari i Këshillit të kaluar, zoti Blerim Rexhaj, i cili edhe kishte dërguar letër në EQAR, është person partiak me ngjyrimë të theksuara të PDK-së. Arsyetimi i përgjithshëm i MASHT-it se shkarkimi është bërë për parregullsitë qëndron, përveç tjerash, nuk duhet harruar se ish-Bordi i AKA-së ka aprovuar 87 vendime për akreditim, për të cilat ka dyshime të bazuara që kanë përdorur dokumente false, mirëpo MASHT nuk ka arritur ta argumentojë në opinion diçka të tillë. Kjo na bën të kuptojmë që vendimi për shkarkim ka qenë politik, se sa i thirrur në shkeljet e vërteta të bëra. Si Bordi i mëparshëm, ashtu edhe ky që po propozohet tani janë persona me afirmimet politik, të caktuar për interesat e ngushta klanore, e madje edhe kriminale dhe ndeshja mes këtyre grupeve ka sjellë në situatën e tanishme nga EQAR dhe ngeljes së AKA-së pa organe drejtuese tashmë e disa muaj, e si pasojë edhe me institucionet e arsimit të lartë të paakredituara, përderisa ka vazhduar regjistrimi pa asnjë kontroll të studentëve në shumë universitete e kolegje private.

Nuk besoj se tashmë ka nevojë të theksojmë se ku kemi rënë, prandaj edhe renditja në vendin e fundit në PISA vjen edhe si shkak i disa të dhënave që u përmendën dhe plot të tjerave që kanë rënduar sistemin arsimor në Kosovë. Përjashtimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë do të ketë pasojë të mëdha për studentët e diplomuar të Kosovës që duan të vazhdojnë studimet në ndonjë universitet ndërkombëtar. Drejtori i EQAR, Kollin Tuk, ka thënë se pas përjashtimit të Kosovës nga organizata që ai drejton, do të komplikohen jashtëzakonisht procedurat e aplikimit në universitetet ndërkombëtare për studentët e Kosovës.

Është e sigurt që procesi i aplikimit të studentëve kosovarë në universitetet ndërkombëtare tashmë do të jetë më i gjatë dhe më i vështirë, për shkak të procedurave shitesë që do të bëjnë universitetet evropiane. Përjashtimi i AKA-së nuk do të thotë domosdoshmërisht që diplomat e

universiteteve në Kosovë nuk do të njihen më, por njohja mund të jetë më e vështirë për ato diploma që lëshohen nga universitetet që do të akreditoohen pas përjashtimit të AKA-së nga EQAR.

Të nderuar qytetarë,

Në vend se kjo Qeveri të përmirësonte gabimet e Qeverisë së kaluar, sistemin arsimor në Kosovë po e shtyn drejt kolapsit dhe ata të cilët do të humbin më së shumti dhe do të bartin pasojat e këtyre veprimeve, si gjithnjë janë qytetarët e këtij vendi. Prandaj, na duhet një urgjencë departizimi, sepse secili që dilte këtu thoshte “depolitizimi”, domethënë ka dallim mes politizimit, sepse ka politika për atë farë pune, por nuk duhet të jetë partia. Prandaj, na duhet, thashë, me urgjencë departizimi tërësor i sistemit arsimor, por këtë nuk është në gjendje ta bëjë kjo qeveri, ashtu sikurse nuk e kanë bërë as qeveritë e kaluara. Pa dyshim se këtu janë humbës më të mëdhenj nxënësit, studentët dhe të gjithë të rinjtë të Republikës së Kosovës.

Ne deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” jemi tepër të vendosur që intensivisht të punojmë e që të mos lejojmë Qeverinë të emërojë sërish persona me nivel të ulët profesional, akademik e shkencor. Për këtë angazhohemi plotësisht dhe pa rezerva dhe, në fakt, gjatë diskutimit këtu u përmend që ministri nuk ka obligim ligjor që të dalë dhe të raportojë, në fakt Ligji për arsimin e lartë, neni 7, pika 5, thotë që ministri duhet të raportojë në Kuvend nëse ndërron tre vetë, e lëre më që ai i ka ndërruar pra nëntë vetë, e ka pasur obligim ligjor që të dalë dhe të raportojë, gjë që nuk e ka bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Unë do të dëshiroja që sot Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni më i lartë i këtij shteti, të debatonte për sukseset në arsim, për reformat në arsim, për cilësinë dhe ngritjen e cilësisë së arsimit të të gjitha niveleve dhe jo mu më 7 Mars, Ditën e Mësuesit, ne të thërrasim seancë të jashtëzakonshme.

Duke qenë që vij nga opozita, nuk është dëshirë e opozitës që të thërrasë shpesh seanca të tilla, por mendoj që është përgjegjësi shtesë kushtetuese dhe ligjore e opozitës që të mirëmenaxhojë dikasteret e caktuara, për të cilat e ka marrë përgjegjësinë po nga ky Kuvend. Vendimi i Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë domosdo është më tepër se alarm për shtetin e Kosovës. Mbase kam qenë ndër pak deputetë të opozitës që kur është debatuar për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, kam kërkuar rritje të buxhetit për arsimin në të tri nivelet, sepse në shekullin XXI, në trendet moderne të reformave të arsimit, të ndjekjes së trendeve normale dhe bashkëkohore të tregut të punës kjo nuk mund të bëhet pa mbështetjen e

nevojshme buxhetore dhe financiare të sektorit më të ndjeshëm, më të rëndësishëm për një shtet, për shtyllën kryesore që është arsimiti.

Kam bërë edhe kërkesa të tjera, jo për ministrin Bytyqi dhe për Qeverinë, por për sistemin arsimor të vendit dhe në këtë segment kërkoj konsensus nacional, nuk mundet një ministër t'i zgjidhë për tre muaj, pesë muaj apo gjashtë muaj, problemet e grumbulluara me vite të tëra në sistemin e arsimit. Jemi dëshmitarë të kohës dhe ne disa që jemi më gjatë në politikë se që nga viti 2002 i kemi pasur duart e lira ta vëmë në binarë normalë sistemin e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Fatkeqësisht që të dyja janë katandisur dhe janë rrëzuar përtokë. Ministri Bytyqi në fjalën e tij tha që e ka marrë detyrën në ministri me shumë probleme funksionale në të gjitha hallkat e funksionimit të saj. Kjo është një qasje racionale për situatën në këtë dikaster kaq të rëndësishëm. Arsimiti parauniversitar dhe testi PISA nuk duhet ta gëzojë opozitën apo ta dëshpërojë një pjesë të pozitës. Zoti zëvendëskryeministër, në këtë debat jashtëzakonisht të rëndësishëm është vetëm një partner i koalicionit qeverisës këtu, kjo më bën të dyshoj që vërtet nuk ka qasje serioze dhe nuk është prioritet i kësaj qeverie zhvillimi i arsimit, i sektorit të arsimit në të gjitha nivelet dhe kjo po shihet edhe si pasqyrë e prezencës së pjesëtarëve të Kabinetit qeveritar vetëm nga njëri partner i koalicionit qeverisës.

Ministri tha që kërkesa për t'u proceduar në Komisionin Parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Bordit të Agjencisë të Akreditimit të Kosovës është bërë më 6 dhjetor të vitit të kaluar. Është proceduar më 15 dhjetor të vitit të kaluar. Vallë çfarë kanë bërë mekanizmat kompetentë, në radhë të parë edhe në Kuvend, ku ju, zoti zëvendëskryeministër, jeni pjesë e kësaj qeverisje dhe e keni mazhorancën. Këtu hapet tani një dilemë e madhe, një pikëpyetje e madhe, sepse vërtet ky sistem që do të duhej të ishte krenaria e Kosovës së re, kur e lamë prapa një dekadë të shpalljes së pavarësisë dhe kur e dimë se çfarë sakrifice kanë bërë punëtorët e arsimit të të gjitha niveleve të viteve '90-'99, por edhe tutje, thjesht hap dilema të mëdha se këtu po vjen era ekskluzivisht politikë.

Në këtë kuptim, unë sot bëj apel që ne të kemi konsensus nacional pas këtij alarmi që na erdhi nga EQAR. Tek e fundit, qeverisja nuk është vetëm të merren vendime, qeverisje nënkupton respektim të neneve të Kushtetutës, nënkupton respektim të ligjeve dhe të normave ligjore, prandaj zoti ministër, bashkë me neve, sepse të gjithë kemi hise, nëse mund të themi me fjalë të popullit, në degradimin e arsimit, por edhe të gjitha bordet e tjera të Agjencisë Kosovare të Akreditimit, kolegë të nderuar, kanë qenë puro politike, ka pasur emra profesionalë, por pjesa dërrmuese e tyre kanë qenë pjesë e Bordit të Këshillit të Lartë të Cilësisë dhe nuk e kanë pasur idenë se ku kanë shkuar dhe cili është roli i tyre. Prandaj, zoti ministër, kërkojmë me urgjencë që bashkërisht, si Kuvend dhe si Qeveri, ta gjejmë rrugën e normalizimit të këtij alarmi që na e ka dërguar EQAR ditëve të fundit.

Të mos përdorim inate politike partiake, mbase edhe personale. Një herë e përgjithmonë t'i lëmë anash interesat personale, po bëhet fjalë për arsimin universitar, po bëhet fjalë përreth 30 mijë maturantë që e shohin me shpresë këtë institucion dhe atë ndërtesën tjetër përballë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ku jemi ne si spektër politik, ku është Qeveria e Kosovës karshi shpresës së atyre të rinjve, karshi shpresës së studentëve që mbarojnë studimet dhe shpresojnë që të avancohen tutje në vendet e rajonit, të Evropës dhe më larg. Unë nuk dua të besoj që Ministria e Arsimit nuk ka teknokratë të thirrur që t'i menaxhojë dhe t'i vërë në binar institucional dhe të nevojshëm me interes të arsimit të Republikës së Kosovës, jo në këtë rast të "Nismës" dhe partnerëve të koalicionit qeveritar.

Ku janë ata profesorë eminentë, me të cilët jemi krenuar për vite dhe dekade të tëra? Ku është Akademia? Ku është universiteti? Ku janë kolegjet private, në gjirin e së cilave ka mjaft profesorë teknokratë, ekspertë që e njohin legjislacionin e trendëve moderne të reformave dhe zhvillimit të cilësisë së arsimit të lartë universitar.

Prandaj, uroj që ky Kuvend, uroj që mazhoranca, në radhë të parë, ta ketë mësuar mësimin se duhet ta bëjmë një kthesë të madhe në reformë të thellë, në depolitizim të arsimit të lartë në Kosovë. Prandaj, duke shpresuar që pas këtij debati të nxjerrim konkluzione, në radhë të parë në interes të arsimit të lartë, të mësimdhënësve dhe të studentëve e rinisë që janë shpresa e këtij vendi. Përndryshe, këto debate, me avaze të vjetra, dua të shpresoj që nuk do të jenë të kota. Andaj, pas shterimit të këtij debati të ulen përfaqësuesit e të gjitha partive politike dhe t'i ndihmojnë në këtë rast, si deputet opozitar po bëj kërkesë publike, apel publik, ministrit të Arsimit të dalë nga ky vorbull, i cili mund të jetë njëri nga hallkat e mesazheve jo të mira, sepse na presin probleme me ENCA-n dhe organizatat simotra të saj dhe ndërprerjen e të gjitha bursave për studentët dhe talentet, por edhe mësimdhënësit që i ka Kosova dhe janë të shkëlqyeshëm.

Dua të besoj në racionalitet, dua të besoj në konsensus, dua të besoj që fjalëve "transicion", "politizim" dhe "joprofesionalizëm" ky Kuvend një herë e përgjithmonë t'u vërë pikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Reagimi ynë i vazhdueshëm pikërisht për këtë gjendje, qoftë nëpërmjet pyetjeve parlamentare këtu në Kuvend, qoftë përmes tryezave me profesionistë, qoftë me Komisionin Parlamentar për Arsim dhe konferenca për media, kemi hasur në vesh të shurdhër nga Qeveria.

Pra, qartësisht mund të themi se Qeveria Haradinaj ka qenë e njoftuar, e paralajmëruar nga profesionalistët, por edhe zyrtarisht nga Lëvizja “Vetëvendosje” këtu në Kuvend se rruga që e zgjodhi për Agjencinë e Akreditimit, Bordi i saj ishte jo vetëm i gabuar, por edhe i dëmshëm. Gjatë gjithë kësaj situate ministri i Arsimit ende nuk është paraqitur në komision, siç u tha edhe më herët. Ky qëndrim i ministrit është e qartë për Kuvendin dhe deputetët, Qeveria nuk do të përmirësojë këtë proces, sipas sugjerimeve të deputetëve, e veçanërisht atyre të opozitës. Ani pse për herë të parë e sollëm për ratifikim në këtë Kuvend, anëtarët e ri të Bordit nuk u paraqit para deputetëve raporti me të gjeturat dhe shkeljet që e shtyjnë Qeverinë të shkarkonte Bordin e kaluar. Për të regjistruar përnjëmend punën e Agjencisë së Akreditimit, nëse Qeveria ka gjetur shkelje të rënda, e që pa dyshim aty ka, jo vetëm të këtij Bordi, por edhe të atyre më herët rruga e duhur është që ajo së pari t’i dorëzonte në Komisionin Parlamentar për Arsim dhe sigurisht të paraqiteshin në seancë për të gjithë ne deputetët.

Mandej, nëse shkeljet janë aq të rënda, sa përbëjnë shkas për shkarkim, ato duhet pa vonesë të paraqiteshin nga Qeveria në Prokurorinë e Republikës së Kosovës. Vetëm shkarkimi nuk mjafton nëse janë bërë shkelje, duhet ligjërisht të ngarkohen me përgjegjësi, me emër dhe mbiemër, si dhe të dimë se çka kanë bërë ata për t’u shkarkuar. Është e drejtë e çdo studenti që studion në universitet apo kolegji privat të dijë të vërtetën për gjendjen e institucionit ku po studion apo aferat në kurriz të cilësisë së diplomës së tij.

Rrugë për të dalë nga kjo gjendje ka, por a ka kurajë? Kryeministri dhe ministri i Arsimit çdo ditë e më shumë na vë në dyshime, jo vetëm ne si deputetë të pozitës, por tani ky dyshim e ka kapur edhe gjithë opinionin publik. Nuk ka veprim më të dëmshëm se sa të fillosh një nismë antikorupsion, kundër kapjes të një institucioni që garanton cilësinë dhe ta lësh në mes, duke formuar një version të ri të kapjes së institucionit. Nëse nuk e keni këtë kurajë, lërjani Kuvendit të vendosë për gjithë këtë proces dhe kështu nuk i keni, edhe ashtu-kështu nuk i keni votat për ta kaluar këtë nismë tuajën, e cila sa është e paligjshme, është aq edhe vetëdemaskuese. Dhe, në fund, me shpresë për ditë më të mira për arsimin, shfrytëzoj rastin të gjithë mësime të t’ua uroj Ditën e Mësuesit, 7 Marsin, dhe kërkojmë që mësime të t’u kthehet dinjiteti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Urime 7 Marsi, Dita e Mësuesit, respekt i veçantë mësuesit të madh Shaban Jasharit në këtë ditë të veçantë të shënimit të Epopesë së UÇK-së dhe Ditës së Mësuesit. Lavdi e përjetshme të gjithë atyre që ranë për vendin me pushkë në dorë, por edhe me ditar në dorë.

I nderuar ministër,

Diskutimin tim do ta fokusoj në atë që është bërë dhe që duhet bërë. Asnjë ministër asnjëherë nuk e kam shikuar si emër të përveçëm, por si institucion dhe punën e tij dhe të dikasterit që udhëheq në vazhdimësi jam munduar ta vlerësoj me rezultate konkrete të punës.

Në asnjë rrethanë, asnjërin prej jush që keni marrë përgjegjësi udhëheqëse, nuk justifikoheni me atë nëse deklaroni qoftë në shëndetësi, në arsim, apo në ndonjë sektor tjetër se keni marrë një sektor problematik dhe prandaj ka vështirësi, sepse një herë duhet ta bëjmë skanimin, pastaj duhet të bëjmë edhe një vlerësim, e pastaj të bëjmë veprime. Sepse, askush nuk ju ka detyruar që të merrni përgjegjësi të tilla udhëheqëse, domethënë kur po është çështja e emërimit të ministrave, të gjithë po ngarendin të bëhen ministra, e pastaj po fillojnë të ankohen se kanë marrë ministri me probleme. Pra, me dëshirë i keni marrë që t'i udhëhiqni dhe t'i zgjidhni, e jo për të krijuar probleme të reja. Pra, është deklaruar që keni gjetur një ministri me probleme dhe sigurisht që arsimi ka probleme, por ka pasur edhe probleme më të mëdha.

Kur jemi në Ditën e Mësuesit, ka pasur paga të mësimdhënësve, të cilat kanë qenë në asistencë sociale me nivelin e tillë. Kemi pasur deri në vitin 2008 dhjetëra shkolla kontejnerë, kemi pasur dhjetëra shkolla në prag të rrënimit. Prej vitit 2008, ajo që i takon ta bëjë një qeveri, e që duhet ta bëjë, është investimi në përmirësimin e gjendjes së pagave të mësimdhënësve dhe përmirësimin, ngritjen e dinjitetit të tyre, si dhe investimet në infrastrukturën shkollore. Dhe, Partia Demokratike e Kosovës prej vitit 2008 e ka bërë një gjë të tillë, janë ngritur pagat e mësimdhënësve dhe është përmirësuar infrastruktura rrugore, por asnjë ministër nuk mund të shkojë të japë mësim në shkolla dhe ta përmirësojë cilësinë ndryshe, përveç në atë që i takon një ministrie ta bëjë, dhe që është bërë. Është bërë edhe një gjë tjetër, është kërkuar që të bëhet testi PISA. Shumë mirë, sepse kam thënë që ne kemi nevojë të dalim përpara pasqyrës sa i përket cilësisë në arsim dhe pasqyra nuk na ka nxjerrë mirë me cilësi në arsim, prandaj janë kërkuar masa që të përmirësohet cilësia në arsim.

Atë që është dashur ta bëjë politika prej vitit 2008 e ka bërë, por të flasim këtu për politizim, kapje të arsimit, partizim të arsimit, mund të themi lirisht se bash asnjë subjekt politik nuk e ka lënë mangut kapjen e arsimit, politizimin dhe partizimin e tij në cilindo nivel që ka pasur përgjegjësi qeverisëse, qoftë në nivelin lokal, qoftë në atë qendror. Bashkë jemi dëshmitarë që bash asnjë subjekt politik në asnjë komunë të Kosovës nuk ka lënë pa e politizuar e pa caktuar drejtorë të shkollave e të çerdheve nga subjekti politik që i ka takuar. Kjo është e evidente, por ka vetëm një dallim, që vetëm Partia Demokratike e Kosovës prej vitit 2008, që ka udhëhequr me këtë dikaster, ka bërë përmirësim të infrastrukturës shkollore dhe ngritjen e pagave dhe të dinjitetit të arsimtarëve. Kjo është më se e vërtetë.

Pasi vitin e kaluar kam qenë në Komisionin për Arsim, më ka rastisur dhe e kam pasur për detyrë dhe obligim që ta përcjell punën e Agjencisë së Akreditimit. Mund të them lirisht, prej asaj

agjencie të akuzuar për korrupsion, marrje ryshfeti, licencim të programeve nëpërmjet mitos, që ka qenë publike, regjistrim të programeve të një kolegji dhe të kolegjit tjetër, thirrja universitete pa e pasur akreditimin si universitete, reklamimi i këtyre universiteteve pa qenë fare universitete edhe nëpër autobusë lokale e ndërurbanë dhe vendosja e një rregulli në këtë sektor.

Jemi dëshmitarë që Bordi tanimë i shkarkuar e ka vendosur një rregull në akreditimin e programeve, dënimin e atyre që kanë përdorur emra pa qenë fare universitete dhe vendosjen e një rregulli, i cili është vlerësuar nga institucionet ndërkombëtare, prandaj brenda një periudhe të shkurtër, jo shumë të gjatë, kemi pasur ngritje të vlerësimit të arsimit të lartë në Kosovë. Vendosja e rregullit të kolegjet private dhe shtimi i numrit të universiteteve publike ka bërë që kjo të vlerësohet nga institucionet ndërkombëtare dhe mendoj se ne do t'i iknim mundësisë, i nderuar ministër, së përjashtimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë nëse do të ishte respektuar institucioni i Kuvendit.

Si do të ishte respektuar institucioni i Kuvendit?

Nëse ju do ta sillnit këtu propozimin për Bordin e ri me emërim dhe vlerësim prej Kuvendit dhe në votim të Kuvendit, nuk do të kishte nevojë të shkarkohej Bordi dhe të merrte penallti e tërë Kosova për shkak të një veprimi të tillë, sepse është në përgjegjësinë e Kuvendit për ta caktuar, e jo të bëhen veprime të tilla të shkarkimit, gjë që pastaj sanksionohet edhe me një përjashtim të Kosovës, e që ka pasoja pastaj afatgjate për të gjithë studentët dhe për gjithë arsimin e lartë në Kosovë.

Pra, kemi pasur mundësi t'i ikim një dukurie të tillë, por që ndoshta nga ngutja, nganjëherë nga dëshira për të bërë më shumë, janë bërë veprime që edhe ju tani i vlerësoni se duhet pezulluar dhe mendoj se duhet studiuar mirë, sepse është në interesin e të gjithëve që Kosova të rikthehet në pozicionin e saj në nivelin e arsimit evropian.

Vendosja e rregullit në programet e akreditimit është më se e domosdoshme dhe të respektohet në formën çfarë ishte duke shkuar, por gjithsesi ne kemi kërkuar nga ish-Bordi i kaluar, që kjo të përcillet edhe me kriteret shtesë që do të kishin ndikuar në akreditimin e këtyre programeve dhe rritjen e cilësisë, në veçanti në zbatimin e ligjeve që ka miratuar Kuvendi i Kosovës, e disa prej tyre burojnë edhe nga rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Ne e kemi miratuar tani më shumë se një vit Ligjin për profesionet e rregulluara dhe ai ligj nuk po zbatohet, sepse ministria ka qenë e ngathtë në zbatimin e atij ligji, e është më se i domosdoshëm, sepse është një monitorim dhe vlerësim i cilësisë në arsim. Konsiderohet një vlerësim i jashtëm, sepse të gjithë ata që i kanë përfunduar studimet në universitetet apo kolegjet private e kanë për obligim për t'i ushtruar ato profesione të rregulluara të hyjnë në provimin shtetëror dhe ai duhet të jetë digjital sipas ligjit, dhe kjo do ta vlerësonte pastaj dhe do ta sillte në

nivel të tillë arsimin privat dhe publik në nivelin e barabartë dhe këtu do të ndihmonim në ngritjen e cilësisë.

Pra, zbatimi i këtij ligji është më se i domosdoshëm dhe respektimi i memorandumeve dhe marrëveshjeve që kanë bërë ministrat paraprakë, të cilat janë në interesin e studentëve, sepse, përveç që është investuar në ngritjen e cilësisë dhe pagave, është zvogëluar edhe kostoja e shpenzimeve për studime për studentët dhe të gjithë studentët e dinë se sa kanë paguar për konvikt për studime, për regjistrim në të kaluarën dhe sa kanë paguar vitet e fundit. Pra, është punuar që të ngrihet cilësia, por edhe të zvogëlohet kostoja e shpenzimeve të studentëve. Edhe pse nuk i shikoj ministrat si emra, por si institucione, po them, i nderuar ministër, vetëm një gjë, ministri i paraprak i Arsimit, Arsim Bajrami, dhe ministrja e Arsimit e Shqipërisë kanë nënshkruar memorandume mirëkuptimi, që sot janë veç në letër dhe nuk zbatohen askund.

Do të duhej të ishte e kundërta, që institucionet t'i respektojnë ato që i kanë nënshkruar ndërmjet tyre për bashkëpunim dhe ky bashkëpunim edhe me shtetin amë nuk është në nivelin e kënaqshëm. Gjithsesi, duhet të punohet pastaj edhe për integrim në sistemin arsimor të Kosovës, aty ku ka pasur vështirësi më të madhe në funksionim dhe integrim të arsimit në pjesën veriore të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekë Berisha e ka fjalën.

BEKË BERISHA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Është gjynah që LDK-ja nuk e ka pasur mundësinë që këto 17 vjet ta udhëheqë Kosovën, se nuk do ta linte arsimin të vinte në këtë derexhe siç ka ardhur sot, por ndoshta në të ardhmen e ndreqim.

Është mirë që ra ky EQAR-i, e ne po diskutojmë për arsimin e lartë dhe për arsimin e Kosovës, në përgjithësi. Po ashtu, konsideroj se është shumë keq që na kanë përjashtuar prej Regjistrimit të agjencive për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë për shkak të zhvillimeve të kohëve të fundit, por sinqerisht nuk mendoj se është fundi i botës që na kanë përjashtuar. Mendoj se fundi i botës do të ishte nëse ne sot pas këtij diskutimi nuk dalim me një pajtim se si do ta trajtojmë arsimin e lartë seriozisht, e jo vetëm arsimin e lartë, por edhe arsimin parauniversitar dhe shkencën.

Arsimi kosovar është shumë keq. I dimë rezultatet e PISA-s, e dimë gjendjen në Universitetin e Prishtinës, e dimë gjendjen e universiteteve të reja, edukimi parashkollor, çerdhet për fëmijë, për fëmijët tanë pothuajse nuk ka hiç, gati 5%. Sot duhet të diskutojmë për Agjencinë e Akreditimit, por duhet të diskutojmë edhe për Ligjin e arsimit të lartë, që është në procedurë që pesë, ose gjashtë vjet. Duhet të diskutojmë edhe për Këshillin Kombëtar të Shkencës. Për shkak të mospajtimeve politike, ne nuk kemi Këshill Kombëtar të Shkencës tani e gjashtë, ose shtatë vjet.

Ekspertët tanë dhe studimet tregojnë se Kosova mbetet larg mbrapa të gjitha vendeve të rajonit në shkencë. Ne çdo vit humbim me milionë euro nga buxheti shtetëror e familjar për bursa të doktoratës jashtë vendit.

Çfarë kemi bërë ne që t'i ndalim këta njerëz që të studiojnë këtu? Ne duhet të diskutojmë çfarë po bëhet me kurrikulat që janë miratuar në vitin 2010, e nuk po lëvizin prej vendit? Ne duhet të diskutojmë për provimin e maturës, cilësinë e mësimdhënësve, e të tjera. Kisha dashur që ne sot të merremi vesh për më shumë sesa për Agjencinë e Akreditimit. Kisha dashur që ne të merremi vesh për fëmijët dhe për rininë tonë.

Unë propozoj që sot ta bëjmë hapin e parë duke i respektuar institucionet, por edhe duke reaguar në situatën e rëndë në arsim. Prandaj, propozoj ta formojmë një komision të përzier nga ekspertët më të mirë të Kosovës, që t'i propozojnë masat për kthimin e Kosovës në EQAR dhe t'ia dërgojmë një sinjal pozitiv popullit, së pari, e pastaj Evropës që mund të merremi vesh për interesin e fëmijëve tanë. Pas kësaj, ministria duhet urgjentisht të dalë me një plan emergjent për ta trajtuar gjendjen në sektorët që i përmenda më lart. Nuk ka kohë më për t'u sjellë duke u nisur nga interesat e ngushta, personale e partiake. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar i Parlamentit!

E nderuar Qeveri,

Gjithmonë kryetar, se kryetari po vjen e po ikën.

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër dhe ministra,

Dëshiroj ta filloj fjalimin tim në radhë të parë, pasi është Dita e Mësuesit t'i falënderoj krejt nënat tona që në mungesë të çerdheve na kanë edukuar deri në klasën e parë fillore, domethënë ato për mua kanë qenë mësueset më të shtrenjta.

E dyta, e dëgjova një kolege deputete që në përshëndetjen e saj tha, "i përshëndes ata mësues të ndërgjegjshëm". Do të thotë, hera e parë që po dëgjoj se paska edhe mësues të pandërgjegjshëm. Kam pas dëgjuar, kur kam ardhur pas luftime se ka gazetarë profesionistë, unë kisha dëgjuar që ka gazetarë "freelance", e që ka gazetarë profesionistë dhe joprofesionistë këtë e kisha dëgjuar vetëm në Kosovë.

Tjetra? E dëgjova një kolege nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për çka unë e përgëzoj debatin e thirrur sot edhe nga LDK-ja, edhe nga "Vetëvendosja", sepse është debat i domosdoshëm, por ajo në kritikën e saj e kritikoi kryeministrin, tha që "po i tuten ministrat, se kryeministri është muskolor, po ju thërret atje të mos vonoheni në punë..." Unë nuk mendoj që Kryeministria dhe

Zyra e kryeministrit janë arena ku njerëzit rrihen boks, por është arenë ku duhet të respektohet orari i punës, disiplina e të gjitha.

Që është bërë një hap i ngutshëm në këtë punë, pajtohemi të gjithë deputetët, por edhe po të mos pajtoheshim, pajtohemi unë me vetveten time, që Bordi nuk është dashur të shkarkohet. Që ka qenë një bord politik, një bord kriminel, një bord që u ka marrë për licenca qindra e mijëra euro njerëzve, edhe këtë të paktën, në rast se ju nuk e dini, se ka mundësi që dikush nga deputetët ka qenë ‘mësit’ i këtyre punëve, ndërmjetësues, edhe këtë e di fort mirë që ka ndodhur ashtu. Se pajtohemi me fjalën e Bekim Haxhiut 100%, që kush keni mundur, kush është çuar i pari jeni munduar të vendosni drejtorë politikë në shkolla, në universitete, në borde, për ta sakatuar arsimin, kjo është shumë e vërtetë.

Në planin kombëtar, gjithmonë stafetën e shokut Tito nr. 1 e bart Partia Demokratike e Kosovës, ndërsa stafetën për të mos i rënë asnjëherë nga dora e ka bartur Lidhja Demokratike e Kosovës. Ia ka mbajtur ‘zhagun’ gjithmonë PDK-së, me borde, me të gjitha. Pastaj, ne të tjerët u kemi shkuar mbrapa nga pak, aq sa kemi mundur të vrapojmë, edhe AAK-ja, edhe “Nisma”, ndërsa prijatarë dhe kampionë të kësaj stafete në Komunën e Prishtinës kanë qenë Lëvizja “Vetëvendosje”, e cila i ka vendosur të gjithë drejtorët e shkollave politikë, veç ku s’ka mundur, se e kanë pas zënë rendin të tjerët. Po, po, flet ti, hiç mos ta ndien, unë s’po flas, unë s’po them ti e ke çuar ndonjë drejtor, po unë ju jap edhe fakte, edhe argumente, edhe emra, ku i keni çuar drejtorë politikë, duke filluar nga shkolla “Faik Konica” e deri te shkolla “Ismal Qemali”, e te shkolla e Dardanisë, e të tjera, e të tjera...

Domethënë, krejt këto punë i keni bërë, dhe tash njeriu politik, i cili ka qenë Blerim Rexha, zëvendësministër, njeri i vendosur nga politika, në vend se të kritikojë brenda institucioneve, u çua e ka bërë një letër atje, sepse kjo është sëmundja patologjike e një pjese të madhe të deputetëve dhe politikanëve që kur të shkojnë te ambasadat e huaja, kur rrinë me institucione ndërkombëtare, atje veç duhet sharë vendin e vet, qeverinë e vet, ministritë, ama pse janë pjesë të krejt kësaj katrahure kurrë nuk tregojnë. Po të kishte treguar Blerim Rexha se ka qenë zëvendësministër dhe ka qenë deputet e kandidat për deputet i Partisë Demokratike, ne sot nuk e kishim thirrur fare këtë seancë. Po ai s’ka treguar. Ai ka thënë jam i pavarur, jam kështu, e kështu, e kështu... dhe të vërtetën nuk e ka thënë fare.

Sa i përket Lidhjes Demokratike të Kosovës, për t’u ndërlidhur me deputetën, e cila i tha dy gjëra për ministrin tonë të Arsimit, e para tha që po të ekzistojë kodi moral ky duhet të japë dorëheqje, e unë po them që ai kod nuk ekziston në Kosovë, as në Shqipëri, as në Serbi, as në Maqedoni, as në Bosnjë, e as në Mal të Zi, sepse po të ekzistonte kodi moral i dorëheqjes, 80% prej ne deputetëve s’do të ishim hiç ulur këtu. Pse nuk ishim?

Sepse, ju deputetët e kaluar, duke përjashtuar deputetët e rinj, ju e keni lënë vendin pa ligj për nivelimin e pagave.

Ju e keni lënë vendin pa ligj të arsimit.

Ju e keni lënë vendin pa ligj të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ju e keni shkelur me të dyja këmbët Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, të nënshkruar më 17 dhjetor 2012, nga kryetari Jakup Krasniqi, për nivelimin e rrogave të bordeve dhe anëtarëve të bordeve të agjencive brendapërbrenda Parlamentit të Kosovës.

Krejt këto i keni bërë e pastaj ulemi këtu, flasim për moral dhe themi inshalla këtë sallatë të prishtë e hanë ata që po na dëgjojnë nëpërmes ekranit televiziv.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Po e përfundoj fjalimin tim me një diçka, pse unë nuk jam fort optimist se ne edhe pas kësaj seance të jashtëzakonshme do të merremi vesh. Nuk jam optimist, sepse shumica e njerëzve tanë e përdorim gazetën dhe fletët e librave për t'i fshirë xhamat dhe për ta fshirë tavolinën e qelqit, e jo për lexim. Ndërsa, fatin tonë kolektiv e shohim duke shikuar fall në filxhanin e kafesë, e duke shikuar çfarë thotë zonja Meri. Prandaj, të kthjellemi pak se ata që shikojnë fatin e popullit të vet në filxhan e i fshijnë xhamat me gazeta e me fletë të librave, kanë jo perspektivë të ndritur, po perspektivë të zymtë.

Hajde ulemi bashkë, të gjithë bashkë dhe nxjerrim konkluzione, e nxjerrim një rezolutë se si të kalojmë nga kjo situatë dhe të propozojmë bashkërisht, të gjitha partitë politike, me të vërtetë njerëz profesionistë, por jo apolitikë, se s'ka në Kosovë asnjë njeri që s'është politik, s'keni për të gjetur në mënyrë absolute, por t'i propozojmë njerëzit që kanë dinjitet, që kanë përgatitje akademike dhe që nuk na turpërojnë dhe ta rregullojmë sistemin e arsimit.

Ndërsa, edhe një herë më lejoni nga kjo foltore t'i bëj thirrje kryeministrit të Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, dhe zëvendëskryeministrit, zoti Fatmir Limaj, ju lutem, në buxhetin e ardhshëm investoni në çerdhe të fëmijëve, sepse po të rriteshim ne në çerdhe nuk do të kishim ardhur në këtë nivel. Po të rriteshim ne me moshatarët tanë, nuk do të kishim debate që veç hajt ne të çohemi e të debatojmë diçka kundër LDK-së, hajde të çohemi të debatojmë kundër "Vetëvendosjes", hajde të debatojmë t'i bllokojmë, qysh e bllokuam javën e kaluar rezolutën tuaj pa kurrfarë arsyeje, që profesori Avdullah duhet të na kërkojë falje ne "Nismës", se ne e votuam, por nuk ka rëndësi. Por, po dua të them, hajde merremi vesh për gjëra të mëdha, si arsimit, shëndetësia, politika e jashtme, mbrojtja e territorit, ushtria, janë gjëra tonat të përbashkëta. Ato divergjencat tona politike, pastaj grijmë sallatë deri në mëngjes dhe kurrkush s'e ha atë sallatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për informim, Miliam, kryetarët e komunave i caktojnë drejtorët, është kompetencë e tyre. Kështu që nuk është vetëm çështja e Prishtinës, janë gjithkund ku ka drejtorë dhe ajo parti që e ka pushtetin realisht i ka të paktën 80-90% të drejtorëve të emëruar. Zoti kryeministër e ka kërkuar fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues, zoti Xhavit Haliti,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Medie,

Qytetarë të vendit,

Seanca e sotme e ka një kronologji, burim pra, shërr është krejt te shkarkimi i Agjencisë së Akreditimit. Po duket se ka qenë më kiamet sesa të shpërndahej ky Parlament fakti që u shkarkua ajo agjenci, të paktën ashtu po del sipas krejt çka po shoh unë.

Unë ju kam thënë në këtë seancë, po ju them edhe sot, s'janë shkarkuar ata njerëz pse i kanë emrat ky apo ai, as pse disa janë të Kosovës e disa janë të huaj. S'janë shkarkuar pse janë të një partie, a të asaj partie, a për inat të asaj partie. Janë shkarkuar se ju kam dëgjuar juve, bash gjithkënd, të të gjitha partive, edhe të partisë në pushtet, duke u ankuar për gjendjen në arsimin e lartë. S'ke mundur të hysh diku e të flasësh me dikë pa thënë "burra, keq është puna". Nuk ke pasur medie, analist, njeri të gjallë mbi këtë dhe që s'i ka dhënë vetes të drejtë të tregojë sa keq e kemi gjendjen në arsim. "E kemi mbytur arsimin, e kemi kriminalizuar, e kemi korruptuar, e kemi korruptuar të ardhmen, e kemi bërë këtë, e kemi bërë atë, e kemi bërë krejt". Non-stop i kemi dëgjuar këto. U shkarkua ky bordi, u kthye në temë të çfarëdo natyre të doni. Mosni, mos i mundoni e mos i torturoni fëmijët e Kosovës, studentët, se ne llogaritë politike i lajmë, këtu jemi, e kemi për t'i larë tërë jetën. Dikush i ka larë disa, e dikush i lanë më vonë, po mos i merrni më qafë fëmijët e Kosovës.

Blerim Rexha, që po flisni për të, është një hajn ordiner. Pse është hajn ordiner Blerim Rexha, ju tregoj unë. USAID-i është tërhequr prej Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, atëherë është quajtur KTA, e kanë thënë derisa të jetë ky njeri në bord nuk rrimë në bord se është i korruptuar. Këtë e di krejt Kosova! Nëse s'ju mjafton kjo, pyetini amerikanët, pyeteni Agjencinë e Privatizimit. Pse po shitni moral të rrejshëm?

Nëse duam të bëjmë lojëra dyfytirëshe, i bëjmë burra, bash kush të doni e kur të doni. Ju kam thënë edhe më herët, nuk i kam dy fytyra. Një e kam! Pse s'po keni guxim qytetar ta tregoni këtë? Kjo është e vërteta. Pyeteni Blerim Rexhën, ju vetë pyeteni, a e ka lëshuar? Atëherë nuk është quajtur Agjencia Kosovare e Privatizimit, por është quajtur KTA. A e ka lëshuar USAID-i, amerikanët janë çuar e kanë thënë "sa të jetë ky njeri, s'rrimë këtu". Pse? Sepse është i korruptuar, kështu kanë thënë. Ose kanë rrejtur atëherë ata, e ky ka qenë i ndershëm, ose diçka paska bërë vaki.

Pse u bë kaq kiamet që u shkarkua një njeri. A bën ta di, vëlla? Kujt është kah i dhemb? Kujt është kah i mungon diçka? Nëse është kah ju mungon profiti, a paratë, a çka do qoftë që ju ka dhënë ai njeri i korruptuar, kallëzoni burra! Po më duket u paska dhënë të gjitha partive, se këtu krejt jeni bërë bashkë, me “Vetëvendosje”, me LDK, me AAK, me PDK, me “Nisma”, krejt që ta mbronin një agjenci. Ku është problemi juaj, s’po ju kuptoj? A po doni arsim më të mirë? Paskam gabuar që e kam hequr, se në të vërtetë nuk e kam hequr as për atë rast. As nuk ka lidhje ajo punë. Paskam gabuar që e kam hequr! A doni ta përmirësojmë gjendjen, a doni t’i mbytim fëmijët? A doni t’i japim përkrahje atij që po shkon, e po bën “davë”, ne kemi thënë “davë” te mësuesi”, të shkojë të bëjë davë atje në agjencitë e huaja “se sa e keqe është Kosova”.

A kesi patriotësh qenkemi ne a? Po, jo bre vëllai im po të jetë, motra ime, kur i merr në qafë fëmijët e Kosovës, jo pse e kam të partisë, ulu një herë, i them, unë e zgjidh problemin nëse të është bërë e padrejtë, po s’ke të drejtë t’i marrësh në qaftë fëmijët e Kosovës.

Pres prej atyre që janë përgjegjës t’i ndalin njerëzit që po e marrin në qafë Kosovën, prej një gabimi të mos i bëjmë dy, prej dy, të mos i bëjmë tre. Hiq s’e kam matur, s’kam këqyrur kush është në atë listë, as s’kam pasur problem me asnjërin prej tyre. Por, hiq pishman nuk jam, bile po e shoh që paskësia bërë mirë pse erdhi puna për shkak të asaj të na heqin prej EQAR-it, do të na heqin nesër prej ENQA-së, paska mundësi për ndonjë luftë civile në Kosovë, se kështu po e bëni punën, kështu po doni ta sillni. A po doni të dilni, po.

Shikoni, unë disa herë kam diskutuar me ministrin, Nuk po them se ministri është duke e kryer punën më së miri, as unë, po në agjendë t’i mbysim fëmijët tanë, t’i lëmë pa diploma të njohura në Evropë nuk kemi. Ne nuk u ndihmojmë në këtë agjendë, nëse është nevoja, të gjithë japim llogari, unë jap për gabimet e mia, ministri për të vetat, gjithkush për veti, po s’e kemi agjendën t’i lëmë fëmijët jashtë, mos i leni as ju.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë nuk do të ndalem me deklaratat e disa prej deputetëve këtu, sepse besoj që vetë mënyra si ata flasin, tregon dhe dëshmon shumë.

Por dua të përsëris qëndrimin tonë, ne nuk kemi amnistuar askënd, për më tepër kemi kërkuar që këtu të raportohet për veprimet e secilit prej kandidatëve që kanë bërë shkelje nga ata që janë shkarkuar.

Dhe, po rikujtoj për ata që mund të harrojmë se është obligim ligjor i secilit person, sidomos i deputetëve që bëjnë këtu paraqitje publike dhe akuzojnë persona për ndërmjetësim apo për

veprime kriminele, qysh u përmendën këtu, marrje të miliona eurove, që e kanë obligim që këtë ta paraqesin përpara organeve të rendit dhe drejtësisë.

Ndërsa, sa i përket çështjes së Komunës së Prishtinës, meqenëse vetë kam qenë drejtoreshë e Arsimit në Komunën e Prishtinës, mbaj përgjegjësi për periudhën sa unë kam qeverisur në atë drejtori dhe garantoj për kritere të përcaktuara saktë dhe për respektim të procedurave ligjore.

Nuk dua të marr këtu kohë me këtë pjesë, po secili që është i interesuar mund të bëjë pyetje për këtë çështje, mund të më shkruajë për secilin detaj dhe do t'ju jap përgjigje për secilin rast individualisht.

Është e pandershme të shfrytëzohet foltorja e Kuvendit për të shtyrë agjenda personale me deklarata të pavërteta.

KRYESUESI: Faleminderit! Ti po të kishe qenë e zonja, e kishe punësuar motrën tënde, e ke lënë pa punë.

Kundër-replikë ka zoti Zeka.

MILAIM ZEKA: Unë, zoti kryesues, nuk përmenda emra, po në një xhami një hoxhë thoshte: “Po vini të faleni, e tu dalë po i vidhni këpucët e shoqi shoqit”. Njëri tha: “Në më pafsh në xhami, baba hoxhë, mirë ma bëfsh”. U zbulua vetë.

Kjo Nagavci, këtyre herë Komiteti Qendror i Lidhjes Komunistëve të Jugosllavisë shoku Tito i marrke kuadrat e fuqishme prej Prishtine atje, kjo prej Gjakovës ka ardhur në Prishtinë dhe bash kjo e ka shkatërruar sistemin arsimor në Prishtinë dhe bash kjo ka vënë me njohësi drejtorë nëpër shkolla dhe jam e lumtur që kjo vetë tregoi, kështu që hiq nuk ka problem.

Mënyra se si flasim është e ndryshme, sepse edhe ndryshe i kemi shenjat e gishtave, ndryshe e kem mendimin dhe ndryshe e kemi edhe erën e trupit.

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Po parlament është! Zoti Avdullah Hoti e ka fjalën. Kjo e bëri replikën, ai ka të drejtë në kundër-replikë dhe me kaq mbyllet.

AVDULLAH HOTI: Kryesues,

Unë po vërej që nuk është hera e parë që në raste të interpelancave, të debateve që ngremë si grup parlamentar, kryeministri është tejet i ngarkuar sa që del në foltore gjithmonë i dhemb diku, drejtohet me shprehje besoj që nuk e kanë vendin këtu.

Në fjalimin tim, si kërkues të këtij debati, asnjëherë nuk e kam përmendur as pse i ka shkarkuar, as s'kam përmendur emra të përveçëm, as s'i kam përmendur pse ka sjellë emra të caktuar, sepse nuk është brengë jona. Brengë jona është që Kosova për tre muajt e ardhshëm është e suspenduar nga ky organizëm ndërkombëtar i cilësisë në arsimin e lartë, ky është problemi.

Problem për neve është edhe procedura se si po menaxhohet arsimi.

Ministri i Arsimit në këtë rast po merr vendime i urdhëruar nga kryeministri, kjo është problematike në një sistem demokratik parlamentar të funksionimit të ligjit dhe të rendit.

Ne nuk jemi të shqetësuar kë e sjell nesër ministri prapë për Bord të kësaj Agjencie, as nuk jemi të shqetësuar kush ka qenë në Bordin paraprak, ne jemi të interesuar për rend dhe ligj edhe për cilësinë në arsim.

Ky është qëllimi i këtij debati parlamentar. Unë e lus kryeministrin që ta lirojë veten nga ato ngarkesa të shumta që i ka karshi kërkesave që ne i kemi në këtë Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Po e shoh rrjedhën e debatit në Parlament, e shoh që interpelanca është një instrument që shfrytëzohet nga opozita për qëllime të caktuara, krejt korrekt. Nuk kam asnjë vërejtje, procedurat e kanë paraparë, nuk jam më eksperti i debatit këtu, kur kam qenë në Parlament, nuk kam qenë aç aktiv ose me pauza.

Ka diçka që unë po ashtu e shoh, një pjesë e madhe e kohës pikërisht këtu është kah shkon fals, është kah shkon pa efekt, po thirrni interpelanca sa të thoni që po bëni opozitë, me gjasë ti Avdullah je i interesuar të bëhesh kryetar i LDK-së, je shef i Grupit Parlamentar dhe e ke këtë arenë këtu ku tregon kush je. Disa kolegë tuaj të LDK-së kanë arenë tjetër, unë po e shoh që është ajo klimë, të uroj fat, vëllai im, nuk kam problem, cilido që të bëheni, urime! I shoh edhe lojërat e tjera politike, po i kuptoj qysh po vijnë. Mirëpo, ka diçka që është kah më dhemb, kjo është tjetër send.

Unë nuk i kam thurur lavde vendimit tim për shkarkim të kësaj Agjencie, kurrë s'kam dalë të lëvdohem, thua se e kam bërë kiametin, e kam bërë një vendim, ndoshta edhe dy a treve u është bërë e padrejtë në atë Agjenci, beso që s'e di cili është cili. Po gjendja në arsim e keni vlerësuar të gjithë shumë të keqe, ata që keni qenë në pushtet kurrë s'keni dalë të lëvdoheni, opozita e ka kritikuar, nëse paska qenë farë dhënie e mundësisë shkarkimi i kësaj Agjencie, Qeveria u ndërrua, u ndërrua ministria, u ndërrua një Bord, të japim një mundësi, nëse këtë e paskësua bërë dhe për këtë s'po mund të shkojmë përpara në tema të tjera, si pozitë, si opozitë, jeni bërë

bashkë, për marre të Zotit. Nuk e kam ditur që kam bërë kaq kiamet të madh atë kohë. Po e shoh që po doni ta shfrytëzoni.

Jam habitur edhe me “Vetëvendosjen”, jam çuditur, çfarë keni, a ju ka mbetur merak pse i shkarkova ata për të cilët jemi ankuar të gjithë se diçka nuk është mirë në arsim. Po u japim mundësi të tjerëve, gjeni ndonjë të këtyre që janë emëruar, që është Aleanca, që ka ndonjë interes a çka do qoftë për ta. Këtu s’i kemi pruar në Parlament, nxirrni në Parlament një ditë, votoni a rrëzoni, thoni s’po duam t’ia pranojmë Qeverisë këta. Keni të drejtë, bimë propozime të tjera. Po shikoni, çka është duke ndodhur sot, edhe pse jam i nervozuar, Avdullah, nuk jam prej ngarkesave, po ka diçka që më nervozon, se më dhimbsen fëmijët e këtij vendi, ajo që po të dhembë edhe ty që po thua që s’po u njihen diplomat.

Kjo farë loje politike duke u ruajtur që hajt se s’po prishem me Blerimin a me atë, a me këtë, e ka sjellë punën dikush t’i japë vetit të drejtë të ankohet në institucione ndërkombëtare që të përjashtohet Kosova, kjo është ngjashëm si të mos lihet Kosova të hyjë në UNESKO, në Interpol, si të humbë ndonjë njohje, kjo logjikë është, këtë dikush po e toleron brenda nesh.

Nuk është mirë, besoni, s’e kam që jam në pushtet, po e kam pse nuk është në rregull, duhet thënë njerëzve deri ku mund të shkohet, deri ku jo.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, po ky bëri kundër-replikë, tash unë nuk kam, dy herë për një çështje, mund të diskutosh, por replika të dyfishta nuk ka, nuk ia dhashë as zonjës atje. Mirë, mirë, ky ta ka përmendur, replikë, ti ia ke përmendur pak më ndryshe, të mos e shkelim Rregulloren. Fjalën për të diskutuar ta jap, se ke të drejtë si deputet të diskutosh, se ke diskutuar veç si sponsorizues, për të replikuar e keni krye të dytë, replika dhe kundër-replika, nuk e kemi të rregulluar kështu. Jo, më fal.

Fjalën e ka zoti Lumir Avdixhiku. Avdullah, merre fjalën, keni të drejtë të diskutoni si deputet, po jo replikë.

AVDULLAH HOTI: Hajde, të lutem, se nuk ka kuptim kështu, është e drejtë imja.

KRYESUESI: Jo, ka kuptim, se unë jam duke e udhëhequr seancën, jam duke e respektuar strikt Rregulloren.

AVDULLAH HOTI: Të shpresojmë tash e tutje. Mirë, faleminderit!

Unë prapë po e dëgjoj kryeministrin dhe me atë që prapë tha tash në foltore, ai po më jep të drejtë plotësisht. Ai e ka hallin me LDK-në, LDK-ja sot është paria kryesore më e madhe në vend, edhe ditët e tij në atë karrige janë të numëruara, këtu e ka hallin ai. Nuk e ka hallin pse Avdullahu po kërkon edhe Grupi Parlamentar vazhdimisht interpelanca, ky i sodit është debat,

për informim të tij. Ai nuk mundet me fjalime të tilla të zhvendosë debatin tek emrat e përveçëm, sot debati është ftuar për veprimet e tij që e kanë përjashtua praktikisht Kosovën nga një mekanizëm i rëndësishëm evropian dhe shpejt mund t'i lëmë studentët jashtë tregut evropian të arsimit të lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash e nisët, replikë, ai edhe një herë kundër-replikë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Të gjithë pushtetarët e kanë hallin e karriges. Besoj, ata që kanë qenë në pushtet e dinë, Avdullahu e di, se ka qenë po ashtu pushtetar, këtu nuk po hyjmë në debat se s'ka lezet, edhe partitë që e kanë hallin e njëra-tjetrës, po ashtu e kanë çdo herë, në atë hall janë disa mënyra si menaxhohet ai hall, ka diçka personale, unë di diçka personale, t'i bie diçka Avdullah, po shihet që bie diçka personale, në debat secili prej nesh ka diçka personale. Unë e kam një hall, e tashti besoj ia qëlllove për mua. A bën të të pyes a ia qëlllova unë për ty, për këtë kandidaturën tënde, a është ashtu? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Glauk Konjufca. Glauk, Avdullahu ka kundër-replikë, një minutë.

AVDULLAH HOTI: Sa herë që po del kryeministri aty në foltore, po më jep plotësisht të drejtë në ato qëndrimet që i kam, ai e ka hallin me LDK-në, LDK është parti kryesore, është duke i determinuar të gjitha rrjedhat politike në vend. Këtë e ka hallin, unë s'mund t'ia heq këtë hall, edhe disa ditë mund të vazhdojë me detyrën e tij, dhe e ftoj që për ditët e mbetura në pushtet t'u shërbejë qytetarëve të Kosovës sipas ligjit me nder dhe me përkushtim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Këtu më herët prej një deputeti që është Milaim Zeka, me që jemi në Ditën e Mësuesit e ngriti problemin se a ekzistojnë në Kosovë mësuesit e pandërgjegjshëm. Unë mendoj që shumica e mësuesve në Kosovë punojnë me nder dhe me përkushtim. Mirëpo, ndonjë mund të jetë i pandërgjegjshëm, për shembull, si ai mësuesi i Milaimit që ia ka qitur këtij dysh e nuk e ka ngelur, e ky duke marrë dysha kështu ka ardhur deri në Parlament të Kosovës.

Kështu që me të vërtetë unë megjithatë mendoj që ka ndonjë mësues të pandërgjegjshëm në Kosovë, prapëseprapë.

Këtu po flasim ne se çka ka ndodhur realisht me vendimin e Qeverisë për ta përjashtuar Bordin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Mirëpo, unë kësaj radhe dua t'i qasem problemit nga një dimension krejtësisht tjetër, nga çka dëgjuam këtu, sepse po mendoj që ndonëse ky është një problem shumë i madh, duhet ta kapin

nga dimensionimi i tij bazik i problemit të arsimit në Kosovë, sepse po frikësohen duke debatuar kështu mos po e krijojmë përshtypjen artificiale se arsimi është shumë mirë, e me këtë vendim kryeministri apo Qeveria Haradinaj e prishi këtë drejtim të duhur të arsimit në Kosovë. Nuk është ashtu! Për shkak që ne e dimë shumë mirë se gjendja e arsimit në Kosovë është fort e keqe, çka ka bërë vendimi i Qeverisë Haradinaj është sikur ajo shprehja në anglisht që është “from bad to worse” që thonë, që i bie, s’po di qysh ta përkthej në shqip, po i bie sikur “prej të keqes, drejt katastrofës”. Ky vendim është asi, mirëpo nuk domethënë që ishte arsimi mirë dhe e ndërroi drejtimin.

Kam dëgjuar edhe nga ndonjë naiv, për shembull, që thotë që PISA nuk e ka vlerësuar arsimin e lartë, kështu që arsimi i lartë nuk është si ai mesëm dhe ai fillor. Po, ashtu qysh është shkolla fillore, pashmangshëm e kemi edhe shkollën e mesme, ashtu qysh është shkolla e mesme, pashmangshëm e kemi edhe universitetin. Është absurde dhe e pamundshme të mendohet se shkollën fillore e kemi keq, ama të mesmen e kemi të shkëlqyeshme. Apo që shkollat e mesme i kemi keq, por universiteti është krejt ndryshe. Kjo është sikur të themi matematikën nuk e di, por në fizikë jam i shkëlqyeshëm. Arsimi është një entitet kompakt, ku secila hallkë e sistemit është përgjegjëse për hallkën tjetër dhe në përgjithësi, të gjitha hallkat e sistemit i kemi keq. Pse po e konstatoj këtë? Sepse, ju e dini, në vitin 2014 rektori i Universitetit të Prishtinës pati dhënë dorëheqje. Dorëheqjen e pati dhënë për shkak të protestave dhe pakënaqësive të shumta nga shoqëria civile së bashku me qytetarët dhe studentët në krye, të Universitetit të Prishtinës, të cilët patën zbuluar se i pari i universitetit, ai që është përgjegjës për mbarëvajtjen e politikave në universitet, vetë ai titullin akademik, me të cilin ishte edhe profesor, e kishte ardhur si rektor pastaj, e kishte fituar në mënyrë të rrejshme, përmes kriterëve akademike të gënjeshtërtë.

Shikuar hollë-hollë, këtu është problemi esencial i arsimit të lartë në Kosovë, ky është problemi esencial. Kemi një mori të njerëzve, të cilët japin mësim në Universitetin e Prishtinës, në arsimin e lartë dhe nuk mund t’i mbështesin me kriterë shkencorë titujt akademikë, në të cilët janë të thirrur dhe të cilët ua mundësojnë t’i ushtrojnë ato pozita publike si profesorë në Universitetin e Prishtinës, meqenëse po flasim për universitet publik këtu, ata rrogat i marrin prej shtetit të Kosovës, prej buxhetit të Kosovës.

Një organizatë në universitet që vepron, e cila quhet “Organizata për Cilësinë e Arsimit” në dhjetor, para tre muajsh, na e dha një konstatim shumë tragjik për Kosovën. Vetëm 28% e profesorëve në Universitetin e Prishtinës, nëse i shikoni rregullat standarde akademike, vetëm 28% i meritojnë titujt shkencorë. A e dini çka domethënë kjo për arsimin dhe a e dini çka domethënë kjo për shtetin e Kosovës dhe për arsimin e lartë? Kjo është një e keqe e pallogaritshme, njerëzit nuk janë të merituar në pozitat që i mbajnë dhe i mësojnë studentët. Janë persona kyç në pozita të transmetimit të dijes dhe të orientimit të dijes, tjetra në Universitetin e Prishtinës ka plot plagjiaturë. Njerëzit, pra, ngritën në tituj të tyre shkencorë përmes mashtrimit, duke gënjer dhe duke mashtruar.

Ky është problemi esencjal i arsimit, mendoj unë dhe këtu Kosova ka ardhur për shkak të politikave të Qeverisë. Këtu të themi jo vetëm e kot, por shumë keq të mendojmë që Ministria e Arsimit është për të ngritur pagat dhe për të shtruar rrugë, apo për të ndërtuar objekte. Ministria e Arsimit duhet të ngrejë cilësinë e arsimit dhe të rregullojë nivelin e arsimit në Kosovës, kjo është detyra primare. Këtu kanë dështuar të gjitha Qeveritë e Kosovës deri tash dhe, sa i përket Agjencisë së Akreditimit, kjo ka pasur problem me ligjin gjithmonë. Para asaj të parafundit, ju e dini që tre anëtarë të Agjencisë së Akreditimit kanë përfunduar në bankat e drejtësisë. Pse? Për arsye që kanë marrë shumë para për shkak të shpikjes së programeve të reja akademike, për shkak të presionit dhe parave dhe të grupit të interesit apo të universiteteve private dhe shumë kollaj aty ka qenë një universitet privat të shpikë dhe të themelojë një program të ri akademik, duke qenë që mbropa tij ka qëndruar edhe ryshfeti.

Kështu që, ne nuk mund të mburremi fare me këtë Bordin e kaluar shtetëror të cilësisë, po kryeministri ka trokitur në derën e hapur. Kurrkush nuk është duke e mbrojtur Blerim Rexhën, ne e dimë fare saktë, edhe ai bile shumë hapur e ka thënë që është zyrtar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka qenë edhe kandidat në listën për deputetë të Partisë Demokratike me numër 83 në listë, domethënë këtë të gjithë e dimë. Edhe ka marrë pjesë në Këshillin Drejtues të Partisë Demokratike, domethënë është një figurë e Partisë Demokratike. Këtu çështja është që kjo nuk shikohet kur të merren këto vendime përmes individit, sepse Kosova ka pësuar këtu, është larguar prej një agjencie, e cila është kompetente për rregullimin e cilësisë në Evropë, në Bashkimin Evropian dhe këto standarde të arsimit sot në Evropë janë të rregulluara. Nëse doni të shkoni andej, nuk mund të bëni kesi veprimesh, të ndodhin kesi konsekuenca dhe të thoni “nuk u bë kiameti”.

Nuk jemi këtu që të bëjmë debate për kiamet, këtu jemi që të bëjmë debate për gabime të Qeverisë. Gabimet e Qeverisë nuk janë kiamet, gabimet e Qeverisë janë gabime, të cilat duhet të ndëshkohen dhe për këto duhet të diskutohet. Për këtë arsye jemi ne në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e ky pos që ishte një gabim, pos që ishte trashanik dhe po ashtu nuk ishte gabimi as i parë e as i fundit i kësaj qeverie. Ministri ka thënë shumë qartë në prononcimet e veta që ai nuk është përgjegjës ose së paku po mundohet t’ia krijojë vetit një hapësirë për amnisti nga veprimi i tij. Sa herë ky ministër të marrë fjalën thotë që ka qenë i detyruar nga kryeministri që ta marrë një vendim të tillë, kryeministri ia ka kërkuar vendimin. Kështu që kryeministri është mirë që të na e shpjegojë përgjegjësinë e tij të drejtpërdrejtë lidhur me këtë proces.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tash kryeministri me siguri ka këshilltarët e painformuar ose vetë është i painformuar, por po të informohej mirë, do ta kuptonte që seanca e sotme s’është interpelancë për kryeministrin, por

është debat parlamentar dhe si debat parlamentar, ne ushtrojmë të drejtën tonë që të diskutojmë edhe për çështjet më bazike për Kosovën, edhe më tepër kur këto çështje kanë të bëjnë me arsimin, sektorin më të degraduar në vend.

Dhe, po qe se kryeministri të ishte në seancë prej fillimit, do ta dëgjonte dhe zotin Hoti për arsyetimin që e ngritëm si grup parlamentar dhe do t'i dëgjonte edhe pasojat që mund të na vijnë nga vendimi në fjalë, do t'i dëgjonte edhe rekomandimet që i bëmë si grup. Por, ardhje-daljet e kryeministrit natyrisht që nuk lënë hapësirë për debat të shëndoshë dhe normal, dhe mbi të gjitha të qetë. Tash para se të nis diskutimin, mua më bindi kryeministri se zoti Rexha qenka hajn ordiner, siç e quajti, më bindi dhe e ftoj që konform obligimeve ligjore që i ka të ushtrojë të drejtën e tij, siç na arsyetohet neve gjithnjë. Mos harroni se neni 386 i Kodit Penal thotë se moslajmërimi i veprës penale është vepër penale, e kryeministri i Kosovës po dika që zoti Rexha qenka hajn ordiner, e ftoj që ta lajmërojë si të tillë.

Tash, unë s'dua të futem në analizën e gjendjes në arsim, sepse është fusha e vetme ku ne kemi pasur kompetenca të plota si shoqëri prej vitit 1999 e këndeje, edhe është fusha e vetme ku s'mund t'i fajësojmë ndërkombëtarët, siç i fajësojmë, le të themi në drejtësi, ku sa herë të flitet për defektet e sistemit të drejtësisë arsyetohemi herë në UNMIK dhe herë në EULEX, këtu i kemi pasur të gjitha kompetencat tona dhe me të gjitha kompetencat tona si shoqëri kemi prodhuar gjeneratën më të humbur të mundshme në histori të Kosovës. Për ta përshkruar gjendjen e rëndë të arsimit veç një fjalë po e them, prej testit të PISA-s lus për interpretim të saj: "2/3 e studentëve kosovarë nuk e kuptojnë atë që lexojnë", pra s'kuptojnë çfarë lexojnë.

Tash, krejt ideja e debatit tonë parlamentar ishte rreth trajtimit të një segmenti të arsimit, segment jo më pak i rëndësishëm se të gjithë sektori i arsimit në vend. Dhe aty krijohen programe, ndalen programe dhe verifikohen ato. Në këtë proces konsiderojmë se janë zhvilluar disa gabime, gabime bazike dhe gabimi i parë, pra i përkeqësimit të gjendjes edhe ashtu të rënduar, është shkarkimi i Bordit. Jo pse ne e kemi brennga për anëtarët e Bordit, as që mërzhitemi për individë atje, por se me shkarkimin e Bordit dhe mosaktivimin e Bordit të ri, që nga data 25 shtator 2018, nëpërmjet një vendimi ad hoc është bërë paralizimi i kësaj agjencie dhe vendimi i shkarkimit nuk është marrë me një arsyetim. Pra është bazike që po të shkarkohet një Bord, të jepet një arsyetim, arsyetimi nuk u dha sepse, po besoj, motivi ishte zëvendësimi i një përbërje politike me një përbërje të re, po ashtu politike. Pra, ne nuk po e arsyetojmë shkarkimin e përbërjes politike, por nuk e amnistojmë edhe caktimin e përbërjes së re.

Gabimi i dytë, jo më pak i rëndësishëm është, se nuk u analizuan pasojat, çfarë pasoje ka një vendim i tillë. Edhe sikur të kishin qenë të informuar më mirë, gjithë kjo makinë qeverisëse në vend, e cila nuk është pak me zyrtarët që bëjnë këtë punë, do të mësonin për pasojat e rrezikimit të afërsisë me Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë dhe në rrjetin evropian, si hap të dytë.

Dhe, gabimi i tretë ishte në komunikimin me Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë. Nga shkresat e Qeverisë që i kemi parë, u shpërfaq një arrogancë e pashoqe. Aty jo vetëm që mungoi arsyetimi i veprimeve të bëra, pra për shkarkimin e Bordit ky është arsyetimi, por në mënyrë shumë amatoreske iu dha material Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë që të bëjë përjashtimin e Kosovës, sepse u arsyetua se Agjencia Kosovare e Akreditimit është shkarkuar në bazë të informacioneve konfidenciale që i paska kryeministri. Një arsyetim i tillë s'është logjik, është më tepër politik.

Pra, do të kishte qenë e udhës që në arsyetimin e dhënë të thuhej se Bordi është shkarkuar sepse ka pasur interferenca politike, sepse njëri prej anëtarëve është hajn ordiner dhe është dënuar sipas një vendimi të dhënë dhe më pas do të minimizonim edhe dëmet e bëra. Gabimi i fundit që po bëhet është rreth çështjes së ankimimit. Përsëri pa u informuar me rregullat e Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, ato çfarë autoritetet tona nuk po e kuptojnë është se ankesa nuk mund të shtrohet ndaj vendimit, pra mbajeni mend këtë mirë: nuk mund të shtrojmë ankesë ndaj vendimit, mund të shtrojmë ankesë ndaj procedurave të Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë për gjykim dhe mund të shtrojmë ankesë ndaj asaj që thonë përbërës verdikt ose gjykim jo i drejtë në bazë të fakteve që kemi prezantuar. Por, ne fakte s'kemi prezantuar, pra ne kemi thënë se ka informacione konfidenciale kryeministri, prandaj është shkarkuar dhe ky nuk bën fakt në vete.

Prandaj, përjashtimi i Kosovës prej Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë është punë e kryer, tash ne duhet të merremi me sanimin e pasojave për përjashtimit të Rrjetit evropian që mund të na vijë shumë shpejt, dhe pasojat janë disa, edhe një herë po i përsëris, meqenëse nuk i dëgjuan ndërhyrëse të shefit tonë. E para, siç është thënë nga drejtori i Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, studentët kosovarë do të kenë vështirësi në njohjen e diplomave, sidomos ata që i kanë regjistruar studimet pas marrjes së vendimit për përjashtim.

E dyta, mungesa e monitorimit ndërkombëtar të punës së Agjencisë dhe përfshirjes së saj në rrjetëzimet evropiane mund të rezultojë në degradimin e kritereve të Agjencisë dhe me degradimin e këtyre kritereve degradon edhe cilësia e arsimit në Kosovë.

E treta, mbetja e Agjencisë jashtë funksionit si pasojë e veprimit të pamenduar për shkarkim të Bordit rrezikon akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve që u ofrohen sot studentëve kosovarë.

Prandaj, e tëra çfarë po kërkojmë sot është ta arrijmë një konsensus rreth përbërjes së Bordit të ri, në mënyrë që kjo përbërje të ratifikohet në Kuvend dhe kjo përbërje të jetë shumë kredibile, sepse do ta ketë detyrën shumë të vështirë që të jetë e pavarur nga Qeveria dhe të jetë e pranuar nga regjistrat evropianë dhe rrjetet evropiane.

Prandaj, ju ftoj edhe një herë për konsensus dhe trajtim të temës në formë krejtësisht profesionale dhe pa tension politik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Lidhur me dyshat e Glauk Konjufcës, se këta s'kanë merak të dalin te treshat, se Glauku është i ndjeshëm në tresh, dëshiroj të të them diçka Glauk djali se mbrapa teje është doktor Fadil Beka, shoku im i klasës, dhe kurrë në jetën time në shkollë s'kam pasur as dysh, as tresh, por kam qenë nxënësi në gjeneratën time nga më të mirët, bile na zgjidhshin edhe për ta bartur stafetën e shokut Tito, e tani i patëm çuar edhe lule Enver Hoxhës. Po, varet kush të vlerëson, se njëri kishte pas shitur diamante te gomarxhinjtë, ata që shishnin dru me gomarë, për dhjetë dollarë s'ia mori, kur shkoi te argjendari 300 mijë dollarë. Edhe babai i tha, “e sheh biri im, nuk është sikur të të vlerësojë gomarxhiu, sikur argjendari”.

Ty të shkon fort metafora, se unë jam brez i babait tënd. Pyete Hydajet Hysenin, pyeta Enver Dugollin çfarë nxënësi kam qenë, po ty të shkon fort metafora që prej “Skenderit del beteri”. Kështu, prapë po them, përmbajuni në divergjencat tona politike dhe mos fyeni, sepse, në fund të fundit, unë nuk fyhem prej njerëzve të fyer. Vazhdoni!

Kundërshtitë tona politike janë tjetër send dhe të mos kalojmë në rrafshin e fyerjeve, në rrafshin personal. Ti vazhdo, s'është problem.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Ja, po vazhdoj pra pak!

Meqenëse po na shet moral dhe na u ka bërë mësues i moralit pikërisht Milaim Zeka, ky e ka keqpërdorur emisionin e tij publik në RTK për ta promovuar njëfarë Ilir S'dikushin, me të cilin ka themeluar kompani, e cila i ka mashtruar qytetarët e Kosovës, qindra prej tyre, për t'ua marrë 250 mijë euro për viza false, viza të punës në Zvicër e në Gjermani. Ky njeri rrezikon të shkojë në burg për këtë farë pune.

E dyta, është njeri i cili kur e ka pas uzurpuar atë shtëpinë e vet, atje në Breg të Diellit, dhe kur e ka nxjerrë Policia e EULEX-it si uzurpator, dilte dhe thoshte “ma ka thyer SHIK-u”, “ma ka thyer shtëpinë SHIK-u dhe ma ka vjedhur një llap-top”. Kur një njeri i tillë shet moral publik, unë nuk di më çfarë të them.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Limaj e ka kërkuar fjalën, si zëvendëskryeministër, meqenëse kryeministri s'është këtu.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Shkasi i debatit të thirrur tashmë është i njoftuar nga thirrësit e debatit, por tema për të cilën po flasim, për arsimin si tërësi, besoj dhe shpresoj se do të jetë temë gati thuajse e përhershme në Parlamentin e Kosovës, për faktin që, siç u tha këtu edhe nga shumë deputetë, është një nga lëmenjtë strategjike të rëndësishme, të veçantë, që duhet të merremi seriozisht për të dalë nga një situatë në të cilën jemi.

Nga ajo që dëgjuam deri më tani, në përgjithësi, pavarësisht këndvështrimet, pajtohem me konstatimin e njohur tashmë që arsimi në vendin tonë është keq. Dhe, po që se ndalemi në këtë foltore dhe të bëjmë me gisht se pse është keq, na shkon shumë kohë. Na shkon shumë kohë dhe përsëri kthehem te konstatimi se është gjendja keq. Në qoftë se kemi qëllim më vete për të bërë me gisht, ne mund të arrijmë deri aty, por përsëri mbetemi në konstatim.

Le të na shërbejë një rinisje, një moment, kur të gjithë bashkë, kur për këtë çështje nacionale, si temë nacionale, bëhemi pjesë e pandashme e kontributit për t'i përmirësuar gabimet, lëshimet, problemet, të cilat i kemi në arsim. Nuk mund asnjë ministër, asnjë qeveri vetë, pa angazhimin e përbashkët, as mazhoranca, si Parlament të kontribuojmë për ta përmirësuar gjendjen në arsim.

Përrjashtimi i Kosovës që erdhi ditëve të fundit dhe shqetësimet e dala, qoftë këtu, edhe në opinion, ma merr mendja se po kapemi më tepër me një pasojë, një dukje që mund të përdoret edhe e frikshme, edhe e keqe dhe në çfarëdo kuptimi që ta shohim. Për shembull, që është e vërtetë, po themi përrjashtimi do të ketë vështirësi dhe probleme rrugës për studentët. Unë kisha dashur dhe pres nga ju, jo ndoshta sot, por herëve tjera, që të futemi pak më në përmbajtje.

A e kemi brenda gjendjen mirë në arsim dhe a janë duke na dalë djemtë dhe vajzat tona me kualitetin e dëshirueshëm dhe të domosdoshëm për të konkurruar me bashkëmohatarët e tyre në universitetet e Evropës?

Ja, ta marrim shembull, krejt jemi të anëtarësuar në ato organizata, sikur që kemi qenë deri dje. A ka qenë dje arsimi më mirë në Kosovë, sesa sot? Ata djemtë dhe vajzat tona që diplomojnë, a mund të jenë konkurrentë me bashkëmohatarët e tyre në universitetet tjera? A është zgjidhje dhe a mund të themi që arsimi është në rregull vetëm me faktin që jemi pjesë e një organizate, apo s'jemi?

Problemi është, për mendimin tim, u tha këtu, u fol këtu për depolitizim, u fol për apolitizim, a çka do që ta quajmë. Ma merr mendja se është koha që t'u japim mundësi njerëzve profesionistë, pavarësisht bindjeve politike, duhet ta kemi një lloj konsensusi nacional në temën e arsimit. Dhe, ne jemi shumë të hapur në këtë drejtim. Njerëz të zanatit, pa dallim për bindje politike, se, në

fund të fundit, çdonjëri në Kosovë që ka një bindje politike e ka për vendin e vet. Dhe, ne jemi shumë të hapur dhe kërkojmë ndihmën e të gjitha grupeve parlamentare, pavarësisht pozitë dhe opozitë, njerëzve që e duan këtë vend dhe profesionistëve, ejani të ulemi bashkë edhe t'i bëjmë intervenimet e nevojshme, që do të çonin në përmirësimin dhe ngritjen e cilësisë në arsimin e të gjitha niveleve.

Ejani të bëhemi bashkë në temat nacionale, sikur që është kjo, dhe t'u japim mbështetje njerëzve që ne të gjithë bashkë besojmë që e kanë kredibilitetin e nevojshëm, profesionalizmin e nevojshëm, për ta dërguar në një fazë tjetër cilësinë e arsimit në vendin tonë.

Ajo që unë po dua të ju siguroj, kjo është përpjekja, dëshira, angazhimi ynë. Andaj, le të na shërbejë kjo seancë shumë e nevojshme për të reflektuar dhe për t'u ofruar e për të filluar së ndërtuari edhe te agjencitë, edhe kudo që është e nevojshme në këto nivele të arsimit, të bëjmë ekipe të cilat profesionalisht janë kredibile për ta ngritur cilësinë e arsimit në vendin tonë.

Shikoni, ne duhet të jemi të kujdesshëm nga paragjykimet. Është e qartë dhe s'po dua të flas, ne e dimë që kjo që ka ndodhur këto ditët e fundit, më tepër është diçka që nuk u shkon intelektualëve të vendit tonë dhe grupeve të ndryshme, të cilat çojnë e sjellin informacione dhe konstatime jo të drejta. Informacione të gabuara, shfrytëzohen kanale dhe keqpërdoren, kanale për të keqinformuar.

Prandaj, unë ju ftoj që të ulemi dhe së bashku t'i bëjmë hapat e nevojshëm që do të ndihmonin në përmirësimin e gjendjes. Në këtë drejtim, ne jemi shumë të hapur, shumë të gatshëm, që t'u jepet hapësirë dhe mundësi njerëzve që i përzgjedhim dhe t'i mbështetim në hapat drejt diçkaje që është interes yni i përgjithshëm.

Sot është 7 Marsi, ani që është shkasi për çfarë është thirrur seanca, por besoj se e ka qëlluar një datë të rëndësishme. Edhe unë e shfrytëzoj rastin që gjithë mësimdhënësve të vendit tonë, ata që janë aktivë në mësimdhënie dhe ata që një jetë të tërë ia kanë kushtuar mësimdhënies, t'ua uroj këtë ditë dhe gjithashtu, me besimin e plotë që ne si drejtues të vendit, deputetë e Qeveri, t'ua dërgojmë mesazhin që jemi të gatshëm shumë seriozisht t'i identifikojmë temat nacionale, të cilat nuk mund t'i bëjë vetë asnjë ministër e asnjë qeveri, pa vullnetin, bashkëpunimin, koordinimin e të gjithëve bashkë.

Nuk e kemi vetëm arsimin. E kemi edhe shëndetësinë, kemi edhe lëmenj të tjerë për të cilët kemi nevojë për një bashkërendim të aktiviteteve dhe angazhimeve tona të përbashkëta.

Edhe një herë ju falënderoj shumë që një pjesë e madhe e deputetëve patën fjalime, të cilat besoj i shërbejnë debatit dhe u shërbejnë konkluzioneve që duhet të nxirren për të ecur përpara dhe për ta ndryshuar gjendjen, por të ikim nga gjërat të cilat mund ta dëmtojnë arsimin. Mund ta

dëmtojnë perspektivën e vendit tonë dhe nuk besoj që përfitohet politikisht nga një metodë e tillë, sepse e kaluara tregon që nga çfarëdo tendence e tillë, jo që ka përfituar dikush, kemi humbur të gjithë. Dhe, mua po më vjen mirë që sot debatin këtu po e shoh që më tepër është i angazhuar për të gjetur zgjidhje e për të ecur përpara, sesa për të instrumentalizuar për interesat e një grupi, ose të një individi.

Kështu që ju falënderoj shumë për këtë mundësi që sot e kemi pasur të gjithë për ta thënë nga një opinion dhe shpresoj se kjo na shërben që edhe të jemi të kujdesshëm në hapat që do t'i ndërmarrim, edhe në angazhimet, dhe jemi të përgjegjshëm në veprimet e përbashkëta dhe të na shërbejë gjithashtu edhe si refleksion që në këtë temë duhet një konsultim i gjerë e një bashkërendim i aktiviteteve për të arritur te më e mira, atë që e ka vendi ynë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ne po marrim pauzë të drekës tash deri në 15:30, pastaj vazhdojmë, sepse lista e diskutuesve është e gjatë.

Ndoshta, ka qenë më mirë të jetë nga pesë minuta, por sidoqoftë është çështje e juaja, kur të kthehemi diskutojmë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë! Vazhdojmë me seancën. Zonja Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Lajmi për largimin e Kosovës nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është mjaft shqetësues dhe kjo vjen si rezultat pasi po vazhdohet me politizimin dhe degradimin e arsimit në kurriz të studentëve dhe profesorëve tanë.

Pra, është një lajm shumë i keq dhe shumë i dëmshëm për sistemin e arsimit, në përgjithësi.

Pra, siç e dimë, Kosova, e pranuar në vitin 2015 në EQAR, ka qenë një ndër pak shtetet e Ballkanit që ka qenë pjesë e këtij mekanizmi shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me arsimin e lartë.

Pranimi i Kosovës në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është vlerësuar si një zhvillim shumë i rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Kosovë dhe është vlerësuar se do të kontribuojë në përmirësimin dhe avancimin e cilësisë në arsimin e lartë, si dhe do të jetë një mundësi për ndërlidhjen e institucioneve dhe studentëve tanë në sistemin evropian të arsimit të lartë.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në vend që të ofronte përkrahje për Agjencinë e Kosovës për Akreditim si institucion kyç që garanton cilësinë e punës arsimore dhe kërkimore shkencore në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, pra në vend që Qeveria ta përkrahë dhe forcojë Agjencinë, nëpërmjet vendimeve të ngutshme dhe të kundërligjshme e shkarkon Bordin dhe menaxhmentin e saj.

Dhe, si rezultat i këtij vendimi, Agjencia e Kosovës për Akreditim është përjashtuar nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Largimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë duhet të jetë alarm për institucionet tona, në mënyrë që në veprimet e tyre politike të kenë kujdes, pasi me largimin nga një mekanizëm kaq i rëndësishëm për arsimin e lartë është goditje e rëndë për sistemin e arsimit të lartë në Kosovë.

Sipas drejtorit të Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, pas përjashtimit të Kosovës nga organizatat EQAR do të komplikohen jashtëzakonisht procedurat e aplikimit në universitete ndërkombëtare për studentët e Kosovës.

Pra, sipas drejtorit, një gjë është e sigurt, që procesi i aplikimit të studentëve kosovarë në universitetet ndërkombëtare tashmë do të jetë më i gjatë dhe më i vështirë për shkak të procedurave shtesë që do të bëjnë universitetet evropiane.

Sipas drejtorit të Regjistrimit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, Kosova fillimisht duhet të presë edhe tre muaj që të ketë të drejtë t'i fillojë procedurat e reregjistrimit në EQAR për shkak të rregullave dhe procedurave të saj.

Një gjë e tillë për Agjencinë e Kosovës për Akreditim mund të jetë edhe më e vështirë, pasi ajo është përjashtuar për shkak të ndërhyrjeve politike në këtë Agjenci.

I nderuar ministër,

Siç është bërë e ditur, ju si ministër i Arsimit keni qenë të njoftuar që nga muaji nëntor që Agjencia e Akreditimit në Kosovë mund të përjashtohet nga EQAR-i si rezultat i ndërhyrjeve politike që i keni bërë, apo si rezultat i shkarkimit të Bordit të Agjencisë së Akreditimit, pas marrjes së mandatit si ministër.

Vendimi për shkarkimin e Bordit të Agjencisë së Akreditimit është vlerësuar si i ngutshëm dhe politik, e këtë e thanë edhe shumica e deputetëve.

Dhe, si rezultat i vendimeve politike të ngutshme dhe të gabuara, pa ndonjë analizë të mirëfilltë, dhe në këtë rast Kosova po e merr goditjen e radhës shkak i ndërhyrjes politike në arsim nga Qeveria e këtij mandati.

Edhe pse të gjithë e dimë se anëtarët që kanë qenë pjesë e Bordit të Agjencisë së Akreditimit kanë qenë politikë dhe ka pasur dilema të arsyeshme për kapacitetin e agjencisë për të vepruar jashtë ndikimit të politikave ditore, si në vend, po ashtu edhe në organizatën ndërkombëtare, pasi është vënë në shërbim të interesave politike dhe atyre biznesore.

Megjithatë, në vitet e fundit Agjencia e ka treguar një përkushtim, mirëpo jo të kënaqshëm për t'i adresuar problemet e cilësisë të arsimit të lartë.

Mirëpo, pikërisht ky Bord kishte marrë disa veprime, apo të paktën kishte dëshmuar se dëshironte që të kishte sado pak rregull në arsimin e lartë dhe kishte pezulluar më shumë se 100 programe akademike në universitetet publike e në kolegjet private, pasi kishte vlerësuar se nuk i përmbushnin kriteret ligjore.

Në këtë rast, shkarkimi i gjithë strukturës udhëheqëse të Agjencisë nuk mund të kuptohet ndryshe përveç si ndërhyrje politike ndaj një institucioni që duhet të ishte i pavarur.

Shkak për largimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë është si rezultat i vendimit të kundërligjshëm edhe të ngutshëm për shkarkimin e anëtarëve të Bordit dhe të menaxhmentit të Agjencisë së Akreditimit.

Prandaj, Komiteti i Regjistrit të EQAR-it në vendimin për përjashtim ka konstatuar se pas vendimit të ministrit të Arsimit, në këtë rast vendimit tuaj për shkarkime, Agjencia e Akreditimit e Kosovës e ka humbur aftësinë e saj për të vepruar në mënyrë autonome.

Në këtë rast, në arsyetim ka theksuar se ka mundur të identifikohen rrethanat që do të justifikonin shkarkimin me efekte të tij të dëmshme në pavarësinë dhe aftësinë e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.

Siç është raportuar në medie, presidenti i Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë ka kërkuar sqarime për shkarkimin e Bordit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe ushtrueses së detyrës së Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Po ashtu, ju ka kujtuar se Agjencia e Kosovës për Akreditim është pjesë e Regjistrit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë që nga viti 2015 dhe ju ka bërë me dije se është subjekt i monitoruar nga EQAR-i.

Andaj, kërkojmë nga ju si ministër që të njoftoni nëse i jeni përgjegjës dhe cila kanë qenë përgjegjja juaj apo arsyetimi juaj për këtë shkarkim që keni bërë, i cili po vlerësohet i dëmshëm për arsimin e lartë në Kosovë.

Po besoj që e keni analizuar me vëmendje këtë vendim dhe do të ndërmerrni hapa konkret në përmirësimin e veprimeve tuaja të kundërligjshme.

Po ashtu, shpreh shqetësimin tonë se zgjedhja apo propozimi i anëtarëve të rinj të Bordit të Agjencisë nuk është bërë nëpërmjet një procesi transparent dhe të besueshëm që do t'i argumentonte pretendimet e Qeverisë se synon depolitizimin e Agjencisë.

Andaj, në këtë rast ne kërkojmë nga ju ministër që të keni shumë kujdes në hapat e ardhshëm kur do të shfrytëzohen të gjitha mundësitë që janë në dispozicion, të ofrohen arsyetime të plota për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë, t'i tërhiqni emrat e propozuar për Bordin e ri dhe të filloni një proces transparent të përzgjedhjes së anëtarëve të rinj për Bordin e ardhshëm të Agjencisë së Akreditimit. Pra, të jenë njerëz profesionistë, njerëz apolitikë dhe që ndihmojnë në të mirë të sistemit të arsimit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Besoj që debati i sotëm, së paku unë do të preferoja të jetë për gjendjen e përgjithshme në arsim, meqenëse rastis me një ditë të shënuar, me Ditën e Mësuesit, prandaj e shfrytëzoj rastin edhe unë t'ua uroj të gjithë mësime të Kosovës.

Por, nga debati që u dëgjua deri më tash realisht ne nuk patëm debat të fokusuar.

Parashtruesit e kërkesës për debat e kanë pasur arsyen shumë specifike e ftesës për këtë debat dhe një pjesë e mirë e diskutuesve paraprakë realisht rrëshqitën nga tema në temë dhe ngritën çështje e dilema të ndryshme, të cilat realisht edhe kur vijnë prej grupeve të njëjta nuk përputhen me qëndrimet e shprehura nga këto grupe politike.

Unë do t'i them vetëm disa fjalë, ndoshta më shumë për të nxitur diskutim, sesa për të dhënë përgjigje.

Gati u krijua përshtypja që gjendja në arsimin e lartë në Kosovë varet vetëm prej funksionimit ose jo të Agjencisë Kosovare për Akreditim dhe Këshillit Kombëtar të Cilësisë. Dhe, unë nuk jam i sigurt që kjo është e vërtetë, sepse gjithë ky vajtim të cilin e dëgjuam sot, pak a shumë i bie që nëse s'e kemi funksionale këtë Agjenci, atëherë ne s'kemi as arsim të lartë. Dhe, unë besoj që është lajmë absolutisht jo i mirëseardhur përjashtimi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga EQAR-i dhe s'ma merr mendja që, para së gjithash, është ndie mirë ministri, sepse do të ishte absurde nëse ministri ndihet mirë për një rezultat të tillë.

Por, ma merr mendja që vërtet duhet ta shohim se pse ka ardhur deri këtu dhe mbi të gjitha të mundohemi ta gjejmë një rrugëdalje prej kësaj situate.

Rrugëdalja do të duhej të ishte sot sesi mund të përmirësohet ky problem dhe si mund të kthehet Agjencia Kosovare e Akreditimit në EQAR.

Po ashtu u tha se mund të përjashtohet edhe nga ENCA, gjë që shpresoj shumë që nuk do të ndodhë, sepse besoj që është organizatë edhe më e rëndësishme dhe ENCA është edhe njëri nga themelueset e EQAR-it, por realisht unë shpresoj që sidomos pas kësaj situate, Qeveria dhe Ministria, në radhë të parë, do të jenë shumë më të ndërgjegjshme, shumë më të kujdesshme për të mos e sjellë situatën deri aty.

U fol shumë për politizimin, por nuk u tha pothuajse prej shumicës asgjë konkrete. Ne kur flasim për politizim, duhet ta dimë a po flasim për partizim, a po flasim për anëtarë të partive politike zyrtare, apo për diçka tjetër, dhe nëse flasim kështu atëherë ma thoni një parti politike në

Kosovë, e cila ka pasur çfarëdo përgjegjësie, qoftë në nivelin qendror, apo në atë lokal, dhe nuk ka pasur anëtarë të saj në sistemin e arsimit dhe, në fund të fundit, ne s'mund t'ua mohojmë të drejtën edhe njerëzve të arsimit që të jenë pjesë e partive politike.

Por, nëse ky Bordi i kaluar që është shkarkuar ka qenë politik, atëherë a është edhe ky tjetri që po vjen politik? Dhe, nëse dikush thotë po, a bën të na tregojë me emra?

E përmendët Blerim Rexhën, po hajt t'i shohim edhe ata të tjerët, a kanë qenë ata politikë. Ose ja këta tjerët, që i ka propozuar Qeveria, a janë këta politikë? Të cilave parti janë? A bënë të na tregojë dikush prej juve cilat pozita i mbajnë, në cilën parti, pasi po flitni për politizim.

E nëse flasim për politizim, atëherë a është Akademia e Shkencave institucion i rëndësishëm i shkencës dhe i arsimit në këtë vend? A është Akademia e Shkencave një institucion që s'do të ishte mirë të jetë e populluar prej zyrtarëve politikë dhe prej zyrtarëve partiakë që kanë pozita udhëheqëse nëpër parti politike? Dhe, nëse ka kundërshtime për këtë çështje, do të kishte qenë mirë që edhe në Akademinë e Shkencave ta kemi standardin e njëjtë, e jo të flasim vetëm për Agjencinë e Akreditimit, sepse Akademia e Shkencave konsiderohet ndoshta si institucioni kulmor i arsimit, i shkencës dhe i kulturës.

Por, në anën tjetër, edhe për kurrikulat, se ato, për mendimin tim personal, janë baza e problemit të arsimit në Kosovës. E nëse doni përnjëmend ta trajtojmë, a kthehemi ta shohim kush i ka shkruar këto kurrikula dhe kush i ka bërë gati, prej programeve të gjuhës e letërsisë shqipe nëpër shkolla fillore, e të gjitha lëndëve tjera, deri në përfundim të ciklit para universitare, meqenëse këtu nuk u fol veç për arsimin e lartë, u fol edhe për të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Edhe atëherë do të ju dalin të politizuar e të partizuar, do të jenë besa edhe njerëz që kanë qenë edhe anëtar të këtij Kuvendi, edhe në nivele të larta politike dhe partiake.

Do të thotë, duhet ta kemi një standard, nëse duam të gryojmë. Të mos i kemi dy, tri ose katër pesë standarde të ndryshme.

Po kthehem konkretisht. A ka qenë vendim i drejtë shkarkimi i atij Bordi që e ka bërë Qeveria? Është çështje e mendimit të secilit. A ka qenë ligjore, është diçka tjetër.

Po ta pyesësh secilin prej neve, do të kishim ndoshta mendim tjetër dhe s'do të vepronim ndoshta njëjtë siç kanë vepruar ministri dhe kryeministri. Ndoshta do të vepronim ashtu. Por, a ka pasur të drejtë ligjore? E vërteta është që ka pasur. A e kanë menaxhuar mirë Qeveria dhe ministri procesin pasi është bërë ankimimi në EQAR? Unë mendoj që nuk e kanë menaxhuar si duhet. Sepse është dashur një formë tjetër ndoshta, edhe e përgjigjes, besa edhe e marrjes së përgjegjësisë, edhe e shpjegimit të gjithë situatës, tek e fundit, edhe të vizionit të këtij ministrit të ri çka po do të bëjë dhe të arsyetojë pse i ka ndërmarrë këto veprime.

Tek e fundit, një ministër, një kryeministër, një Qeveri e merr përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime. Këtë ia ka dhënë vota e këtij Kuvendi, që ka ardhur si rrjedhojë e një vote, dhe pastaj ka fund secili prej nesh, veçanërisht Qeveria e jep llogarinë e fundit kur të duhet të dalë edhe një herë para qytetarëve.

Po flitni për akreditimin. Po kush e ka filluar këtë akreditim në Kosovë? Është Partia Demokratike e Kosovës, kur e ka udhëhequr atë ministri që e ka filluar procesin e akreditimit. Është Partia Demokratike e Kosovës që Kosovën dhe këto institucione i ka anëtarësuar edhe në ENCA, edhe në EQAR. Dhe, nëse vula e cilësisë në arsimin e lartë, është anëtarësimi në EQAR. Atëherë, a dini të më tregoni diçka, a është gjendja në arsim sot e tmerrshme që jemi përjashtuar dhe dje paska qenë e mirë se kemi qenë anëtar, dhe është pikërisht Ministria e udhëhequr prej PDK-së që e ka arritur këtë sukses. Po flitet edhe për diploma dhe unë sot kam pritur së paku që ka njerëz kompetentë në këtë Kuvend që të flasin për arsimin, që të tregojnë përnjëmend për qytetarët e brengosur dhe studentët, para së gjithash, a ka efekt direkt, apo s'ka? Neve diplomat e Kosovës na u kanë pranuar nëpër universitete të huaja, ka shumë edhe në këtë Kuvend besoj që e kanë pasur këtë përvojë edhe pa pasur Agjenci të Akreditimit fare.

Unë besoj që është shumë e rëndësishme edhe për prestigjin e arsimit të Kosovës dhe kësaj agjencie për të qenë edhe në EQAR, edhe në ENCA, dhe diku tjetër, pavarësisht që ka shtete të rajonit që s'kanë qenë asnjëherë anëtare. Por, ne duhet të jemi të sigurtë dhe t'i tregojmë vërtet konsekuencat, dhe unë besoj që konsekuenca ka. E dëgjova ministrin në fjalën e tij, tha që ka kërkuar prej kryeministrit për ta pezulluar për një periudhë të caktuar vendimin. Mendoj që ka bërë veprim të drejtë, dhe unë i inkurajoj, edhe ministrin, edhe kryeministrin, që të diskutojnë sa më gjerë, me konferencën e rektorëve, me kolegjet private, me të tjerat publike, por edhe me palët e interesit, organizatat joqeveritare, shoqatat dhe organizatat e studentëve e tjera dhe të ketë një përfshirje sa më të madhe dhe le të na e sjellë listën, qoftë me përmirësimet, qoftë çfarë ta vlerësojnë këta. Pastaj, është në përgjegjësinë e këtij Kuvendi që t'ia japë vulën e miratimit apo tutje, por ne duhet ta gjejmë një formë, një mënyrë për të dalë prej kësaj situate.

Thënë të drejtën si ish-ministër po ia jap vetes të drejtën që të them edhe diçka, sepse e kam provuar petkun e përgjegjësisë ekzekutive. Rreziku më i madh është kur një ministër, s'e kam fjalën domosdoshmërisht për ministrin e Arsimit, e sheh veten si shpëtimtar të asaj fushe në të cilën hyn, sepse ashtu mund të bëjë veprime, të cilat pastaj mund t'i kushtojnë. Por, ne s' duhet ta paragjykojmë as këtë ministër, as këtë Qeveri. Ne duhet të marrim përgjegjësi për veprimet që i ndërmerr, por jo ta paragjykojmë domosdoshmërisht pa e parë një veprim të caktuar që jep rezultate. E kemi parë një veprim që ka dhënë një rezultat negativ, po pajtohemi të gjithë që s'është pozitiv, e pamë një zotim sot që po e kërkojnë tre muaj sa është koha e apelit për ta përmirësuar këtë situatë dhe për ta rikthyer, dhe, tek e fundit, hajde po i presim këta tre muaj, e nëse nuk arrijnë me të vërtetë që ta kthejnë Agjencinë e Akreditimit në EQAR, atëherë e kemi të

drejtën me të vërtetë që ta kërkojmë një përgjegjësi prej tyre, qoftë me ndryshimin e këtyre emrave, qoftë me diçka tjetër.

Por, po e përsëris, shqetësimi duhet të jetë për nivelin e vërtetë të cilësisë, të cilin e kemi në arsim, sepse unë besoj që është shumë i rëndësishëm pranimi në EQAR dhe në ENCA, por nuk mendoj që vula dhe dëshmia kryesore e cilësisë në arsimin e Kosovës është anëtarësimi ose jo sot, në këto organizata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti ministër!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë u mundova që me vëmendje ta dëgjoj çdo çështje që u ngrit nga deputetët, ta dëgjoj dhe ta analizoj, dhe konsideroj që tash pa një kronologji të rrjedhës do të mundohem t'i jap disa përgjigje.

E para, u diskutua disa herë raportimi në Kuvend nga ministri, si dhe në raportimin e Komisionit Parlamentar për Arsim. Sa herë që është kërkuar që unë të jem i pranishëm në Komisionin për Arsim, përveç kur s'kam qenë në Kosovë, jam munduar që të jem aty dhe t'i jap të gjitha përgjigjet që janë kërkuar nga komisioni. Pikërisht për çështjen e mënyrës se si është shkarkuar Bordi, nuk e kam pasur një kërkesë të veçantë që të jemi i pranishëm dhe e kemi diskutuar kur kemi qenë gjatë diskutimeve të temave tjera brenda këtij komisioni, por jo direkt për këtë çështje, sepse nuk është kërkuar. Por, unë kam kërkuar që çështja e përjashtimit nga EQAR nga Komisionit për Arsim brenda Parlamentit të Kosovës u kërkoja që të shtyhet ky takim, sepse kishim nevojë që edhe ne të reflektojmë, edhe ne të shohim se cilat ishin shkaqet që na shtynë kaq shpejt te ky vendim, në mënyrë që pastaj të jemi sa më të përgatitur, që ta kemi një informacion më të qartë dhe ta informojmë edhe komisionin për qartësimin e kësaj situatë.

Lidhur me raportimin në Parlamentin e Kosovës, unë konsideroj që kemi ligje, të cilat nganjëherë mund të interpretohen në mënyra të ndryshme, pra kur s'ka qartësi brenda ligjit lejohet mundësia e interpretimeve të ndryshme, sepse edhe vetë jam në atë pjesën e njohjes së interpretimeve të ligjeve, mirëpo për t'u siguruar nga kjo unë e kam marrë një interpretim nga Zyra Ligjore, ku thuhet se pas shkarkimit të Bordit në tërësi, Bordi duhet të shkojë të miratohet në Parlamentin e Kosovës si listë e tërësishme. Ne jemi në nenin 7, pika 4, pra nuk jemi në nenin 7, pika 5, kur për shkak të një numri të caktuar shkarkimi duhet të vijë e të raportohet fillimisht në Parlamentin e Kosovës, por pasi lista ka qenë e tëra e shkarkuar dhe është pika 4, atëherë me

sjelljen në Parlament për t'u votuar si listë është dashur të jepet edhe një raport, të cilin nuk kam pasur mundësi deri më tani, dhe vërtet kjo na ka kushtuar për shkak të shtyrjeve që janë bërë, sepse të jeni të sigurt që edhe kjo vonesa për pothuaj pesë muaj për pamundësinë e funksionalizimit të Agjencisë së Akreditimit e ka shkaktuar një dëm, sepse sikur Agjencia e Akreditimit të ishte funksionalizuar për një periudhë të shkurtër do të ishte shumë më lehtë që të shihej pavarësia e kësaj agjencie, të hiqen dilemat e ndërhyrjeve politike dhe vetë Agjencia do ta kishte një komunikim direkt me institucionin profesional, EQAR.

Dua ta bëj një sqarim zyrtar, nga çështja e njohjeve të diplomave, që u diskutua nga disa deputetë, gjithmonë ekziston vetëm një e vërtetë, nuk janë dy të vërteta, por nganjëherë duke i shkurtuar në mes prezantimit mund të kuptohen si dy të vërteta. Edhe deklarimi i kryetarit të EQAR, nëse e lexojmë pikë për pikë deri në fund, pra nuk thotë që diplomat e studentëve tanë, të cilët dalin të diplomuar dhe programet apo nga institucionet që deri më tani kanë qenë të akredituara do të kenë vështirësi në njohjen nga universitetet e Evropës. Pra, kjo është një deklaratë, pjesa tjetër e deklaratës vazhdon më tutje, nëse programet e reja apo institucionet e reja akreditohen tani dhe pa qenë Agjencia jonë anëtar i EQAR, mund të ketë problematikë, ose vështirësi në njohjen e diplomave.

Pra, pjesa e parë është e qartë që nuk do të ketë vështirësi, pjesa e dytë se mund të paraqiten vështirësitë, mirëpo deri tek akreditimi i programeve të reja, deri te diplomimi i studentëve që mund të jenë në këtë vit studentë të rinj në Universitetin e Prishtinës, apo në universitetet tjera dhe kolegjet private, jam i sigurt që ne si institucion, pra si Qeveri, dhe ju si Parlament duhet të bëjmë maksimumin për t'i bashkërenditur veprimet që ne të kthehemi në EQAR dhe të mbetemi pjesë e ENCA-së, një institucion i rëndësishëm i Agjencisë Evropiane.

Të gjeturat, të cilat ministria i ka pasur dhe tregon që ministria nuk ka dashur që të ndërhyjë në Agjencinë e Akreditimit, pra ajo që po kërkohet - transparenca e zgjedhjes së një listës, që po quhet "ndërhyrje politike", që nga momenti kur është marrë vendimi për shkarkimin e Agjencisë së Akreditimit, gjegjësisht Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Ministria e Arsimit nuk e ka pasur asnjë ndërhyrje në Agjencinë e Akreditimit, pra nuk e ka shfrytëzuar absolutisht këtë zbraçeti dhe të themi se është bërë për qëllime politike dhe tani po e shfrytëzon këtë zbraçeti për të pasur ndërhyrje politike. Nga ajo që është parë, për mosndërhyrje zero në Agjencinë e Akreditimit, ju i keni dëgjuar konsideroj edhe diskutimet që janë bërë ndërmjet EQAR dhe Agjencisë së Akreditimit. Zyrtarët e Agjencisë së Akreditimit nganjëherë kanë dhënë informacione jo të duhura, ose të themi më mirë jo të sakta, sepse s'ka pasur ndërhyrje nga ne.

U diskutua çka quajmë ndërhyrje politike, në rast se nuk është bërë asnjë veprim politik. Çka kuptojmë me transparenca të listës? Unë do të isha shumë i kënaqur sikur të themi se lista s'është bërë transparente, sepse nuk është respektuar ky udhëzim administrativ, apo ky ligj që i përcakton kriteret se si duhet të përzgjidhen personat që duhet të jenë anëtarë të kësaj liste. Ajo

çka mund të ju themi sot, ne e kemi bërë përzgjedhjen e listës sipas Ligjit për arsimin e lartë, pra siç kërkohet që të emërohet nga ministri. Ministri ka kërkuar që personat që duhet të propozohen në këtë listë të jenë jopolitike dhe ju kisha lutur - lista ka qenë publike, nuk po dua tani ta mbroj më këtë listë, sepse ne vetë kemi kërkuar për hir të transparencës, sepse nuk e kemi asnjë lidhje emocionale me këtë listë.

Për ne është që lista të jetë sa më e pavarur. Nuk them që është lista më e qëlluar që ka qenë e propozuar, por së paku jemi munduar që kjo listë të mos jetë listë politike dhe lista ka qenë publike, e nëse ma thoni ju që e keni lexuar listën që ky person që është emëruar në këtë listë është person që mban post politik, unë do ta jap një përgjigje. Pra, e kemi një listë, e cila përmban njerëz profesionalë, njerëz kredibilë, por që nuk janë njerëz politikë. Kemi kërkuar që kjo listë të verifikohet. Pra kemi kërkuar nga ministri zyrtarisht ta ndalim këtë listë dhe jemi të hapur, kemi thënë që secili që mendon që e ka një mundësi për ta dhënë në verifikimin e këtyre personave në rritjen e vlerës së kësaj liste, ne jemi të gatshëm që ta diskutojmë çështjen e listës, të cilën e kemi propozuar.

Cilat janë të gjeturat? Ka shumë të gjetura, u thanë edhe këtu, por gjithmonë kemi dëshiruar që të gjeturat të mbeten pjesë kur të bëhet funksionalizimi i Agjencisë së Akreditimit, Këshilli Shtetëror i Cilësisë t'i adresojë të gjeturat në këtë agjenci. Është folur shumë për një sukses të profesorëve të huaj, të cilët nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë janë konsideruar si profesorë, të cilët janë falsifikuar me dokumente dhe kanë kryer punë në universitete të ndryshme. Për 42 profesorë, të cilët konstatohen nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, të cilët kanë falsifikuar dokumente, Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka bërë vepër penale sipas KIPRED, të cilin e ka të publikuar në raport, sepse asnjëherë nuk i ka bërë publike kush janë ata profesorë, cilat janë institucionet në të cilat këta profesorë kanë çuar dokumentacione false dhe asnjëherë nuk i ka dërguar në Prokurori individët, të cilët konsiderohen që kanë bërë falsifikimin.

Pra, sipas KIPRED, kjo është një vepër penale direkte e Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Për shkak të menaxhimit jo të mirë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe të Agjencisë së Akreditimit, sot buxheti i kësaj agjencie paguan ndëshkim hiç më pak se 800 mijë euro, pra për arsye të keqpërdorimit, të keqmenaxhimit të këtij institucioni. Dhe, për këtë shumë jo, për tërë shumën, për një pjesë të kësaj shume, ne e kemi dërguar një lëndë në Prokurori dhe s'kemi dashur ta bëjmë publike, sepse është çështje e Prokurorisë, e cila tani duhet të merret me këtë lëndë.

Pezullime - ka pasur programe të cilat janë pezulluar dhe është përdorur një term jologjor, i cili nuk ka qenë i përcaktuar në asnjë ligj. Mund të lind pyetja, pse pezullime për një vit? A është çështje e rregullit, a është çështje e shantazhit, a është çështje politike? Mendoni ju dhe mund të mendojmë të gjithë. Nëse nuk i ka plotësuar kriteret që një program të jetë i akredituar, është

dashur të suspendohet, jo të pezullohet. Standarde të dyfishta! Pra, ka një varg shembujsh, në të cilët janë përdorur standarde të dyfishta në institucionet e caktuara, të cilat mbeten prapë të verifikohen nga Këshilli i ardhshëm Shtetëror i Cilësisë.

Ka pasur programe, të cilat për një periudhë të shkurtër nuk janë akredituar dhe për një afat dhjetëditor janë kthyer dhe janë akredituar pas një ankese të shkurtër. Krejt këto të bëjnë të dyshosh se ka pasur përcaktime, të cilat nuk janë mbi bazën e udhëzimeve administrative dhe mbi bazën e ligjit.

Dhe, ajo çka dua ta përsëris edhe një herë, që e thashë në fjalimin tim të parë, nëse do të bëhej vlerësimi nga EQAR në vitin 2019 sipas orarit, i cili ka qenë i paraparë të mbahet, do të ishin analizuar të gjitha këto të gjetura, duke ditur se EQAR nuk bën lëshim në asnjë procedurë të veten që e ka, do të kishim përfunduar po me këtë vendim. Pra, do të ishim përjashtuar. Por, ne është dashur të ndërhyjmë dhe tani është një moment kur ne të gjithë bashkë duhet të bëjmë përpjekje dhe jemi të gatshëm që të diskutojmë se si të dalim nga kjo situatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu, ministrat atje, se ju paskan lënë vetë,

Këtu kemi një temë, të cilin e ka ftuar dy partitë opozitare për të diskutuar dhe kam përshtypjen që më së paku u ndalëm tek ajo. Nuk jam kundër debatit as për këtë tjetrën, bile do të kisha thënë nga ajo çka dëgjuam sot është i domosdoshëm një debat i gjithanshëm për arsimin në tërësi, në përgjithësi, duke filluar nga ai fillor, i mesëm dhe i lartë, super i lartë.

Por, sot këtu është ftuar debat për gjendjen që është krijuar pas vendimit të EQAR, për një vendim që i ka paraprirë asaj dhe po supozoj për të shikuar rrugët, mundësitë, se si mund të shpëtohet e çka mund të shpëtohet, se si mund të vijmë në pikën ku ishim, pa marrë parasysh se kthimi në pikën ku ishim na sjell në rrafshin e cilësisë së arsimit sërish në pikën ku ishim, nuk na bën më të mirë, nuk na bën as më të keq, sa i përket çështjes së arsimit, cilësisë së arsimit.

Këtu sa i përket kësaj pjesës tjetër, sepse sikur të ndaleshim te pjesa që ka të bëjë me EQAR-in nuk besoj se do të kishim nevojë çdo grup parlamentar të konsumonim më shumë se dhjetë minuta dhe për të dalë pastaj me konkluzione të përbashkëta se si të ecet përpara, por meqë pjesën më të madhe të kohës e shfrytëzuam për çështjen e cilësisë së arsimit, do t'i marr edhe unë disa minuta për atë.

Se mjafton të hysh në Google, të gjithë ne kemi smartfonët me veti, nuk kemi nevojë të shkojmë as nëpër zyra apo shtëpi, dhe të shohim se çka thonë ato. Testi PISA, 77% e nxënësve 15-vjeçar

nuk dinë lexim, nuk di... është raport media, rreth 40% e profesorëve në UP me plagjiaturë, s'di sa është e vërtetë, është raport media, këta të gjithë janë nëpër universitete publike e private, nga 150 - 250 shkojnë çmimet për një temë diplome në nivel bachelor, raport media prej Google, secili mund ta nxirrni këtë, s'është ekskluzivitet imi.

Pse gjendja e arsimit në Kosovë është kaq skandaloze? - kolegët nga "Vetëvendosja". Gjendja e arsimit në Kosovë e mjerueshme - kolegët nga LDK-ja. E gjeta edhe një nga LDK-ja, që konfirmon se këtu kemi një emërues të përbashkët rreth asaj se ku jemi me cilësinë e arsimit. Nuk ka dallim nga ajo që thotë PDK-ja, çka thotë "Nisma", çka thotë "Vetëvendosja", sot jemi këtu për të diskutuar jo për cilësinë e arsimit, sepse s'kemi dallime. Cilindo ta marrim nga këta 110, se ata dhjetë tjerët nuk e di çka mendojnë, thonë që gjendja në arsim është skandaloze, është e mjerueshme, dhe se duhet urgjentisht të merren masa për të filluar përmirësimin e gjendjes. Ta dimë, të jemi të qartë, të gjithë e dimë se gjendja në arsim nuk është se mund të përmirësohet me një vendim, me një akt, me një projektligj a me një ligj, ajo është një proces që përcjell gjenerata në vazhdimësi, të gjithë këtë e dimë, s'kam nevojë besoj as unë të ju mbaj ligjërata juve, as ju mua, po as të tjerëve.

Unë nuk bëj pjesë në kategorinë e atyre që hedhin përgjegjësi gjithkrah. Opozita kur është opozitë nuk e ka për detyrë, as me ide të kontribuojë e jo më me gjëra të tjera, por është në të mirën edhe të saj që të kontribuojë, jo për shkak të detyrës, por për shkak se edhe ata jetojnë këtu dhe fëmijët e tyre i rrisin këtu. Nëse nuk e ndjejnë si obligim që të kontribuojnë me ide dhe me mbështetje të Qeverisë, atëherë nuk do ta pësojnë veç fëmijët e qeveritarëve, por do ta pësojnë edhe fëmijët e opozitarëve, sepse këtu opozita dhe Qeveria nuk janë të dhëna konstante të përhershme, ato ndryshojnë, hip njëri zbrit tjetri, zbrit njëri, hip tjetri. Kjo është jeta në politikë në demokraci.

Të emëruar politikë u tha shumë për atë se nëpër borde mbrohen njerëzit në politikë. Nuk ka organ më politik se Kuvendi dhe Qeveria. Përderisa një organ e emëron Kuvendi dhe Qeveria detyrimisht që ai do të jetë politik. Çështja është nga momenti kur ata zgjidhen a veprojnë sipas politikave të Qeverisë e jo politikave të odave apo të kafeneve, po politikave të Qeverisë në kuptimin e plotë të fjalës, zbatimin e strategjive dhe politikave të Qeverisë, a e zbatojnë ligjin nga momenti kur ata e marrin atë detyrë dhe jo prej nga e kanë prejardhjen, se mund të jetë i "Vetëvendosjes", mund të jetë i PDK-së, i AAK-së i "Nismës", rëndësi ka çka bën ai nga ai moment. Dhe, unë mendoj që bordet e kaluara i kemi parë çfarë kanë bërë, agjencitë e kaluara i kemi parë çfarë kanë bërë dhe kjo quhet gjykim. Ndërsa, të paragjykos dikë ende pa e parë, pa ia dhënë shansin, të gjykos dikë ende pa ia dhënë mundësinë ajo më nuk është gjykim, ajo është paragjykim.

Kam përshtypjen se qëllimi i mirë për të ndryshuar, siç e tha edhe kryeministri, është paragjykuar, më shumë duke u kapur në procedura, se sa në përmbajtje. A ka pasur të drejtë ligjore, a e ka respektuar një procedurë në momentin kur është marrë një vendim apo nuk e ka

respektuar një procedurë. Gjendja alarmante në arsim, siç u pa nga këto që unë i thash dhe ju që i thatë, së paku unë mendoj se do të na jepte të drejtë nganjëherë t'i përshpejtojmë procedurat. Nuk mendoj se është shkelje e ligjit të shkarkosh një organ, nëse ti me ligj e ke të drejtën ta emërosh. Është çështje interpretimi pastaj a u respektua edhe një nen, edhe një procedurë, a nuk u respektua.

Mendoj se kjo çështje është dashur të kalohet në Kuvend. Ai bord është dashur të mandatohet dhe të fillojë të kryejë punën e vet dhe pastaj ta gjykojmë në bazë të angazhimeve, në bazë të veprimeve që do t'i bënte. Ajo nuk qe e thënë, nuk u bë për shumë arsye, tash nuk jemi në atë fazë për të diskutuar cilat janë arsyet pse nuk u bë, por duhet të mbështesim iniciativën, kërkesën e ministrit që e ka përcjellë te kryeministri, në mënyrë që Qeveria së bashku të dalë me... të pranojë propozimin që kjo listë të tërhiqet dhe të bëhet së bashku edhe me partitë në pushtet, edhe me partitë nga opozita, një proces tejet transparent dhe të përzgjedhim më të mirët. Por, mos kërkon jastëtokësor, ata ose do të jenë PDK, dikur do të kishin qenë ose në VV, ose në LDK. Rëndësi ka që ata të kenë kompetencën e tyre profesionale, vullnetin për të punuar dhe mbi të gjitha, ata që i emërojmë ne deputetët, Qeveria, të jemi të gatshëm atyre vetëm një kërkesë t'ua bëjmë - veproni sipas ligjit dhe vetëm sipas ligjit, se shpeshherë edhe ata nga presioni i politikës i bëjnë disa devijime atje, jo nga vullneti i tyre krejt personal.

Pra, këtu nevojitet një bashkëpunim më i gjerë në rrafshin e hapave të mëtejshëm për përmirësimin e cilësisë, para së gjithash nevojitet një strategji e Qeverisë, përkatësisht përmes Ministrisë së Qeverisë, ndërsa për këtë çështje ne jemi të gatshëm, të hapur, që të kontribuojmë edhe si grup parlamentar, besoj edhe në cilësinë e ministrit që vjen nga Nisma, gjithashtu edhe nga Qeveria, që së bashku me opozitën të angazhohemi që procesin e përjashtimit nga EQAR-i ta kthejmë në pikën zero, edhe pse siç thash në fillim kthimi në pikën zero në EQAR aspak nuk nënkupton përmirësimin e cilësisë, do të jemi aty ku kemi qenë.

Prandaj, ju ftoj që ta mbështesim ministrin. Ne do të jemi të gatshëm t'i përgjigjemi ftesës së shefit, kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së, që në fund të ulemi të shohim se çfarë mund të kontribuojmë në drejtim të rezolutës apo të përfundimeve të përbashkëta, në mënyrë që temën që e kemi ngritur këtu të sanohet që është krijuar pas përjashtimit nga EQAR-i, të bashkëpunojmë. Të tjerat pastaj janë çështje që kërkojnë muaj, vite, në mos edhe dekada. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJÀ REDŹEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Kao prvo želim da svim učiteljima na Kosovu, bez obzira na nacionalnu pripadnost, čestitam njihov dan, Dan Učitelja.

Poštovani kolege poslanici,

Predstavnici Vlade,

Poštovani građani,

Svi smo svesni činjenice da imamo velikih problema u sistemu obrazovanja, svi građani Kosova, a posebno pripadnici zajednice koju ja ovde danas zastupam. Zbog nostrifikacije diploma Bošnjaci su ugroženi, diskriminirani i za nas je to odavno političko a ne akademsko pitanje. Mi možemo da nostrifikujemo diplome u zemljama u regionu a u svojoj zemlji ne, što se direktno reflektuje da sve veći broj intelektualaca iz naše zajednice napušta Kosovo a svima je poznato da kada vam ode intelektualna elita odlaze i svi ostali.

Znate onu staru narodnu poslovicu, koja kaže: “Ukoliko želite da degradirate jedan narod, jednu zajednicu, blokirajte joj obrazovni sistem direktno ili indirektno ona će se sama asimilirati, vremenom utopiti ili nestati”.

Poštovani građani, Bošnjaci su ustavni narod i imaju pravo na svoj jezik, kulturu i obrazovanje. Više od 10 godina imamo problem sa nostrifikacijom diploma. Naši profesori ostaju bez posla i posle 20 godina radnog staža u prosveti na javnim i privatnim univerzitetima, posebno “Ukšin Hoti” i “Hadži Zeka” dovode se profesori i asistenti iz drugih zemalja bez adekvatnih kompetencija iz drugih zajednica, koji naš jezik slabo i poznaju, te je upitno i kakvi je kvalitet te nastave. A svi dobro znamo da bi i univerzitet i državu manje koštalo nego što to košta dovođenjem profesora iz susednih zemalja.

Sada ispada da je i za ovaj problem koji postoji godinama kriv ministar Bytyqi. Ne nije, gospodo, kriv. Kriv je naš obrazovni sistem godinama unazad, krivi su dosadašnji ministri obrazovanja, krivi smo mi poslanici, kriva je politika koja svakodnevno utiče na razne odluke koje se donose u obrazovnoj sferi, počev od predškolskog pa sve do visokog obrazovanja.

Poštovani ministre,

Ja sam dugo godina poslanik u Kosovskom Parlamentu i za ovom govornicom sam javno zahtevala da se ne politizuje visoko obrazovanje u nastavi na bosanskom jeziku i da to nije privatni biznis pojedinaca. Zato od Vas javno zahtevam i tražim ostavku prorektora na javnom univerzitetu “Ukšin Hoti”, Sadika Idriži, da podnese ostavku zbog degradiranja nastave na bosanskom jeziku, degradiranja naših profesora koji su osnivači tog univerziteta u nastavi na bosanskom jeziku, zbog prijema nekompetentnih kadrova na IT-smeru, sa Saobraćajnog fakulteta i smeru turizma. Profesori su primljeni političkim putem bez ikakvog profesionalnog znanja a posebno akcenat stavljam zbog otvaranja istih smerova godinama unazad, tako da sada imamo više od 200 diplomiranih učitelja a broj dece je sve manji i manji.

Poštovani građani bošnjačke nacionalne zajednice, mi to ne smemo dozvoliti i ja ću se u ovom Parlamentu boriti do kraja, ali ne mogu sama, te zahtevam sve naše nezavisne intelektualce

nevladine organizacije, medije, a pre svega profesore, studente, roditelje, da svi zajedno, jednom zauvek podignemo svoj glas i zaustavimo Sadika Idrizija, osoba koja je uzurpirala našu nastavu na univerzitetu, nastavu na bosanskom jeziku na javnom univerzitetu "Ukšhin Hoti" u Prizrenu, i pokažemo svima da Bošnjaci imaju svoj kadar, svoje ljude, svoje profesore, mlade ljude spremne da se ovom izazovu odupru. Dajmo im šansu da pokažu svoje intelektualne kapacitete i otvore nove smerove, ekonomski, pravni i sve ostale smerove, u zavisnosti od potrebe društva, kako bi smo svoju decu, svoje studente zadržali u našoj zemlji i stvorili im prostor za njihovo školovanje, zapošljavanje i egzistenciju na ovim prostorima podjednaku i ravnopravnu sa drugim narodima.

Poštovani ministre,

Univerzitet "Ukšhin Hoti" nije prostor za privatne biznise pojedinih profesora sa raznim krivičnim dosijeima, koji neko godinama unazad pokriva iz njima političkih znanih razloga. To se mora zaustaviti e neko mora snositi odgovornost i posledice zbog toga pred organima pravde a ne zloupotrebljavati konstantno studente radi svojih ličnih i partijskih interesa. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë,

Diplomati francez dhe ideatori i projektit evropian, Jean Monnet, pati thënë se "projekt i evropian mund të ketë sukses vetëm nëse qeveritë e shteteve anëtare u japin të rinjve mjetet që nëpërmjet edukimit të shfrytëzojnë plotësisht potencialet e tyre".

Pushteti në Kosovë që e qeveris vendin që nga paslufta, jo që nuk ua dha të rinjve të vendit tonë mjetet për të shfrytëzuar potencialin e tyre, por ata ua morën edhe ato pak mjete që kishin, ua morën thelbësoren, universitetin.

Konjuktura e këtij pushteti ka punuar shumë në projektin e kapjes së universitetit, si të tillë, e çdo institucioni të arsimit të lartë. Pra, qartazi ky është një projekt.

Projekti i vërtetë që i është imponuar Kosovës nuk është projekti drejt zhvillimit dhe integritetit evropian. Sepse, po të ishte ky projekti i vërtetë, rruga e duhur që do të duhej ndjekur do të ishte përmes edukimit, përmes shfrytëzimit të potencialit të të rinjve në kuadër të zhvillimit dhe të integritetit.

Projekti i vërtetë që po i imponohet Kosovës, e që po realizohet me sukses nga pushteti, është kapja e shtetit dhe shtrirja e ndikimit mbi të tashmen dhe të ardhmen tonë. Prandaj zgjedhën rrugën e shkatërrimit të potencialit të të rinjve përmes edukimit. Ky pushtet për të realizuar projektin e vet përdori edukimin, mjetin e njëjtë që pushtetet jodemokratike e kanë përdorur jo vetëm në rajonin ku jetojmë, por edhe gjetiu.

Ne e njohim këtu se çdo do të thotë kur një pushtet ka projekt kundër arsimit. Ne regjimi i Milosheviqit na i mbylli shkollat dhe universitetin. Na e pamundësoi arsimimin e kultivuar dhe përparimin e tij.

Na duhet një çlirim i dytë. Bash çlirim evropian i universitetit tonë.

Edukimi i mirëfilltë i të rinjve hap dyert për pjesëmarrje aktive të tyre në jetën politike ekonomike e sociale të vendit. Studentët e edukuar mirë nuk mund të qëndrojnë të heshtur kur iu shkelet e drejta elementare, e drejta e edukimit cilësor.

Studentët e edukuar mirë nuk do të qëndronin të heshtur as sot. Kur për shkak të ndërhyrjeve politike Agjencia e Akreditimit të Kosovës përjashtohet nga Komiteti i Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë (EQAR). Tani nuk ka asnjë garanci për cilësinë e edukimit që marrin studentët në universitetet vendore.

Kjo është më e rëndësishme se sa liberalizimi i vizave, që do të na mundësonte të udhëtonim si turistë, por jo si studentë e punëtorë profesionalë. Ky është izolimi i vërtetë. Kjo mbi të gjitha do të pengojë integrimin e arsimit të lartë të Kosovës në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

Izolimi i vërtetë është kur studentëve nuk do t'u pranohet diploma universitare në asnjë vend në Evropë. Për studentët e edukuar mirë Evropa tashmë i ka hapur dyert, sepse nevoja për punëtorë krahu po reduktohet çdo ditë e më shumë. Evropa ka nevojë për punëtorë profesionalë. Doktorët, ekonomistët e inxhinierët e dalluar tashmë mund të udhëtojnë në Evropë, jo si turistë, por si punëtorë profesionalë.

Sot studentët do të duhej të bllokoni të gjitha rrugët e Prishtinës, do të duhej të bllokoni këtë qeveri e këtë kuvend. Pra, sot studentët do të duhej të ishin në rrugë. Por, sot po qëndrojnë të heshtur.

KRYESUESI: Po më duket je duke thirrur për luftë, unë ta ndërpres fjalën, ndërpreja fjalën, ndërpreja fjalën, prej Parlamentit nuk ke të drejtë të thërrasësh protesta. Kush ta ka shkruar fjalimin, le ta lexojë ai vetë.

Mimoza Kusari Lila e ka fjalën.

(Ndërhyrje në sallë)

Jo, o, nuk ia jep fjalën. Nuk duhet thirrur për luftë prej Parlamentit, ju e keni djegur Parlamentin e Kosovës, i keni djegur rrugët dhe qytetet, ju nuk keni të drejtë të thirrni për luftë këtu, shko në vend, shko në vend sa s' ka intervenuar policia, shko në vend.

Shiko, zonja Pacolli, a ka mundësi veç diçka?

(Ndërprerje e incizimit)

Lëshoja, le të vazhdojë, se nuk dua të terrorizohet kështu. Regjia, jepja fjalën, veç leje thirrjen për protesta.

FITORE PACOLLI: Sot Kosova është në krizë ekonomike, sociale e politike. E ardhmja juaj, studentë të dashur, dhe e vendit tonë gjendet para një pikëpyetje të madhe, rruga jonë drejt Evropës duhet të jetë përmes edukimit dhe zhvillimit dhe jo përmes nënshtrimit e faljes së tokës dhe burimeve tona ujore.

Nuk do të ketë integrim e as avancim të agjendës sonë evropiane përmes kopjimit të ligjeve, të cilat votohen, por kur nuk implementohen, e as përmes plagjiatit arsimor.

Sot të gjitha raportet e progresit të publikuara nga Komisioni Evropian shkruajnë për partizim dhe degradim të arsimit. Të gjitha raportet çdo vit përsëriten këto dy fjali, citoj: “Kosova nuk ka adresuar rekomandimet e vitit të kaluar” dhe prapë citoj fjalia e dytë: “Arsimi mbetet një sektor me rrezik të lartë për korrupsion dhe ndikim politik, veçanërisht arsimi i lartë”.

Integrimi i vërtetë evropian bëhet kur forca punëtore e Kosovës të mund të integrohet në institucione e industri evropiane. Kjo arrihet vetëm përmes investimeve në sistemin e edukimit, përmes departizimit të arsimit dhe përmes avancimit të punës kërkimore e shkencore.

Edukimi cilësor është nevojë urgjente për të ardhmen tonë në shoqërinë evropiane.

Të dashur studentë,

Ju jeni gjenerata e së tashmes dhe jeni ju ata që trasoni rrugën e gjeneratës së ardhshme dhe përcaktoni të ardhmen e këtij vendi. Prandaj, nuk duhet të qëndroni të heshtur. Ndryshimet e mëdha në botë i bëjnë studentët.

Ne si deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje” kemi për të qenë atu, me ju, përkrah jush, në përpjekje për ta çliruar universitetin nga kapje.

Ne jemi me ju, sepse ju jeni garancia e Kosovës për nesër. Faleminderit! Herën tjetër mos ma ndal fjalën kur flas.

KRYESUESI: Të ndalet fjala sa herë të thirrni dhunë, protesta e luftë prej foltores së Kuvendit.

Zonja Lila e ka fjalën. Me keqardhje e thashë, por nuk ka kuptim prej foltores të thirren protesta as dhunë.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Veç për t'ju rikujtuar, ky debat është thirrur sot si debat parlamentar për të diskutuar pse Agjencia Kosovare e Akreditimit, se kryeministri e pruri këtu edhe këtë temë, është përjashtuar prej EQAR-it.

Megjithatë, prej krejt kronologjisë së prezantuar edhe prej ministrit të Arsimit, edhe prej kryeministrit, në letrën shpjeguese nga EQAR-i në asnjë fakt nuk është vënë një germë që e tregon arsyen e mirëfilltë pse këta njerëz janë shkarkuar.

Letra e parë, e cila është drejtuar për Ministrinë e Arsimit, daton më 2 tetor 2017.

Letra kërkuese për ministrinë, për shpjegimet për shkarkimin e anëtarëve të Bordit dhe drejtorin daton më 6 tetor.

Letra kthyese e ministrit është më 12 tetor dhe të vetmin arsyetim ose argumentim të qëndrueshëm që ministri i Arsimit ia dërgon EQAR-it është që është bërë me kërkesë të kryeministrit. Prapë ka deklarata, letër-shkëmbime deri te letra e fundit më 15 janar 2018, ku ministri prapë e thekson se kërkesa është bërë nga kryeministri për shkarkimin dhe Bordit dhe se konform me Ligjin e arsimit të lartë në Kosovë do të emërohen anëtarët e rinj të Bordit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Megjithatë, ministri dhe Qeveria e Kosovës e kanë shkelur me të dy këmbët Ligjin e arsimit të lartë, duke e shkelur nenin 7, pikën 5, ku thuhet: “Nëse tre anëtarë të Bordit shkarkohen në një periudhë më të shkurtër brenda vitit duhet të iniciohet debat parlamentar”.

Sot këtu dëgjuam çdo gjë, dëgjuam gjithashtu se u fajësua opozita pse është tërhequr lista për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit dhe pse nuk është votuar. Po herën e parë ky ligj është shkelur nga vetë Qeveria dhe nga ministria.

Krejt çka ka kërkuar opozita është ligjshmëri dhe kjo ligjshmëri ka të bëjë me atë që duhet ministri vetë të raportojë para këtij Parlamenti, se cilat janë arsyet të cilat sot i tha nëpër të, por nuk i tha tamam me emër siç duhet t'iu kishte arsyetuar edhe EQAR-it.

Që sot e kësaj dite në arsyetimin final, i cili është publik, edhe është i publikuar, tregon se përndikime politike dhe përqëndrueshmëri dhe mungesë kredibiliteti është përjashtuar Agjencia Kosovare e Akreditimit.

Ky vendim në esencë nuk është ndonjë përjashtim i rastit i vendimmarrjes së Qeverisë Haradinaj, me këtë vendim vetëm ka hasur sharra në gozhdë, edhe Kosova është penalizuar në mënyrë se si është penalizuar, se mungesa e ligjshmërisë së Qeverisë Haradinaj është vërejtur. Deri më tash i kemi një mori vendimesh të jashtëligjshme që i ka marrë kjo Qeveri.

Ajo çfarë ka ndodhur ne mund ta shohim si mënyrën më të mirë të mundshme se si komunikon kjo Qeveri me njerëz e vet. Kjo Qeveri komunikon në formën brutale, komunikon me ofendime. Kryeministri këtu del dhe bërtet e u ngërthehet të gjithëve në Parlamentin e Kosovës, duke u thënë: “Çka keni bre, a krejtëve ju paskan pagu”.

Përgjigja jonë për kryeministrin është shumë e thjeshtë: Jo, kryeministër, mos na mat me kandarin tonë, se nuk blihemi na këtu të gjithë, edhe nëse ata paskan marrë para dhe nëse ata realisht e paskan shkelur Kodin Penal të Kosovës, për informatat që ti i ke, ti je përgjegjës njëjtë para Kodit Penal të Kosovës, se pse nuk i ke dërguar në prokurori. Dhe, dërgimi në prokurori i një krimi penal që ndodh nuk është informatë e klasifikuar, e cila nuk duhet t’u komunikohet të tjerëve, në të kundërtën, e kish rritur kredibilitetin e kësaj qeverisë se po e lufton krimin dhe korrupsionin.

Pse nuk e zgjedh Qeveria e Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Republikës mekanizmat ligjorë për t’i zgjidhur rastet e korrupsionit ose krimin. Pse e zgjedh formën brutale të komunikimit me deputetë, në mënyrën më të vrazhdë të mundshme, për t’u treguar deputetëve se po i vjen rëndë nëse thirret në debat parlamentar, se nuk është interpelancë, interpelanca tjetër po i përgatitet. Po kjo është demokracia dhe kjo është forma kur një Qeveri e refuzon të funksionojë në një demokraci parlamentare.

Përndryshe, ministër, me krejt respektin për angazhimin ose përkushtimin që po mundoheni ta tregoni, nëse jeni bashkë për depolitizim të arsimit, a mund të na shpjegosh si u bë që sekretar i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë u zgjodh një njeri që nuk e pati as rekomandimin e Ministrisë së Administratës.

Në mbledhjen e Qeverisë, për institucionin që ju e drejtoni, ministri i Administratës Publike ka dalë edhe ka thënë prej 15 kandidatëve, të cilët kanë aplikuar për sekretar të përhershëm në Ministrinë e Arsimit, asnjë nuk i ka plotësuar kushtet, ju prapë e keni zgjedhur, ka rastisur të jetë ish-shefi i prokurimit në Komunën e Malishevës.

Çfarë ligjshmërie ose çfarë kredibilitetit po tregon që ju doni si Qeveri e re të realizoni, ku menjëherë në rastin e parë e bëni shkeljen e radhës. Cili është serioziteti i kësaj Qeverie nëse e shkelim ligjin, cili është serioziteti ynë, gjithë së bashku, ku si Parlament i Republikës së Kosovës kemi miratuar një buxhet 2 miliardësh, prej të cilit vetëm 3% shkojnë në arsim, po flasim se e kemi seriozisht për arsimin.

Prej 3-përqindëshit ose afro 60 milionë që janë për Ministrinë e Arsimit, 40% janë për investime kapitale, ose ndërtesa, 30% janë për rroga, paga dhe mëditje. Vetëm 30% të tjera që kanë mbetur janë për shpenzime operacionale ose investime çfarë do, në kurrikulë ose në kreativitet të fëmijëve nëpër shkolla. Nuk e kemi seriozisht, nuk e kemi seriozisht arsimin. Sikur ta kishit seriozisht arsimin, kryeministri kish pasur durimin dhe qëndrueshmërinë të qëndrojë në këtë debat dhe të dëgjonte, e ta kuptonte që edhe ne e kemi njëjtë sikurse të gjithë të tjerët që e duam Kosovës. S'kemi ardhur këtu të nxjerrim askënd në shpoti, po kemi ardhur të kuptojmë saktë e drejt pse një ministër i Arsimit e shkel ligjin me argumentin e vetëm para institucionit ndërkombëtar që e ka me urdhër të kryeministrit.

Ne po duam të dimë saktë, a është Blerim Rexha rasti kryesor? Pse nuk janë informuar dy ambasadat, të cilat i kanë paguar dy ndërkombëtarët e tjerë për shkarkimin e anëtarëve të tyre? Nuk kanë qenë të paguar prej buxhetit të Kosovës, ata i ndihmojnë sistemit të arsimit të Kosovës.

Tjetra, u tha që kemi të tjerë që vijnë dhe e shajnë Qeverinë e vet para ambasadave. Nëse e vërteta ju dhemb, e vërteta është këtu, nuk është çka flitet nëpër ambasada. E para.

E dyta, ajo çka është prezantuar në letrën e EQAR-it, është e zeza në të bardhë, çdo gjë është e përshkruar. Në asnjë rast nuk thotë se është bërë prej fjalëve vetëm të Blerim Rexhës.

Tri herë kanë synuar dhe kanë kontaktuar me institucionet e Kosovës, dy herë me ministrin dhe një herë me ushtruesin e detyrës së Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Të mos i kryqëzojmë njerëzit këtu, me t'i ofendojmë e t'i shajmë pa pasur argumente.

Përfundimi i Kosovës ka ndodhur në faza, ka ndodhur në letrën e parë, të dytë, të tretë, shtatë dokumente janë të publikuara sot në korrespondencat mes EQAR-it, Agjencisë Kosovare të Akreditimit, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Krejt çfarë ne kemi bërë, janë ato çfarë duhet secili qytetar i Republikës së Kosovës sot ta dijë se pse Agjencia Kosovare e Akreditimit sot është jofunksional. Kjo përgjigje duhet të dalë nga ky debat parlamentar. Nuk kemi nevojë as të ofendohemi, as sharje, as fyerje, as të shantazhohemi. Na jepni përgjigje pse në Kosovë sot nuk kemi Agjenci Kosovare të Akreditimit funksionale? Kjo është çfarë kërkojmë.

Argumentet dhe patriotizmat e tjerë i lëmë për rrafshë të tjera. Parlamenti i Kosovës ka nevojë për përgjigje të sakta për qytetarët e saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht, është bërë një shprehi e keqe që sa herë të flasë dikush prej “Vetëvendosjes”, pavarësisht përmbajtjes së fjalimit, të ngutet në ndaljen e fjalës.

KRYESUESI: S’është e vërtetë, edhe ty ta ndali fjalën, në qoftë se prej foltores të Parlamentit bën thirrje për dhunë. Diskuto çka të duash, kritiko Qeverinë, kritiko kryetarin e Parlamentit, kritiko presidentin, po jo kështu. Jo kështu, se mjaft më me revolucionarë. Revolucionarë pa dhunë nuk është mirë të bëheni, askush s’ka ushtruar dhunë ndaj jush.

SALIH SALIHU: Më së pari, kryesues, ke qenë jashtë vendit, e di mirë që demonstratat, protesta, është mjet demokratik dhe ka të drejtë

KRYESUESI: Jo, jo, prej foltores së Parlamentit nuk ndodh kurrë në ndonjë vend të thirren protesta, kurrë. Nëse ma gjen një shembull që një deputet se ne nuk kemi të drejtë t’jua marrim mandatin dikujt, po në Parlamente serioze të Evropës i merret mandati deputetit me Rregullore dhe me Kushtetutë, në qoftë se bën akte të thirrjes për dhunë jashtë Parlamentit të Kosovës.

(Polemikë)

SALIH SALIHU: Mos more...!

FITORE PACOLLI: ...Ju jeni duke shpifur, nuk bëra thirrje për dhunë, bëra thirrje për protestë demokratike....

KRYESUESI: Hajt se mirë e ke lexuar, e kishe mësuar gati përmendsh fjalimin, mirë e ke.

SALIH SALIHU: Kryesues, fjala ishte vetëm për protesta, edhe unë po mendoj se në çfarë gjendje është arsimit në Kosovë, vërtet ishte dashur sot qytetari i Kosovës, studentët, të dalin në protesta.

Fatkeqësi, duke e ditur që universiteti është tamam një promotor i lëvizjeve politike në Kosovë. Për këtë arsye universiteti është i kaptë, kryesues dhe jo veç universiteti, ju e dini mirë se shkaktar për këtë gjendje të rëndë të arsimit në Kosovë është vetë politika prej lufte e këndeje. Duke u nis prej universitetit

KRYESUESI: Me siguri që politika e Serbisë ka qenë më e mirë, sipas jush.

SALIH SALIHU: Jo, të gjithëve mund t’ua linë fajin, ama veç politikës së Serbisë jo prej luftës e këndeje, për universitetin, sepse askush nuk ka faj që t’i investon vetëm 2%, 3% të buxhetin në arsim. Ndërkaq vendet e tjera, madje për shembull, izraelitët 30% të buxhetit e ndajnë për arsim.

Paramendoni sot, njerëzit izraelitë janë nëpër sistemet më të mëdha bankare evropiane, amerikane, e sot studenti ynë duhet të presë për një vizë për ta marrë për studentë.

Dhe, kjo është pasojë e gjendjes suaj që e keni politizuar çdo gjë.

Dhe, a nuk është politike, për shembull, për njerëz në Akademi, merren vesh dy parti politike dy t'i dërgojë LDK-ja, dy PDK-ja, nuk është kjo zgjidhje politike?

Këtu duhet ai që e meriton, ka plot njerëz të sinqertë në universitet, ka plot njerëz të sinqertë edhe në Akademi, por kurrë i merituari nuk po vjen në shprehje, për shkak se politika po i shti duart.

Tjetër, edhe te avancimet kemi problem, avancohen vetëm njerëzit që janë të një partie politike, ose që i përkasin, janë në lidhje të ngushtë me politikën.

Kthehemi te universitet. Universitetet publike, kryesues, por edhe universitetet private janë bërë më tepër sot sikur ndërmarrje punësimi, nuk ka cilësi, më tepër interesohemi qysh të hyjë një njeri në punë, se rrogat janë shumë të larta, por askush s'po kujdeset për cilësi.

Me vetëm 3% dhe me vetëm një milion euro për hulumtime shkencore, ne nuk jemi të konkurrueshëm në tregun evropian, pa hulumtime shkencore të mirëfillta.

Ne sot në Universitetin e Prishtinës nuk bëjmë shkencë, kryesues, ne sot në Universitetin e Prishtinës bëjmë vetëm ligjërata, ligjërata, në shkollë fillore a në shkollë të mesme.

Dhe, këqyrni mirë se si i trajtoni arsimin. Ju e dini shumë mirë, kryesues, që arsimi në Kosovë para luftës është quajtur "shtyllë e pavarësisë së Kosovës". Sot atë 'shtyllë të pavarësisë së Kosovës' ju vetë po e degradoni.

Sot ju atë kontribut që e kanë dhënë mësimdhënësit para luftës, 10 vjet pa para, sot po pritni edhe pesë vjet këtë ligj të mos e bëni, derisa të vdesin krejt, se edhe pesë vjet asnjë njeri që ka punuar para luftës më nuk është i gjallë. Kjo nuk është e rastësishme. Ju vetë po doni të shkatërroni arsimin e Kosovës. Mbani mend se baza e zhvillimit ekonomik të një vendi, kryesues, konsiston në arsimin dhe edukimin e mirëfilltë dhe ne nuk kemi edukim dhe arsimim të mirëfilltë, prandaj nuk ke edhe zhvillim ekonomik në Kosovë, se prej një universiteti burojnë të gjitha kuadrat, ku e ndihmojnë zhvillimin ekonomik të këtij vendit.

Prandaj, nuk jemi rastësisht në këtë pikë ku jemi. Hiqni duart prej universitetit, hiqni duart prej Akademisë, lironi duart e njerëzve që janë tamam profesionalistë, profesorë të ndershëm, quadro të forta që kanë doktoruar jashtë e brenda, e le të punojnë, se kështu qysh ia kemi mësyre na, për

besë veç ka me na u sjellë kjo situatë dhe kurrë nuk do të mund të zhvillohemi dhe as t'ua japim shansin.

A e dini, kryesues, kush studion sot jashtë vendit? Veç djemtë tanë, të politikanëve, djemtë e deputetëve, djemtë e politikanëve, ata që janë të varfër, s'kanë shans të shkojnë jashtë vendit.

Dhe, unë po ju them, në qoftë se ju vetëm 15 milionë euro në vit i ndani për doktorantë, me 15 milionë euro 500 doktorantë në vit mund t'i dërgojmë jashtë vendit. Çka do të thotë kjo? 30 deri në 40 mijë euro një student për doktoratë i duhen në vendet evropiane, që i bie se 500 doktorantë nga 30 mijë euro, bëjnë 15 milionë.

Paramendoni efektin e këtyre 15 milionëve në vit kur 500 vetë i çojmë jashtë vendit për tre vjet bëhen doktorë shkencash, 100 dështojnë, 400 e kryejnë. Prej 400, në qoftë se 200 i punëson në Perëndim në organizma ndërkombëtarë, qoftë sportive, politike, ekonomike, sisteme bankare, do ta shihni mirë efektin e këtyre njerëzve për Kosovën se çfarë lobimi mund të bëjnë.

Ndërkaq, sot shkojnë vetëm fëmijët tanë, të politikanëve që kanë mundësi financiare, e fëmijët inteligjentë që nuk kanë kushte mbesin dhe përfundojnë dhe ajo dije shuhet.

Prandaj, jepni shans edhe për ata që s'kanë, jepni buxhet më shumë për arsim, depolitizoni universitetin, lenia duart e lira universitetit, se ndryshe nuk zhvillohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! 100% edhe unë jam me ty. Po mund ta zhvillojmë atë, është më mirë se gjithçka. Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Pajtohem plotësisht që shumë gjera tash u thanë në mënyrën e vet edhe nga kolegë deputetë, edhe nga raporti, edhe ata që janë më të involvuar në këtë proces.

Unë nuk po bëj thirrje nga ajo çka e tha Fitorja, jo pse po frikohem nga ndalja e fjalës, por po bëj thirrje për ndërgjegje më shumë të gjithë atyre që janë bartës të një procesi, i cili jo veç që është i domosdoshme për zhvillimin institucional e jetën në përgjithësi në Kosovë, por është më shumë edhe ana morale, edhe e kaluara e Republikës së Kosovës në të gjitha këto etapa.

Tash kemi dy fakte që janë para nesh, është një rezultatet e PISA-s dhe tash largimi i Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga Rrjeti evropian për sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë.

Dhe nëse ne e dëshirojmë që të mbizotërojë arsyeja, se këto të dyja duhet heshtur dhe të lejojmë vendime partizane, ndërhyrje politike në tërë sistemin arsimor, krejt çka fitojmë është vazhdimi i avancimit të të paditurve në sistemin tonë shoqëror, e sidomos edhe në këtë qeveritar. E tash kjo

tendencë shihet jo si çkapje, siç po thuhet, por është më shumë si ndërhyrje mbi ndërhyrjet e këqija që kanë ndodhur edhe nga e kaluara.

Për të mos u përsëritur nga shumëçka çka u thanë, më lejoni të potencoj vetëm dy aspekte dhe të cilat ndoshta më shumë më bën që ta marr fjalën. Dëgjova që këto ditë është arrestuar pronari i Universitetit Kristal të Tiranës për shitjen e diplomave në Kosovë. Nga përvoja ime këtu që kam pasur, shpeshherë njerëzit që kanë konkurruar kanë pasur edhe certifikatë të atyre diplomave dhe kjo është njëra anë e medaljes. Ana tjetër e medaljes është jo vetëm nga universitetet tona publike, që deshëm a s'deshëm, na pëlqej apo s'na pëlqej ta pranojmë, të gjitha universitetet publike udhëhiqen nga rektorët që kanë ardhur nga politika. Nëse ka dikush ndryshe ose nëse ka ndonjë përcaktim tash që ka ndryshuar në atë fakt, unë besoj në të kaluarën e tyre akademike, në thirrjet akademike, por nuk mund të anashkalojmë që kanë qenë politikanë, deputetë, ministra, e tjerë.

Andaj, nuk mendoj që duhet të anashkalojmë këto fakte, apo të tentohet të minimizohen, mbi të gjitha të kemi dhe thirrje e nuanca ashtu siç ishte nga kryeministri i Kosovës. Sepse ju nuk i ndalët fjalët kur tha për një person që është hajn. Nëse është hajn dhe e di që është hajn, që unë nuk po dyshoj që mund të jetë një prej tyre, duke marrë parasysh defektet që kanë ndodhur në organizatat që ai ka mundur të udhëheqë, por moslajmërimi i veprës penale automatikisht për një zyrtar të lartë publik krijon një vepër tjetër penale. Kjo është fshehje, sidomos që kanë të bëjnë me korrupsionin zyrtar dhe moskryerjen efektive të detyrës zyrtare. Dhe, mbi të gjitha, ajo çka më së shumti nuk po merr apo kryesorja e cila nuk po merr përgjigje, zoti ministër, në të gjitha diskutimet dhe në të gjitha informacionet që ju i thatë që keni edhe informacione jo të duhura nga Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe në të gjitha këto që po i potenconi si ndërhyrje, ju lutem, unë po e përfundoj me një kërkesë, tregonani, tregojini Kuvendit të Kosovës, tregojuni qytetarëve të vendit pse janë shkarkuar këta njerëz? Sepse askush nuk besoj që është sot i thirrur as t'i mbrojë as t'i vlerësojë, do t'i vlerësoni ju dhe do t'i vlerësojë ligji, por ju tregoni pse janë shkarkuar dhe çka duhet të bëjë Kuvendi i Kosovës nëse ju nuk mund ta bëni.

Nëse nuk mund Qeveria e Kosovës, nëse janë këta njerëz mbi ligjin, mundësinë për t'i shkarkuar e keni pasur, por mundësia për t'i nxjerrë para ligjit atëherë le të dalë, le të jetë deklarative dhe të merren edhe instancat e tjera, sidomos drejtësia, sado që e brishtë është në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Arbërie Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë po mundohem të mos përsëris ato që i folën parafolësit, por edhe pse kryeministri nuk është këtu, besoj që i ka personat, të cilët ia përcjellin, këshilltarët e tij. Ne sot dëgjuam nga kryeministri një fjalim mjaft emocional, me një pranim të pjesshëm të fajit, me kërkesë për

mirëkuptim, e deri te akuzat shumë të rënda për individ të caktuar. Duhet thënë që në fillim që ne jemi të gatshëm të mbështesim çdo iniciativë të kryeministrit për të vendosur kritere të mirëfillta dhe t'i zgjedhim më të mirët, por kryeministri duhet të deklarojë se a është i gatshëm t'i dorëzojë në prokurori shkeljet për të cilat ai foli këtu dhe nëse fëmijët po i dhimbsen, ashtu sikurse ai deklaroi, rruga për të ofruar zgjedhjen më të mirë është pikërisht duke vendosur kritere të mirëfillta dhe duke i adresuar të gjitha shkeljet dhe vendimet e tij të dëmshme në prokurori.

Duhet përsëritur edhe një herë që ne nuk mbështesim as Blerim Rexhën, as Këshillin e kaluar, e asnjë organizëm apo individ, të cilët kanë bërë shkelje dhe, edhe më herët ne i kemi dërguar kritikën tona dhe sikur të ishin dëgjuar dhe marrë parasysh me kohë, ka mundur të shmanget edhe kjo situatë në të cilën sot jemi. Dua të përmend se ne kemi adresuar çështjen e obligimit ligjor të ministrit për të raportuar në Kuvend për shkeljet që nga 4 tetori i vitit të kaluar, pra menjëherë pas marrjes së vendimit të tij. Do të ndalem pak edhe te fjala e ministrit, ministri përmendi se e kemi gjetur agjencinë të pavarur me ushtrues detyre për vite të tëra, unë besoj që ai e di pse ligji e përcakton saktë se ushtrues detyre nuk mund të qëndrojnë një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj. Andaj, unë nuk e kontestoj këtë, por ia bëj edhe ministrit të njëjtën pyetje: çfarë ka ndërmarrë në lidhje me këto agjencinë dhe këto raste, kur ai thotë se kanë gjetur persona për vite të tëra? A i keni dërguar këto shkelje në prokurori dhe, në anën tjetër, a ka përfunduar kjo praktikë dhe a i keni zgjedhur udhëheqësit e rinj konform legjislacionit në fuqi?

Ministri po ashtu e përmendi disa herë që ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore pas shkarkimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, po ashtu se bile ka propozuar anëtarë të rinj dhe se listën e ka dërguar te kryeministri. Për këtë iu referua nenit 7, pika 4 e Ligjit për arsimin e lartë. Për hir të së vërtetës dhe për informatën e qytetarëve, duhet të përsëritet se, ministër, nuk e keni përbushur obligimin ligjor për të raportuar në Kuvend. Pika 5 e nenit 7 decidivisht e parasheh këtë gjë dhe po e citoj këtu nga ligji: “Nëse më shumë se 1/3 e anëtarëve të Bordit zëvendësohet për çfarëdo arsye brenda një viti, ministri duhet t’ia raportojë këtë Kuvendit”. Pra nëse vetëm tre anëtarë do t’i kishit shkarkuar, keni pasur obligim ligjor që të raportoni në Kuvend, por ju keni shkarkuar nëntë anëtarë dhe po ashtu iu referuat pikës 4 dhe thatë se keni marrë përgjigje nga departamenti juaj i juristëve, nga zyra ligjore, më vjen keq t’ju them, por zyra ligjore, ose nuk janë të kualifikuara sa duhet ose qëllimisht ju kanë vënë në lajthitje, nëse qëndron kjo që e deklaruat, sepse neni 4 po ashtu e parasheh saktësisht dhe nuk ka asnjë hapësirë që të dilema as për ratifikim, as për mosraportimin e anëtarëve në Bord.

Po ashtu, ministër, ju duhet të keni parasysh edhe një çështje, thatë se pasi që keni propozuar anëtarët e rinj, i keni dërguar kryeministrit listën me emrat e anëtarëve të ri. Ligji e përcakton saktë, ministër, ratifikimi bëhet nga Parlamenti, jo nga kryeministri. Ju mund të konsultoheni me kryeministrin për emra të caktuar, por në pikën 4, të cilës ju iu referuat, përmendet saktë që ratifikimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë bëhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pra nga ky institucion. Deklaruat edhe një çështje, thatë se keni planifikuar apo jeni dakorduar, apo jeni i

gatshëm të bëni verifikimin e listës me emrat e propozuar për anëtarët e rinj të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Unë besoj se kjo nuk është as mënyra e duhur e as profesionale, sepse duhet të përcaktohen qartë procedurat dhe kriteret se si do të vazhdohet tutje. Nuk është e rrugës që ne të merremi me verifikime, edhe pse nuk e kuptoj çka keni menduar kur keni thënë se duhet të bëhet verifikimi i emrave të listës, por ka një rrugë të qartë, ku ne duhet të bazohemi në kriteret, të cilat janë të përcaktuara, në profesionalizëm dhe në integritet personal të personave apo emrave që ju i propozoni.

Meqenëse u përmend edhe një çështje nga parafolësit, u tha se po kërcënohet me përjashtim nga rrjeti Evropian i cilësisë në arsimin e lartë, duhet bërë të ditur për qytetarët se Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë është vetëm një organizëm, i cili është themeluar nga Rrjeti evropian i cilësisë për arsimin e lartë dhe veprimi i tillë, domethënë kjo mund të çojë më tutje me përjashtimin e Agjencisë Kosovare edhe nga Rrjeti evropian i cilësisë në arsimin e lartë dhe kjo nuk duhet të merret si kërcënim, por duhet të shihet si një situatë, e cila mund të ndodhë dhe të merren të gjitha masat që të përjashtojmë këtë.

Për më tepër, ka shumë mundësi që ky veprim të ndikojë edhe në anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizma dhe institucione të tjera ndërkombëtare dhe vendimi që tashmë është marrë për përjashtim nga EQAR mund të ketë pasoja edhe më tutje. Edhe një fakt dua të përmend në fund, deputetët nga pozita akuzuan se është Kuvendi ai që ka vonuar ratifikimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë që është propozuar. Duhet bërë me dije se shkarkimi i Këshillit Shtetëror të Cilësisë ka ndodhur më 25 shtator të vitit 2017, pra diku gjashtë muaj prej tani. Sot jemi në muajin mars, kjo pikë ishte planifikuar për seancën e 8 shkurtit dhe atë si pika e 12-të, dhe seanca e 12 shkurtit dhe gjegjësisht ardhja deri te pika e 12-të e kësaj seance nuk ka ndodhur akoma, kështu që duhet të kemi parasysh që situata dhe mosratifikimi i emrave të rinj ka ndodhur pikërisht për shkak të neglizhencës së ministrisë dhe, në anën tjetër, duhet të kemi parasysh se nuk mund të ratifikojmë anëtarët e rinj përpara se të vendosim, gjegjësisht të bëhet raporti juaj për shkarkimin e Këshillit të kaluar të Cilësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nezir Çoçaj, le të përgatitet Teuta Haxhiu.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk po dua të përsëris atë fjalën time më herët, kur fola në emër të grupit, po as të shumë kolegëve, por ajo që më shqetëson më së shumti nga ky debat është ajo që dëgjohet nga kolegët të opozitës, më së shumti, por edhe të pozitës.

Sinqerisht në këto dy legjislatura, sa jam deputet i këtij Kuvendi, asnjëherë asnjë fjalë të mirë nuk e kam dëgjuar për Republikën e Kosovës. Të gjitha segmentet dhe sektorët e Republikës

kanë qenë të fyer, të denigruar në mënyrën maksimale, shëndetësia, arsimiti, Qeveria, Kuvendi, Presidenti, universiteti, shkolla, çerdhet, kjo situatë është sinqerisht shumë serioze. Unë nuk e di tash a duhet të mendojë dikush që ka punuar për këtë vend, që ka luftuar për këtë vend, që e ka dhënë familjen për këtë vend, të mendojë a ka qenë situata më e mirë në kohën e Serbisë, a në kohën e sotme?

Kjo është e paarsyeshme dhe e pakuptueshme. Unë po ashtu kam dëgjuar nga shumë të rinj dhe studentë që sa herë po jepet një emision seanca e Kuvendit, asnjëherë s'e shikojnë, por më shumë po lexojmë, e ndoshta edhe kjo ka qenë arsyeja që sot Universiteti i Prishtinës është në vendin 3320, e në sa ka qenë, në vendin e 9 mijë, a 10 mijë a 13 mijë përpara. Tjetra, e kisha lutur zotin ministër, të mos e pezullojë këtë Bord, por t'i shkruajë ENQA-s, jo EQAR-it, ENQA-s, thuaj që ne nuk jemi nga ajo që dëgjohet në debatet e deputetëve të Kosovës. Thuaj që ne nuk jemi, sistemi arsimor është i tmerrshëm, prandaj mos na merrni në qafë të na shtini me zor në institucionet ku s'e meritojmë. Po e them, jologjikshëm, po sinqerisht mua këto fjalime jashtëzakonisht po më pengojnë. Ne duhet të komunikojmë në mënyrë profesionale, si ta ndihmojmë, si ta përkrahim çdo institucion, prej çerdheve, deri te Akademia, ne e kemi obligim që të punojmë dhe t'i ndihmojmë, por jo në këtë mënyrë, sidomos për Ditën e Mësuesit kemi folur fjalët më të rënda për sistemin e arsimit.

Unë pajtohem që sistemi ka vend për t'u përmirësuar, duhet të përmirësohet, duhet ta ndihmojmë, por jo që është në këtë gjendje, sepse po dalin kundërthënëse gjërat. Domethënë, më mirë kemi qenë në sistemin e Serbisë, se sa sot që jemi në shtetin tonë, për të cilin kemi punuar, e kemi luftuar, kemi dhënë gjak e mund, e ka shumë studentë e shumë të rinj që janë mburrur me Kosovën, shumë studentë që kanë dalë nga Universiteti i Prishtinës dhe universitetet e tjera kanë pasur dhe kanë arritur rezultate atje. Nuk dua ta mbroj as Blerim Rexhën, absolutisht, nëse dikush është hajn, ai ka një emër dhe një mbiemër, por Blerim Rexha dhe studentët e tij kanë bërë projekte për NASA-n, është një emër i respektuar në shkencën tonë, por nëse ka bërë vepër të tillë, sa më shpejt ta fusin në burg, jo vetëm Blerimin, por edhe Nezirin, edhe të tjerët.

Por, ne nuk duhet në këtë mënyrë të luftojmë, nuk duhet për një person, gjithë Agjencinë ta gjuhëzojmë. Pikërisht në raportin e MSA-së arsimiti ka qenë i vlerësuar sidomos në raportet e fundit, sepse aty ka shkruar shumë qartë që ka pasur ngritje në çdo sferë, prej parashkollorit deri në arsimin e lartë, për atë punë edhe jemi pranuar edhe në ENKA, edhe në EQAR. Kështu që është mirë t'i ndihmojmë të gjithë, e sidomos veten në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të flasësh për depolitizim të arsimit, do të duhej të flasin ata që vërtet janë jashtë politikës, e aq më tepër që nuk ndërhyjnë në institucionet e arsimit të lartë. Unë kam një pyetje për zonjën Kusari-Lila: a jeni anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit të Gjakovës? A e quani ju këtë politikë, a e quani këtë ndërhyrje, le ta dijë opinioni, a jeni apo nuk jeni ju anëtare e Këshillit Drejtues në Universitetin e Gjakovës? Zonja Lila, po pres përgjigje prej jush.

KRYESUESI: A e kreve a? Ia ke përmendur emrin, ka të drejtë në replikë, unë mendova që do të diskutosh.

MIMOZA KUSARI-LILA: Unë jam shumë e lumtur që sa herë e marr fjalën për çfarëdo teme, më rrinë disa pararoje këtu të bëjnë replikë. Po dua t'u them që krejt debatet, të cilat i keni ose të cilat i kërkon me mua, mund ta caktoni një seancë të veçantë, nëse keni ende dhimbjen e Gjakovës, edhe atë mund ta bëjmë me terapi kolektive, si të doni, si t'jua merr mendja, hiq fare nuk është problem.

Të kthehemi në temën e sotme që jemi duke e diskutuar, përgjigjet po i presim, pse sot jemi pa Agjencinë Kosovare të Akreditimit funksionale? Krejt çka i doni të tjerat personale, caktoni seanca, procedurat i dini, njëjtë sikurse ne e thirrëm debatin parlamentar dhe debatojmë pa problem. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, Teuta!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

A ka Gjakova njerëz ekspertë që mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues dhe të mos jeni ju, që jeni edhe deputete, edhe anëtare e Këshillit Drejtues. Dhe, në rangimin në vitin e fundit kur keni qenë, do të thotë dhe jeni ende, sepse në ueb faqe ende figuron emri juaj, mund ta shikojnë secili prej qytetarëve, edhe përkundër protestave të vazhdueshme prej studentëve të Universitetit të Gjakovës, kundër jush, sepse po të kishit qenë në interes të universitetit, nuk është se kishin protestuar, do të thotë Universiteti i Gjakovës është ranguar për 1 mijë e 343 vende më poshtë, do të thotë shumë keni kontribuar në rangimin e këtij universiteti.

Pra, edhe një herë, a ka Gjakova ekspertë më të mirë se ju për të qenë anëtarë të këtij Këshilli, apo duhet ju t'i keni dy pozita, edhe si deputete, edhe si anëtare e Këshillit Drejtues. Nuk po ju tregoni, s'po jeni e sinqertë, prandaj mos u fshihni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sot debatuar për një temë mjaft të rëndësishme, dua të falënderoj LDK-në, edhe “Vetëvendosjen” që e kanë sjellë në Kuvend për debat këtë temë, e cila mendoj që ka shfaqur mjaftueshëm se gjendja në arsim ka qenë keq dhe Bordi i Akreditimit ka pasur përzjerje politike, kjo nuk ka asnjë dilemë.

Mendojmë se jemi para një momenti që duhet të marrim vendime, të cilat do të na hapin një rrugë të re për të ndryshuar gjendjen në arsim. U thanë nga shumë parafolës, edhe nga ministri, edhe nga kryeministri, por edhe nga deputetë të caktuar se veprimtaria e Bordit tanimë të shkarkuar, ish-Bordit, është manifestuar me mjaft shkelje dhe parregullsi në punën e tyre, mendoj që nuk ka nevojë tani të hyjmë edhe të listojmë edhe më tutje të gjeturat, të cilat do ta reflektonin edhe më tutje punën e ish-Bordit të shkarkuar. Dëgjuam këtu edhe thirrje për protesta, pse jo, është e drejtë e secilit të bëjë thirrje, të bëjnë thirrje për revolucionarizëm, e tema të tjera, të cilat nuk e kanë vendin, por mirë është, foltorja është e hapur, thirrjet mund të jenë, siç tha njëri nga folësit, edhe partizane, nuk ka asnjë të keqe.

Bordet politike, kjo është një temë e cila ka përcjellë në vazhdimësi Kosovën, do të ishte shumë e çuditshme sikur do të kishte ndonjë Bord, në cilindo nivel, qoftë në ndërmarrjet publike a lokale, të cilët do të ishin jopolitike. Ne kemi pasur skena kur edhe për çështje të ndryshme, thjesht për Borde lokale kemi parë kacafytje të eksponentëve politikë për të ndërhyrë, tendencat e tilla nuk janë diçka risi në Kosovë. U shtruan edhe tema të tjera nga deputetët, shikoni, Malisheva tri herë si komunë gjatë ish-pushtetit është shpërbërë, për të vetmen arsye se ka qenë njëra nga komunat etnikisht të pastra.

Të gjithë kanë të drejtë të konkurrojnë dhe të zgjidhen nëpër institucionet e Kosovës, tendenca për të etabluar dikë. si Malishevës apo si i dikujt tjetër që zgjidhet në një pozicion, mendoj se nuk i bën nder kurrkujt këtu në këtë Kuvend, e më së paku atyre të cilët e ngritin. Sigurisht që parafolësi që foli kush është i Malishevës apo i cilës komunë, dua ta vazhdoj pyetjen e zonjës Haxhiu. Cila ka qenë ajo farë përgatitja e saj që është zgjedhur në Bordin Drejtues të Universitetit të Gjakovës? Apo që i takon të komunës së Gjakovës, apo cila përgatitje ka bërë që ta avancojë çështjen edhe punën e Universitetit të Gjakovës, deputete e nderuar Lila, ku u dha një pasqyrë reale që Universiteti i Gjakovës, edhe pas pesë vjetëve, ende nuk është funksional dhe nuk i plotëson kushtet të quhet as universitet. Prandaj, unë bëj thirrje që është momenti i duhur të reflektojmë pozitivisht, në mënyrë konstruktive, ashtu siç bëri thirrje edhe shefi i Grupit, zoti Sherifi, që të gjejmë një konsensus nacional për këtë temë tepër të rëndësishme edhe për të tashmen, edhe për të ardhmen e vendit, ashtu siç ofroi mundësi për ecjen përpara edhe ministri, ta mbështesim pa dallime dhe pa përfitime politike në këtë rast.

Mendojmë se situata kërkon përgjegjësi politike edhe nga ne si deputetë, përtej grupimeve politike, të cilave u takojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rekalju.

FIDAN REKALJU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë,

Vite me radhë jemi përballur me probleme të mëdha në sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës, sidomos në atë të lartë. Të gjithë ne që jetojmë dhe veprojmë në Kosovë përditë përballemi me raste të rënda të papunësisë të rinia jonë, qofshin ata studentë apo që kanë mbaruar qoftë njërin apo tjetrin nivel të studimeve të avancuara.

Të gjithë ndjejmë dhimbje për këto raste, dhe në këto momente pyesim veten pse s'po e zgjidhin dot këtë plagë ndër më të rëndat e Kosovës së pasluftës? Në anën tjetër, shohim përditë kërkesa specifike nga tregu i punës, nga punëdhënës në sektorin privat që përballen me mungesë të punonjësve të kualifikuar ose, më saktë, nuk arrijnë të gjejnë në treg nivelin e duhur të përgatitjes specifike profesionale. Sistemi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës përveçse funksionon me dobësi të rënda, në të njëjtën kohë, është edhe i dizajnuar në shpërputhje me kërkesat e tregut të punës, me shkallën e avancuar të inovacionit dhe kapaciteteve zhvillimore absorbuese në Republikën e Kosovës. Kështu këto politika kanë prodhuar numër enorm të të diplomuarve në disa drejtime gjenerale, pa asnjë mundësi për t'u futur në tregun e punës dhe, në anën tjetër, ka lënë bosh tregun e punës me profesione e drejtime profitabile, qoftë për të rinjtë, qoftë për ekonominë e vendit.

Sot ne do të duhej të flisnim në këtë seancë për reformën e thellë e të gjithanshme të arsimit të lartë dhe për ndryshimin e politikave të gabuara, të cilat i përmenda më lart. Por, këtë mundësi nuk e kemi, nuk e kemi, sepse Qeveria qartësisht më e dobët që nga paslufta, sistemin e arsimit të lartë, të ardhmen e rinisë kosovare ka vendosur t'i vërë edhe një gur mbi shpinë. Përfundimi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë është një akt i rëndë me pasoja të qarta me perspektivën e reformave dhe besimin se një ditë ky sistem arsimor do të nxirret gradualisht nga kolapsi. E shprehur në formë të ndryshme, ky veprim i Qeverisë ka prodhuar ende më shumë zhgënjim te qytetarët e Republikës së Kosovës, andaj sot me këtë rast si deputet dhe kolegë juaji, shpreh mirënjohjen deputetëve nënshkrues të kësaj seance të jashtëzakonshme që bënë të mundur të krijohen kushte për të kërkuar përgjegjësi nga aktorët e kësaj vepre kundër interesave të studentëve, imazhit tonë jashtë vendit dhe në përgjithësi.

Dua të besoj, madje shpresoj shumë që secili deputet në Kuvend, i pozitës apo i opozitës, do të jetë në lartësinë e detyrës politike, përfaqësuese e qytetare për t'u bashkuar për të mirën e rinisë

dhe të vendit. Të mos lejojmë të përfundojë kjo seancë pa rezultate konkrete, ky Kuvend mund dhe duhet të veprojë sot. E ka detyrim të veprojë, mos harroni, është në nderin e Kuvendit të Republikës së Kosovës të ushtrojë përgjegjësitë e tij kushtetuese, mbikëqyrjen dhe korrektimin e Qeverisë, jashtë çdo interesi të ngushtë partiak që ndërlidhet me marrëveshjet për të mbajtur pushtetin si qëllim në vete.

Sot, kur bëhet fjalë për një çështje si kjo, kryeministri i vendit me nxitjen e bërë për të shkarkuar Bordin e mëparshëm të Agjencisë për Akreditim ka shkaktuar këtë situatë që dëmton edhe më tej imazhin e universiteteve tona, prandaj i njëjti duhet të jap përgjegjësi për këtë situatë të krijuar. Është obligim që e kemi ndaj një sistemi arsimor, i cili duket që ka funksionuar më mirë në periudhën 1990-1999 se sa tash. Duket që kjo Qeveri nuk po lehtëson aspak problemet që ka vendi, përkundrazi, ajo është shkaktar i shumicës prej tyre. Një qeverisje e tillë duhet të ndërpritet sa më parë për të mirën e qytetarëve të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrahmani e ka fjalën.

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Nga diskutimet e sotme të kolegëve deputetë u pa dhe u konstatua që gjendja në arsim është e rëndë, në fakt ne sot drejtuam gishtin nga njëri-tjetri, herë me argumente, herë pa to dhe duke mos ofruar asnjëherë zgjidhje adekuate për ta tejkaluar situatën.

Politika dhe politikëbërja në fushën e arsimit ka bërë që sot kur flasim për arsimin përpara na del një mal me probleme, të cilat asnjëherë nuk janë vënë në rrugëzgjidhje. Sot në Ditën e Mësuesit, në vend se të flasim për suksese, në vend se të flasim për proceset e hapjes me botën dhe proceset e integritimeve në institucione kredibile të arsimit modern, ne po debatojmë për krejt të kundërtën. Rrethanat që po krijohen në arsim nga ata që do të duhej të hapnin rrugë me vendime të peshuara mirë, rrezikojnë që punëtorin e arsimit në këndvështrimin e qytetarit ta vendosin padrejtësisht në qendër të problemit.

Prandaj, ne kemi përgjegjësi që me politikën në arsim të krijojmë perspektivën, e cila profilin profesional të mësuesit, arsimtarit dhe profesorit e bën të shenjtë dhe të pazëvendësueshëm në zhvillimin e shoqërisë. Natyrisht se problemet nuk janë krijuar sot, shumë janë trashëguar, por e keqja qëndron në faktin se angazhimet e fundit të Ministrisë së Arsimit, angazhimi i fundit nuk po shkon në drejtim të zvogëlimit të problemeve, por përkundrazi ato po thellohen edhe më tutje.

Më herët janë hapur universitete publike që shpesh cilësohen me të drejtë dhe pa të drejtë kryesisht politike, pa ndonjë studim të mirëfilltë të nevojave për profile të caktuara të programeve, përcjellë me hapjen e një numri edhe më të madh të kolegjeve dhe universiteteve

private, që vëshirë monitorohen dhe të gjitha këto janë vetëm disa nga hallkat e krejt problemit të arsimit sot në Kosovë. Jemi dëshmitarë se janë akredituar programe pa njohur mirë nevojën e tregut të punës, pa analizuar fare nevojat e shtetit për kuadro të profileve të caktuara, gjë që ka prodhuar numër të madh të të rinjve me diploma universitare pa asnjë shpresë për punësim dhe ushtrim të profesionit.

Ky zhvillim stihik i rrjetit të institucioneve arsimore, qoftë publike, qoftë private, larg çdo strategjie shtetërore të mirëfilltë, ka krijuar një konkurrencë jo të shëndoshë, si në tregun e punës ashtu edhe në perspektivën e shkollimit të mëtejshëm të të rinjve. Dallimet e mëdha në cilësi si në mësimdhënie dhe mësimnxënie në mes të institucioneve të ndryshme arsimore, sidomos në raportin publiku me privat, ka shkaktuar probleme të paimagjinueshme me krijimin e kuadrove të mirëfillta për plotësimin e nevojave të institucioneve tona. Në disa profile kemi grumbullim dhe konkurrencë jashtë çdo logjike, derisa për shumë fusha nuk kemi fare kuadro. Problemi paraqitet edhe më i theksuar në krijimin e konkurrencës jo të ndershme dhe të pabarabartë në mes kandidatave që synojnë studime posdiplomike. Shumë herë janë akredituar programe pa e ditur mirë se cili do të jetë profili profesional, cili do të jetë titulli i fituar, kush do të licencojë ata të diplomuar dhe cilat janë kompetencat profesionale që determinojnë vendin potencial të punësimit.

Pra, arsimit ka pësuar shumë nga vendime të ngutshme dhe të pamenduara mirë, pothuajse gjithëherë me motive politike, e jo rrallë edhe për inate apo përfitime individuale dhe të grupeve të caktuara. Sikur ky vendim, i nderuar ministër, të mos ishte i motivuar nga ajo që thash më lartë, do të ishte i mirëpritur jo vetëm nga të gjithë ne, por edhe nga instanca ndërkombëtare, rrjedhimisht edhe nga institucioni i Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë. Përrjashtimi nga ky institucion i Agjencisë Kosovare të Akreditimit është kthim prapa në proceset integruese, është kthim prapa në afirmimin e vlerave të arsimit në Kosovë, është mbyllje e dyerve të bashkëpunimit të institucioneve tona arsimore me institucione kredibile në Evropë, është ngufatje e perspektivës për dije më shumë për studentët tonë.

Kështu si ka ndodhur vendimi ka shkaktuar edhe një problem më shumë në arsimin në Kosovë. Prandaj, i nderuar ministër, dua të besoj se e ndjeni veten përgjegjës për një situatë të tillë, e cila lehtë ka mundur të shmangej sikur të ishin respektuar ligjet dhe sikur të ishin respektuar procedurat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ilir Deda tash e ka fjalën.

ILIR DEDA: Faleminderit!

E dini, është zhgënjyese qysh në një debat nuk jemi në gjendje me e mbajt të fokusuar. Edhe ajo që është pritur prej jush sot, zoti ministër, është të na bindni se e keni marrë seriozisht gjendjen në të cilën vendimet e Qeverisë e kanë sjellë një pjesë të arsimit të Kosovës.

Ne nuk po presim prej jush të dilni e të mbroheni, sepse jemi të vetëdijshëm që është vendim i kryeministrit, vendim arbitrar i kryeministrit të Kosovës, i paligjshëm i kryeministrit të Kosovës, vendim i cili sot ai e arsyeton me vepër penale edhe të tijën bashkë, por ne duhet ta dimë që ju jeni të vetëdijshëm dhe duhet të na bindni për hapat që do të ndërmerri, që në këtë 90-ditësh të na sqaroni a do të riaplikojë Kosova në EQAR, apo jo. Çka po ndodh me suspendimin nga ENCA? Këto kanë pasoja.

Tash, disa deputetë të mazhorancës mundohen ta relativizojnë problemin duke thënë “hajt, se s’është problem...”, është problem. Mentaliteti “hajt, se nuk është problem” në këto 20 vjet e ka sjellë Kosovën me numër të analfabetëve funksionalë në rangun apo me statistika njëjtë si në vitet e ‘60-ta. Ne i kemi 40% të popullatës analfabetë funksionalë sot. Nuk ka qenë kështu para 20 vjetëve, kështu ka qenë para 60 vjetëve, e ne e kemi sjellë nga kjo papërgjegjësia, relativizmi, shkatërrimi i arsimit, e kanë sjellë këtë vend në atë pikë. Tash, Agjencia Kosovare e Akreditimit me punën e vet ka qenë një prej institucioneve të pakta të Kosovës, të cilat kanë pasur sukses dhe kanë qenë shembull me të cilën Kosova ka mundur të tregojë se mund të prijë në reforma në një fushë, ku vendet tjera të Ballkanit Perëndimor nuk e kanë pasur atë kualifikim. Ky është problemi.

Tash, ju... se s’ka lejuar kryeministri me këtë filozofinë “kam unë informata konfidenciale” nuk ka lejuar, nuk keni mundur t’i jepni përgjigje, ju ka pritur EQAR-i. Po tash sot duhet të dilni dhe të na tregoni, e dimë që e keni pasur vështirë, ju e thatë se ka qenë vendim i ngutshëm, faleminderit, këtë duhet ta shohim si një vetëdijësim nga ana e juaj për problemin që është shkaktuar, por duhet të na tregoni saktë se me çfarë urgjence do të ndërmerri, cilat hapa do t’i ndërmerri që Kosova të jetë në EQAR, që Kosova të mos përjashtohet nga ENCA, që mos të kemi problem në dy vjetët e ardhshme me studentët e Kosovës dhe me validimin e diplomave të studentëve të Republikës së Kosovës, sepse ajo është problemi dhe nuk është një problem që zgjidhet në qoftë se përjashtohemi përfundimisht, nuk zgjidhet ajo për dy-tre muaj, zgjidhet për disa vjet.

Edhe për fund, ju kisha lutur që në rekomandimet që do të propozohen dhe të votohen, të kemi afate të përcaktuara kohore, me të cilat ministër, do të mund të na raportoni rregullisht dhe t’u përmbaheni afateve nga rekomandimet të cilat do të dalin, sepse ne nuk kemi një vit kohë tash të presim, as gjashtë muaj, por duhet shpejt të ndërmerren këto veprime dhe të ndërmerren në transparencë. Domethënë, të jetë transparent në bashkëpunim me partitë politike, sepse arsimi është, ajo u quajt edhe nga ju “interes nacional”.

E për fund, nëse me të vërtetë ata anëtarët e shkarkuar të bordit, të gjithë kolektivisht, paskan bërë vepër penale, atëherë ju si ministër keni të drejtë që t’i drejtoheni Prokurorisë së shtetit, në qoftë se ju nuk e keni këtë informatë atëherë mund të kërkonin nga kryeministri, i cili paska

informata për vepra penale, që t'i drejtohet Prokurorisë së shtetit. Po dikush tash për këso lloj akuzash duhet të shkojë në burg. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Bytyqi e ka fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Atëherë, ne e kuptojmë seriozitetin e situatës. Deputet i nderuar Ilir, po lidhen shumë gjëra me ju, por edhe me të gjithë deputetët që deklaruan deri më tani. Jo rastësisht, që në fillim e thamë se pas ngritjes së dilemave që lista e propozuar mund të ketë ndikime politike dhe me verifikua që ne vërtet kemi dëshirë që ta kemi një këshill shtetëror cilësor të pavarur në punën e vet, e pavarur si agjenci e rëndësishme për kontrollimin e cilësisë në arsimin e lartë, ne e kemi bërë kërkesën tek kryeministri, që kjo listë përkohësisht të suspendohet, të verifikohet. Kemi kërkuar asistencë direkt nga Bashkësia Evropiane që të na ndihmojë në verifikimin e listës dhe nëse është nevoja kjo listë duhet të ndryshojë, pra të propozohen emra kredibil, karshi situatës, e cila na është krijuar.

E dyta, ne jemi të gatshëm që të kemi një trupë monitoruese, pra ministria do ta ndihmojë bashkë me Parlamentin që të biem dakord, ndoshta edhe nga rezoluta e sotme, që të kemi një trupë monitoruese të vazhdueshme të punës së Agjencisë, gjegjësisht të Këshillit Shtetëror Cilësor i cili duhet të jetë sa më shpejt funksional. Për t'u realizuar këto dy gjëra është shumë e rëndësishme lëvizja në kohë, sepse vërtet jemi keq me kohën dhe konsideroj se ne duhet të zotohemi edhe si Parlament, edhe si Qeveri, që lista kredibile të miratohet nga Parlamenti brenda këtij muaji, pra deri në fundin e marsit, në mënyrë që të kemi në dispozicion 60 ditë, diçka më pak se 60 ditë, për ta ushtruar një ankesë të mirë në AHR. Gjithsesi, ne jemi të gatshëm si ministri të angazhohjmë ekspertë të fushave që të na ndihmojnë që së bashku me Agjencinë e Akreditimit dhe me trupat monitoruese ta bëjmë një ankesë siç duhet në AHR. Këto tri trupa dhe kjo formë e hapave konsideroj që do ta ndihmojë dhe do ta shohë seriozitetin edhe karshi ENCA-s. Nëse ne lëvizim në kohë dhe jemi të gatshëm që së bashku t'i kryejmë punët siç duhet, konsideroj se do të jetë një sinjal shumë pozitiv për ENCA-n dhe do ta marrë seriozisht, se ne nuk kemi asnjë qëllim të kemi ndërhyrje në pavarësinë e agjencisë, por agjencia duhet të funksionojë e pavarur.

Dhe krejt në fund, nëse do të jetë dakord edhe Parlamenti, duhet t'i kërkojmë Agjencisë së Akreditimit, gjegjësisht Këshillit Shtetëror të Cilësisë për shkak të situatës së krijuar që të raportojë në Parlament çdo tre muaj, derisa t'i përfundojmë të gjitha procedurat që lidhen edhe me qëndrimin e ENCA, por edhe kthimin tonë në AHR.

Këto janë propozimet tona, që konsideroj se së bashku mund t'i fusim edhe në rezolutë që t'i bëjmë sa më serioze dhe t'i marrim hapat konkretë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Është mirë të fillohet me diçka të mirë, kështu që ua uroj Ditën e Mësuesit gjithë punëtorëve të arsimit në Kosovë, njëkohësisht edhe veteranëve, po veçanërisht mësueses Elmaze Sabedinaj edhe arsimtares Seniha Vokshi-Gacaferri. Njëkohësisht, ia uroj Ditën e Mësuesit edhe familjes Hertica, Aliut, në Kodrën e Trimave, që në disa prej kohëve më të vështira na e mundësuan neve që të ishim studentëve dhe profesorëve tanë që të ishin profesorë në disa prej kohëve më të vështira, duke rrezikuar edhe veten dhe familjen e tyre.

Tash t'i kthehemi çështjes për çka edhe jemi mbledhur sot. Edhe pse, pjesë e opozitës unë besoj se më takon ta mbroj pak ministrin, sepse po habitem pak që po e ngarkoni kaq shumë kur ai nuk ka bërë diçka të jashtëzakonshme. Ai thjesht ka vazhduar me atë që është e natyrshme për këtë Qeveri, pra që çdo vendim që e marrin, ose duhet mos të ketë bazë ligjore, ose me e shkelë bazën ligjore, ose me e shkelë ndonjë procedurë të caktuar e herë-herë besa edhe Kushtetutën. Kështu që, thënë më mirë, ai ka vazhduar edhe me avazin e vjetër të paraardhësve të tij, pra që të merren vendime të cilat në vazhdimësi e dëmtojnë arsimin në vend dhe japin rezultate sikur këtë që është temë e sotme.

Unë po hutohem edhe me diçka tjetër, që ne zakonisht po presim të vijë një raport i progresit, ose një përjashtim nga një regjistër evropian për të na e treguar gjendjen në të cilën gjendemi. Unë besoj se pjesa dërmuese e deputetëve janë profesorë në një nivel, ose një tjetër, dhe e dinë shumë mirë gjendjen. Besoj se edhe bartësit e arsimit të lartë janë shumë të vetëdijshëm, sa i përket gjendjes së mjerueshme në të cilën ka qenë në fakt edhe Agjencia për Akreditim. Nuk është ndonjë sekret i madh, në fakt është sekret publik edhe shaka e brendshme në mes tyre, që thonë se kurdo që thirren aty nuk shkojnë kurrë pa u ndalë një herë në bankomat. Kështu që, është një shaka e tyre e brendshme.

Pra, pse na po presim gjithmonë dikush prej Brukselit, ose prej ndonjë qendre tjetër evropiane të na e tregojë neve gjendjen në të cilën gjendemi. Nëse shikohen vendet që kanë dështuar, ose vendet që janë shtete të suksesshme janë drejtpërdrejtë reflektim i tri shtyllave të shoqërisë, një prej tyre është arsimi, shëndetësia dhe drejtësia. Fatkeqësisht, në shtetin tonë këto janë tri shtyllat më të dobëta të shoqërisë sonë. Do të thotë, tri shtylla mbi të cilat ne duhet ta ndërtojmë shtetin tonë janë ato të cilat i kemi lënë anash, sepse qëllimi veçanërisht i kësaj Qeverie është që të fokusohet dhe të ketë prioritete të tjera, pra jo ato që janë të rëndësishme për qytetarët, por në gjëra të tjera që ndërliken me interesat e tyre të ngushta, qoftë partiake, qoftë personale.

Kështu që, ne e kemi një mundësi të rrallë si deputetë, që ta shfrytëzojmë këtë ndodhi që nuk besoj se është as e para, as e fundit, që ta bëjmë një zgjim nga gjumi edhe të tregojmë vullnet politik që të ndërmarrim masa konkrete për ta përmirësuar, po them prapë, njëën nga tri shtyllat që do të përcaktojë se a do të jemi shtet funksional a do të jemi shtet i suksesshëm apo do të jemi në listën e njërës nga shteteve të dështuara, që kemi plotë nëpër botë. Kështu që, vërtet ju kisha inkurajuar të mendoni jashtëzakonisht thellë, jashtëzakonisht shumë, edhe me i tejkalua ngjyrat, qoftë partiake, qoftë personale, për të ardhur deri te një vendim dhe deri te disa të zbatueshme, të cilat arsimin në vend vërtet e shtyjnë përpara si parakusht për zhvillime të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vjosa, dëshiron ta marrësh fjalën? Atëherë, zoti ministër, në qoftë se dëshironi për fund? Ju, propozuesi? A keni përgatitur diçka, zoti Hoti?

AVDULLAH HOTI: Kryesues,

Ne i kemi disa rekomandime. Unë propozoj, që derisa të mblidhen deputetët në sallë për dhjetë minuta të tërhiqemi kryesuesit e grupeve parlamentare dhe t'i harmonizojmë rekomandimet e të vijnë në sallë për votim.

KRYESUESI: Mirë, atëherë sa minuta the? 15?

AVDULLAH HOTI: 15!

KRYESUESI: 15 minuta pauzë, pra derisa t'i sjellin rekomandimet.

* * *

KRYESUESI: Zoti Hoti, do t'i lexojë rekomandimet.

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë, ju lus për vëmendje.

Ne kemi mundësi që të votojmë tani rekomandimet të cilat mund t'i lexojë Avdullahu dhe ato janë rekomandimet që janë dhënë këtu dhe kanë arritur pajtueshmëri të gjitha grupet parlamentare. Nuk është shumëzuar teksti për ta pasur secili deputet. Kemi mundësi ta votojmë tani pasi ta lexojë Avdullahu, ose nesër kur të fillojë seanca tjetër.

Zoti Hoti? Atëherë, Zoti Hoti është dakord. Ju të "Vetëvendosjes" a jeni dakord? Glauk, a je dakord? Po.

Sa kemi kuorum? A kemi? Nuk ka dikush kundër që voton? Sa janë? Atëherë, kemi kuorum të mjaftueshëm, janë 65 deputetë. Po, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Pa i pasur secili deputetë para vetën shkresën nuk duhet të votohet, prandaj e lëmë për nesër. Administrata le t'i bëjnë të gjitha kopjet, le t'ua shpërndajnë deputetëve, sepse pastaj po thonë “nuk kemi ditur çka kemi votuar”.

KRYESUESI: Nuk mund ta hedh, sepse dështon votimi. Bilall? Po, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues! Nuk mendoj se këtë punë të mundimshme tërë ditore që e bëmë, një herë duke debatuar, pastaj duke harmonizuar, ta lëmë për nesër. Administrata mund t'i fotokopjojë, kur të bëhen dhjetë minuta 65 letra dhe ta votojmë, ta heqim nga rendi i ditës këtë dhe të fillojmë me afatet që i kemi përcaktuar në ato 5-6 pika. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, në rregull! Shumica janë për ta futur në votim, por unë s'e di kalon apo s'kalon. Zoti Hoti, mund ta lexosh, nëse do, tekstin. Shumica janë për ta lexuar tekstin, tash s'po di. A po e lexon tekstin dhe e hedhim në votim?

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Pas dakordimit me të gjitha grupet parlamentare, më lejoni t'i lexoj rekomandimet e këtij debati.

1. Brenda afatit të ankimimit të ndërmerren të gjitha veprimet e duhura për të kthyer AKA-në si anëtar i rregullt në EQAR.

2. Ministri të raportojë në Kuvend:

a. për arsyet e shkarkimit të Bordit, duke ofruar informata për Komisionin Funkcional (në raportim me dyer të mbyllura, nëse është e nevojshme); dhe

b. veprimet që janë ndërmarrë ndaj ish-anëtarëve të Bordit për shkeljet e pretenduara që mund t'i kenë bërë ata.

3. Ministri ta tërheqë nga Kuvendi për verifikim propozim-vendimin për anëtarë të Bordit.

4. Në afatin prej shtatë ditësh një ekip pune, i përbërë nga të gjitha palët, ekspertë të arsimit, përfaqësues të ministrisë, përfaqësues të organizatave që monitorojnë punën e arsimit të lartë dhe të tjerë, të përgatisë Udhëzimin Administrativ që miratohet nga ministri, i cili udhëzim do t'i përcaktojë kriteret dhe procedurat transparente për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit.

5. Bazuar në këtë Udhëzim Administrativ, lista e anëtarëve të Bordit të procedohet në Kuvend për miratim.

6. Kuvendi obligohet që brenda dhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të propozim-vendimit nga Qeveria, ta radhisë në rend dite për miratim.

7. Kuvendi i rekomandon ministrin të fillojë hartimin e një propozim-ligji të ri për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili siguron autonominë e Agjencisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë e hedh në votim propozimin e të gjitha grupeve parlamentare lidhur me rekomandimet, të miratuar së bashku. Votojmë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 62 deputetë. 61 për, 1 kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që rekomandimet e propozuara nga grupi miks i të gjitha grupeve parlamentare u miratua në Kuvend mbi bazën e kërkesës për deputetë nga Lidhja Demokratike dhe Lëvizja “Vetëvendosje”.

Mirupafshim nesër!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*